

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL I TURIZMIT
RAJONI I ALPEVE SHQIPTARE

PLANI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETARI I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Z. BLENDI KLOSI

**PLANI I KOMBËTAR SEKTORIAL I TURIZMIT
PËR RAJONIN E ALPEVE SHQIPTARE**

PLANI I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, Datë 09.12.2017

STUDIO KONSULENTE

PM Group, *Irlandë*.

Instituti i Politikave Publike dhe Private IP3,
Tiranë.

AUTORËSIA DHE KONTRIBUTET

Ky dokument u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor nën kornizën e investimeve në rajon, përfituar nëpërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës.

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë dokument janë të autor-it/ve (konsorciumi që përbëhet nga PM Group, Archidata, Globaldit, Instituti i Politikave Publike e Private IP3 dhe Seda) dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të kontribuesve në Fondin e Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor, të EBRD, si bashkë-menaxher i Fondit të Përbashkët për Ballkanin Perëndimor, apo Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës si institucion financiar kryesor në lidhje me projektin.

E K S P E R T Ë T K R Y E S O R Ë (K E Y E X P E R T S)

Gabriele Bonafede, udhëheqësi i grupit;
Manfred Kojan, ekspert për marketimin dhe turizmin;
Max Haberstroh, ekspert i turizmit;
David Lyth, ekspert mjedisi;
Fredrik Pitzner-Jorgensen, ekonomist për investimet;
Ariela Kushi, ekspert i planifikimit urban;
Romina Sahiti, ekspert i planifikimit urban;
Endri Noçka, ekonomist urban;
Gent Nechwatal, ekspert i transportit;
Luan Mlloja, ekspert për ujësjellës-kanalizime;
Bukurosh Onuzi, ekspert i turizmit;
Genc Metohu, ekspert i turizmit;
Abdulla Diku, ekspert mjedisi;
Artur Galanxhi; ekspert i bujqësisë;
Erin Mlloja, ekspert GIS.

E K S P E R T Ë T M B È S H T E T Ë S (N O N - K E Y E X P E R T S)

Iva Tavanxhiu, ekspert i planifikimit urban;
Orinda Biba, ekspert mjedisi;
Kreshnik Bajraktari, ekspert transporti;
Besmira Vishe, ekspert ligjor.

PËRMBAJTJA

1. HYRJJE	8
1.1 ZONA NË STUDIM DHE POZICIONI RAJONAL	9
1.2 KONSIDERATA NGA PPK DHE STRATEGJIA KOMBËTARE E TURIZMIT	13
1.2.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030	13
1.2.2 Draft-Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2017-2022	15
1.3 ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE DHE TË TRASHËGIMISË KULTURORE	17
1.3.1 Parku Kombëtar i Alpeve	18
1.3.2 Parku Bashkiak Nikaj-Mërtur	21
1.3.3 Parku Bashkiak i Shkrelit	25
1.3.4 Thethi - Qendër e mbrojtur historike	29
1.3.5 Monumente kulture dhe natyre në zonë	30
1.3.6 Kufizime të tjera	32
1.4 PËRMBLEDHJE E VIZIONIT DHE ORIENTIMEVE STRATEGJIKE	34
2. PROPOZIMET DHE PËRCAKTIMET TERRITORIALE	38
2.1 PRODUKTET TURISTIKE QË MUND TË ZHVILLOHEN	39
2.1.1 Klasifikimi i produktit turistik	39
2.1.2 Aktivitetet kryesore që mund të zhvillohen sipas produktit turistik	41
2.2 PROJEKSIONET PËR SEKTORIN E TURIZMIT NË ALPET SHQIPTARE	43
2.2.1 Karakteristikat e kërkesës turistike aktuale sipas segmenteve	43
2.2.2 Projektioni i kërkesës turistike	47
2.2.3 Vlerësimi i “kapacitetit mbajtës” dhe akomodues të territorit	49
2.3 SEGMENTET KRYESORE QË DO TË SYNOHEN NË TË ARDHMEN	50
2.4 LOKALITETET TURISTIKE DHE KARAKTERISTIKAT E TYRE	52
2.4.1 Niveli I: Lokalitetet urbane	53
2.4.2 Niveli II: Lokalitetet “ndërmjetëse”	53
2.4.3 Niveli III: Lokalitetet “bërthamë”	54
2.4.4 Niveli IV: “Lokalitete natyrore” të Alpeve Shqiptare	55
2.4.5 Rrezja e influencës	55
2.4.6 Kapaciteti akomodues optimal i lokaliteteve	58
2.5 MBROJTJA E PEIZAZHIT DHE SHPALLJA E ZONAVE TË RËNDËSISË KOMBËTARE	62
2.5.1 Çështjet e rëndësisë kombëtare	62
2.5.2 Zona e Rëndësisë Kombëtare - fshati Curraj i Epërm	63
2.6 KARAKTERISTIKAT DHE VEÇORITË E LOKALITEVEVE	66
2.6.1 Koplik - niveli I	66
2.6.2 Bajram Curri - niveli I	69
2.6.3 Vermosh - niveli II	72
2.6.4 Tamarë-Selcë - niveli II	75
2.6.5 Razëm - niveli II	78
2.6.6 Reç - niveli II	81
2.6.7 Bogë - niveli II	84
2.6.8 Lugina e Kirit - niveli II	87

2.6.9	Nënmavriq - niveli II	90
2.6.10	Koman - niveli II	93
2.6.11	Dushaj - niveli II	96
2.6.12	Valbonë - niveli II	98
2.6.13	Lekbibaj - niveli II	101
2.6.14	Tropojë e Vjetër - niveli II	104
2.6.15	Lëpushë - niveli III	107
2.6.16	Vukël - niveli III	110
2.6.17	Theth - niveli III	113
2.6.18	Curraj i Epërm - niveli i III	116
2.6.19	Çerem - niveli i III	119
2.6.20	Rragam - nivel i III	122
2.6.21	Sulbicë - niveli i IV	125
2.6.22	Blini i Gurit të Lekës - niveli i IV	128
3.	AKSESI NË ZONË DHE ITINERARET TURISTIKE	132
3.1	ITINERARET KRYESORE TURISTIKE	133
3.2	INFRASTRUKTURA E MOBILITETIT	136
3.2.1	Infrastruktura e nevojshme	136
3.2.2	Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore	141
3.3	TRANSPORTI DHE PARKIMI	142
3.3.1	Linjat e transportit turistik	142
3.3.2	Terminalet dhe parkimet publike	143
3.4	SHTIGJET PËR KËMBËSORË DHE BIÇIKLETA	146
4.	INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE	150
4.1	SHËRBIMI I FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME	151
4.2	SHËRBIMI I GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE URBANE	154
4.3	ENERGJIA DHE TELEKOMUNIKACIONI	156
4.4	QENDRAT SHENDETËSORE DHE SKUADRAT E KËRKIM- SHPËTIMIT	158
4.5	ORIENTIME NGA VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR	160
4.5.1	Rekomandime për mbrojtjen e tokës	160
4.5.2	Rekomandime për ruajtjen e cilësisë së ajrit	160
4.5.3	Rekomandime për mbrojtjen e elementeve ujore	161
4.5.4	Rekomandime për mbrojtjen e peizazhit natyror dhe kulturor	161
4.5.5	Rekomandime për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit	162
4.5.6	Rekomandime për uljen e zhurmave dhe ndotjen akustike	162
4.5.7	Rekomandime ndaj ndryshimeve klimatike	163
5.	PLANI I VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PKS-së	168
5.1	METODOLOGJIA DHE PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE	169
5.1.1	Ndikimi i projektit në mbrojtjen e natyrës	169
5.1.2	Ndikimi mjedisor	169
5.1.3	Ndikimi i projektit në projektet e tjera	170

5.1.4	Ndikimi në flukset turistike	170
5.1.5	Kosto e investimit	170
5.1.6	Efektiviteti i kostos	170
5.1.7	Përfituesit	170
5.1.8	Mundësia për punësim në shkallë lokale	171
5.1.9	Ndikimi i projektit në shërbime turistike të lokaliteteve	171
5.1.10	Ndikimi i ndërhyrjes sipas nivelit të lokalitetit	171
5.1.11	Përcaktimi i prioritetit të një projekti	171
5.2	FAZAT E ZBATIMIT TË PROJEKTEVE PRIORITARE DHE KOSTOT E TYRE	172
5.3	INDIKATORËT PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E PKS-së	200
5.4	NDRYSHIMET E NEVOJSHME NË KUADRIN LIGJOR DHE ADMINISTRATIV	201
5.4.1	Monitorimi i planit	201
5.4.2	Emergjencat civile	202
5.5	KOSTOT DHE FINANCAT E NEVOJSHME PËR ZBATIM	203
6.	PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESUARA DHE TAKIMET ME PUBLIKUN.....	210

IMAZHE

1. Pozicioni i zonës së studimit	9
2. Dinamikat rajonale	11
3. Rrjeti i zonave të mbrojtura	18
4. Plani i menaxhimit. Parku Kombëtar i Alpeve	19
5. Parku Bashkiak Nikaj-Mërtur. Plani i menaxhimit	21
6. Parku Bashkiak i Shkrelit. Plani i menaxhimit	25
7. Zona e shpallur, Qendër e Mbrojtur Historike e Thethit	29
8. Harta e monumenteve të natyrës dhe kulturës	31
9. Zonat e lejimit dhe përjashtimit	32
10. Harta e nivelit dhe influences se lokaliteteve	57
11. Kapaciteti akomodues optimal sipas kategorive të strukturave akomoduese	61
12. Kufiri i propozuar i Zonës së Rëndësisë Kombëtare	63
13. Llojet e turizmit për çdo lokalitet	131
14. Itineraret kryesore turistike	135
15. Harta e gjendjes akaktuale të rrjetit rrugor	137
16. Infrastruktura rrugore e propozuar dhe klasifikimi	139
17. Harta e transportit dhe lëvizjes	145
18. Shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta	148
19. Harta e fazave kohore të projekteve	199

TABELA

Tabela 1. Fluksi i shtetasve dhe automjeteve në pikat kufitare	12
Tabela 2. Zonat e lejimit dhe përjashtimit për Parkun Kombëtar të Alpeve	21
Tabela 3. Zonat e lejimit dhe përjashtimit nga PM për Parkun Bashkiak Nikaj Mërtur	24
Tabela 4. Zonat e lejimit dhe përjashtimit nga PM për Parkun Bashkiak të Shkrelit	28
Tabela 5. Aktivitetet kryesore që mund të zhvillohen sipas produktit turistik	42
Tabela 6. Karakteristika e turizmit aktual sipas segmenteve	46
Tabela 7. Vlerësimi i net-qëndrimit në 2031	47
Tabela 8. Vlerësimi i nr të shtretërve për 2031	48
Tabela 9. Projeksioni i nr të shtretërve dhe preferencat për akomodimin	49
Tabela 10. Segmentimi i tregut	50
Tabela 11. Kapaciteti akomodues optimal	58
Tabela 12. Kapaciteti akomodues optimal sipas kategorive të strukturave akomoduese	59
Tabela 13. Gjendja aktuale e rrjetit rrugor	132
Tabela 14. Rrugët që do të rikonstruktohen dhe ndërtohen	140
Tabela 15. Terminalet dhe parkimet publike	143
Tabela 16. Shtigjet per kembesore	147
Tabela 17. Shtigjet per biçikleta	148



01

HYRJE

- 1.1 ZONA NË STUDIM DHE POZICIONI RAJONAL
- 1.2 KONSIDERATA NGA PPK DHE STRATEGJIA KOMBËTARE E TURIZMIT
- 1.3 ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE DHE TË TRASHËGIMISË KULTURORE
- 1.4 PËRMBLEDHJE E VIZIONIT DHE ORIENTIMEVE STRATEGJIKE

1.1

ZONA NË STUDIM & POZICIONI RAJONAL


Zona që merret në studim nga Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit shtrihet në pjesën veriore të Shqipërisë, në një territor që përbëhet nga 12 njësi administrative vendore që i përkasin 4 bashkive:

- Bashkia Shkodër: Pult, Shosh dhe Shalë
- Bashkia Vau i Dejës: Shllak dhe Temal
- Bashkia Malësi e Madhe: Kelmend dhe Shkrel
- Bashkia Tropojë: Bajram Curri, Bujan, Margëgjaj, Lekbibaj dhe Tropojë e Vjetër

Zona në studim zë një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 2000 km², me një gjatësi maksimale prej 64 km dhe një gjerësi maksimale prej 60 km, duke përbërë gati 6,9 % të territorit të Republikës së Shqipërisë. Brenda kësaj zone përfshihet i gjithë Parku Kombëtar i Alpeve Shqiptare. Në zonën në studim ndodhen luginat dhe lumenjtë kryesorë (nga perëndimi në lindje): lumi i Vermoshit, Cem-it, Vuklit, Përroi i Thatë (“Lumi i Thatë”), i Kir-it, Shalës, Currajt të Epërm, Nikaj-Mërturit, Drinit (duke përfshirë liqenet artificiale të Vaut të Dejës, Komanit dhe Fierzës), Valbonës, Gashit dhe Tropojës.

Nga pikëpamja fizike, alpet janë të përcaktuara gjeografikisht si një rajon i veçantë, si brenda kufirit të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe përtej tij, gjë që dikton nevojën e një bashkëpunimi ndër-kufitar.

Pozicionimi i rajonit të Alpeve Shqiptare si pjesë e Alpeve Ballkanike dhe vlerat peizazhiste që mbart, janë disa nga elementet kryesore që kanë ndikuar në formulimin e orientimeve strategjike. Në të njëjtën kohë, rajoni i Alpeve Shqiptare do të dallojë nga pjesa tjetër përtej kufirit për sa i takon tematikave, llojeve të turizmit, ofertës, aktiviteteve, trashëgimisë kulturore, historisë, etj. Pavarësisht cilësisë së lidhjeve fizike, ky territor me dinamikën e tij luan një rol të rëndësishëm në rajon, duke u transformuar në një “urë lidhëse” midis Malit të Zi dhe Kosovës.



1. Pozicioni i zonës së studimit





Kufi planifikimi PKST

QENDRAT URBANE DHE INFRASTRUKTURA

- Qender primare urbane
- Qender dytesore urbane
- Qender terciare urbane
- Qender lokale
- Qender turistike
- Aeroporte funksionale
- Aeroporte jofunksionale
- Pike doganore
- Lidhjet kryesore te infrastruktures Hekurudhe

ZONA FUNKSIONALE DHE EKONOMIKE

- Zone ekonomike
- Hub logjistik
- Qender Inovacioni
- Zone Turistike
- Zone funksionale ekonomike
- Zone funksionale e specializuar

INDUSTRI, ENERGIJI

- Fabrike
- Miniera aktive
- Hidrocentralet kryesore
- Nenstacione
- Linje transmisioni
- Linje transmisioni ne ndertim
- Linja te propozuara
- TAP

QENDRAT BUJQESORE

- Pol bujqesor
- Qender Lokale e Specializuar

ELEMENTET E FORTE NATYRORE

- Zonat e mbrojtura
- Itinerari alpino liqenor
- Itinerari ujqor

Aksesi në zonën e alpeve

Zona në studim ka lidhje direkte me Malin e Zi nëpërmjet pikave ekzistuese doganore Muriqan - Sukobin, Hani i Hotit - Bozhaj (Korridori Veri - Jug), Vermosh – Guci, dhe atyre që janë planifikuar të ndërtohen në të ardhmen si Zogaj - Hutaj, Grabom - Cijevna dhe Qafë Vranicë -Plavë. Kjo zonë lidhet me Kosovën nëpërmjet pikave doganore Morinë - Vermicë (Korridori X) dhe Qafë Morinë - Gjakovë. Gjithashtu, përveç pikave kufitare, ekzistojnë edhe disa pika policore si në Valbonë, Rosni dhe Tamarë, të cilat shërbejnë vetëm për kalimin e këmbësorëve. Bazuar në të dhënat e marra nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë për vitin 2016, rezulton se në pikat kufitare me Malin e Zi hyjnë dhe dalin rreth 966.000 automjete me targa shqiptare dhe të huaja, ndërsa në pikat kufitare me Kosovën rreth 2 milionë automjete.

Trendi i fluksit në pikat kufitare ndryshon në varësi të sezonit, ku gjatë stinës së verës dhe festave të fundvitit ky fluks është më i madh.

Ky trend i lëvizjes së automjeteve me tendencë rritjeje vit pas viti, na orienton për drejtimet e flukseve kryesore të aksesit të turistëve në zonë. Aktualisht Alpet Shqiptare kanë një mbulim të pjesshëm me rrjet rrugor (akset që vijnë nga Tirana kalojnë nga Shkodra dhe lidhen me Hanin e Hotit për të dalë në Mal të Zi, pjesë e së cilës është edhe hekurudha), ndërkohë ana lindore e rajonit aksesohet nëpërmjet korridorit të rëndësisë kombëtare, Rruga e Kombit, Durrës – Kukës - Morinë. Ky korridor plotëson rrjetin qendror me qëllim lidhjen e kryeqyteteve të vendeve fqinje. Përqendrimi më i madh i rrjetit mbulon pjesën perëndimore dhe lindore të këtij rajoni, ku krahas aksesit nga pikat doganore janë edhe hyrjet nga territori shqiptar apo turistët që vijnë nga aeroporti kombëtar “Nënë Tereza”, portet, hekurudhat dhe aeroporti i Kukësit në perspektivë.

Shtetas	Pikat Kufitare me Kosoven						Pikat Kufitare me Malin e Zi			
	Morinë	Shishtëvec	Orgjost	Qafë- Prush	Qafë- Morinë	Total 2016	Muriqan	Hani i Hotit	Bashkim	Total 2016
Hyrje Shtetas Shqiptar	556.155	13.194	29.487	94.705	138.452	831.993	244.946	231.171	6.221	482.338
Dalje Shtetas Shqiptar	570.245	13.668	30.678	147.970	172.615	935.176	300.112	263.800	6.879	570.791
Hyrje Shtetas te Huaj	2.018.457	1.397	1.021	31.649	65.661	2.118.185	506.239	277.950	9.620	793.809
Dalje Shtetas te Huaj	2.150.958	1.350	911	26.141	57.707	2.237.067	496.424	234.663	8.234	739.321
	5.295.815	29.609	62.097	300.465	434.435	6.122.421	1.547.721	1.007.584	30.954	2.586.259
Mjete	Morinë	Shishtëvec	Orgjost	Qafë- Prush	Qafë- Morinë	Total 2016	Muriqan	Hani i Hotit	Bashkim	Total 2016
Hyrje Mjete Shqiptare	261.756	2.063	2.514	51.450	64.439	382.222	85.950	104.661	1.759	192.370
Dalje Mjete Shqiptar	215.693	2.138	2.496	65.396	71.341	356.864	93.218	106.543	1.894	201.655
Hyrje Mjete te Huaj	550.289	454	162	15.940	31.792	598.577	165.215	123.192	3.981	292.388
Dalje Mjete te Huaj	627.998	448	159	8.868	27.438	664.911	159.538	117.227	3.428	280.213
	1.655.726	5.103	5.331	141.654	194.750	2.002.974	503.941	451.673	11.062	966.626

Tabela 1. Fluksi i shtetasve dhe automjeteve në pikat kufitare
Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme

1.2

KONSIDERATA NGA PPK & STRATEGJIA KOMBËTARE E TURIZMIT

1.2.1 Plani i Përgjithshëm Kombëtar 2015-2030

“PPK ofron kornizën strategjike referuese për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit për 15 vitet e ardhshme, me qëllim sigurimin e zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të vendit, menaxhimin e përgjegjshëm të burimeve natyrore të tij dhe mbrojtjen e mjedisit, duke siguruar njëkohësisht edhe përdorimin racional të tokës. Ky dokument përbën bazën për harmonizimin e politikave sektoriale dhe ndërsektoriale, të cilat kanë ndikim në territor apo shoqërohen me efekte në të, strukturën dhe balancon zhvillimet urbane dhe rurale si edhe ofron një klimë të besueshme për investimet afatgjata”.¹

Në këtë këndvështrim, është me vend evidentimi i rekomandimeve territoriale dhe të sektorit të turizmit që jepen nga PPK.

Bazuar në PPK, në pjesën veriore të Shqipërisë identifikohen dy zona të zhvillimit rajonal: poli i zhvillimit rajonal Shkodër - Lezhë, porta perëndimore e rajonit malor verior, dhe poli i zhvillimit rajonal Kukës - Has - Tropojë, porta lindore e rajonit turistik malor verior. Gjithashtu PPK përcakton edhe konsolidimin e zonës specifike të zhvillimit si Malësi e Madhe - Shkodër - Tropojë (ose zona e alpeve). Këto zona janë konsideruar të tilla për shkak të karakterit, veçorive dhe potencialit që kanë.

Në kuadër të PKST-Alpe, zona specifike e zhvillimit Malësi e Madhe - Shkodër - Tropojë evidentohet si një zonë më potencial të lartë zhvillimi të sektorit të turizmit, e lidhur ngushtë edhe me polin e zhvillimit rajonal Shkodër - Lezhë dhe Kukës - Has - Tropojë. PPK propozon që zhvillimi i këtyre dy poleve veriore të mbështetet jo vetëm në rolin e portave ekonomike kombëtare të rajonit të veriut, por edhe në zhvillimin dhe promovimin e turizmit malor në zonën e Alpeve Shqiptare.

Zhvillimi i qendrës primare të Shkodrës dhe fuqizimi i qytetit të Kukësit si qendër primare (falë mbështetjes së projekteve strategjike si p.sh. aeroporti i Kukësit, lidhja me qendrat kufitare të Kosovës, Prizren - Gjakovë - Pejë, rigjenerimi i aksit Fushë Arrëz - Tropojë etj.), do të ndikojë ndjeshëm në zhvillimin e zonës së alpeve dhe në ndërveprimin ekonomik ndërkufitar.

Elementet e forta natyrore si zonat e mbrojtura në vazhdimësi të parqeve të Malit të Zi dhe Kosovës, lumenjtë që krijojnë itinerarin ujor dhe itinerarin alpino - liqenor, brezi i gjelbër apo “korridorin blu”, janë faktorë që flasin për praninë e karakterit shumëdimensional të zonës, të fokusuar kryesisht në natyrë dhe me qëllim përdorimin e këtyre aseteve sipas standardeve për ngritjen e ekonomisë dhe krijimin e poleve të qëndrueshme dhe funksionale të kësaj zone.

a. Rajonizimi dhe polet ekonomike

Zona specifike e zhvillimit Malësi e Madhe - Shkodër - Tropojë është një nga rajonet më pak të zhvilluara por me një potencial të lartë për zhvillimin e turizmit malor. Razma, Thethi, Lugina e Valbonës, Curraj i Epërm, Sulbica dhe liqenet artificiale të Fierzës e Komanit janë ndër zonat më peizazhistike të rajonit.

Referuar kategorizimit të qendrave urbane sipas PPK, në zonën e studimit të PKST-Alpe përfshihen:

- Qendra sekondare urbane: Bajram Curri
- Qendra terciare urbane: Koplík, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz, Has
- Qendra lokale: Kelmend, Shkrel, Pult, Shosh, Shllak, Temal, Lekbibaj, Valbonë, Theth, etj.

Këto qendra, edhe pse shpesh me natyrë jourbane, karakterizohen nga tipare të veçanta të zhvillimit ekonomik, burimeve natyrore, minerare, vlerave të veçanta peizazhistike, kulturore e historike, etj.

¹ Plani i Përgjithshëm Kombëtar

Rajoni dallohet për një terren të përshtatshëm për zhvillimin e turizmit të tillë si:

- liqenor – përgjatë liqenit artificial të Komanit;
- ekoturizmi – qendrat si Bogë, Theth, Razëm dhe Vermosh;
- malor – në të gjithë zonën e alpeve;
- natyror – kanioni i Shoshanit, ujëvara e Grunasit, peizazhet panoramike të Valbonës dhe Nikaj - Mërturit, etj.

b. *Parashikimet referuar sistemeve territoriale dhe propozimet sipas PPK:*

Sistemi urban:

- Respektimi i hierarkisë së qendrave ku qytetet e Shkodrës dhe Kukësit propozohen si qendra primare me funksionin “portë hyrëse”, ndërsa qytetet e tjera si qendra sekondare e terciare.
- Konsolidimi i qendrave dhe densifikimi i zonave urbane/suburbane për të frenuar përhapjen urbane dhe informalitetin.

Sistemi natyror:

- Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura, duke i shtuar Rrjetin Emerald (Vermosh, Lëpushë, Bogë, Razëm, Tamarë, Nikç).
- Shpallja dhe promovimi i Parkut Kombëtar të Alpeve si park me rëndësi kombëtare dhe hartimi i politikave dhe instrumenteve financiare për nxitjen e zhvillimit të turizmit malor elitare.
- Shtirja e korridoreve natyrore përgjatë luginave të lumenjve dhe ekosistemeve të tyre.

Sistemi ujor:

- Përcaktimi i “vijës blu” dhe respektimi strikt i saj si kufiri i zonave mbrojtëse të të gjitha burimeve ujore, sipas përcaktimeve të legjislacionit sektorial në fuqi dhe Rregullores së Planifikimit, korrik 2015, në mënyrë që të mbrohet ekosistemi i zonës.
- Qendrat parësore dhe dytësore duhet të pajisen me një impiant të trajtimit të ujërave të ndotura.
- Mbulimi me shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve për zonat turistike dhe suburbane.
- Itinerari turistik vozitës lumor - liqenor, duke integruar vozitjen dhe lundrimin në një rrjet rekreativ.

Sistemi bujqësor:

- Krijimi i një tregu rajonal bujqësor i cili do të plotësojë zinxhirin ekonomikobujqësor në përpunimin e produkteve bujqësore (prodhim + përpunim + tregtim).

Sistemi infrastrukturor:

- Zhvillimi i qendrës së Koplikut si “hub logjistik”, për shkak të rolit kryesor, pozicionit kufitar si pikë grumbullimi e produkteve bujqësore dhe funksionit si stacion me rëndësi për njerëz e mallra.
- Integrimi dhe funksionimi me kapacitet të plotë sipas modaliteteve të stacioneve të rrjetit hekurudhor: Hani i Hotit, Bajzë, Koplik, Grilë dhe Milot si stacione mallrash, Shkodër dhe Lezhë si stacione qendrore, si dhe rigjallërimi i stacioneve për pasagjerë.
- Vlerësimi i potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë alternative, duke vlerësuar këtu që rrezatimi prej 2700 orë/vit të shfrytëzohet në ndërtimin e parqeve fotovoltaike.

1.2.2 Draft-Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2017-2022

Turizmi është një ndër sektorët më dinamikë në zhvillimin ekonomik botëror. Pavarësisht ndryshimeve pozitive të viteve të fundit, potencialit turistik dhe pozicionit të favorshëm të Shqipërisë në rajon, sektori i turizmit në Shqipëri përballet me problematika të ndryshme si mungesa e një produkti turistik konkurrues, mungesa e cilësisë dhe vlerësimit të shërbimeve, mungesa e marketingut dhe promovimit etj. Në këtë kuadër, hartimi i një strategjie kombëtare të zhvillimit të turizmit dhe një plani kombëtar sektorial të turizmit, shfaqet si prioritet për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm në vend.

MZHETTS² ka hartuar Draft-Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit 2017-2022, në të cilën propozohet vizioni strategjik i mëposhtëm:

“Shqipëria do të njihet si një destinacion turistik tërheqës, autentik dhe mikpritës në rajonin e Mesdheut dhe Evropë, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike të arritshme lehtësisht nga tregjet ndërkombëtare. Turizmi luan një rol kryesor në ekonominë shqiptare, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe duke krijuar një mjedis tërheqës për investimet”.³

Ky vizion bazohet në tre objektiva kryesore:

- **Objektivat ekonomike** synojnë të rrisin PBB-në, punësimin, kualifikimin e forcës punëtore, të ardhurat nga taksat dhe tatimet, të ardhurat nga udhëtimet, rritjen e numrit të bizneseve dhe investimeve, etj.
- **Objektivat cilësore** synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të përshpejtuar dhe afatgjatë, zhvillimin e produkteve turistike falë shërbimeve cilësore e të larmishme, zhvillimin e infrastrukturave lehtësuese dhe informuese për orientimin e flukseve turistike, krijimin e një imazhi turistik pozitiv dhe konkurrues, përmirësimin e cilësisë së jetës, aksesit dhe mbrojtjes së mjedisit etj.
- **Objektivat strukturore** synojnë të rrisin qëndrueshmërinë e turistëve në territor, evidencimin dhe orientimin drejt segmenteve turistike potenciale, diversifikimin e produkteve turistike, zhvillimin e industrisë së turizmit në tërësi, etj.

Këto objektiva do të përmbushen falë fushave kryesore të drejtimit strategjik:

- Marketingu (promovimi do të mbështetet në teknologjinë e informacionit dhe telekomunikacionit, markimin e produkteve turistike, etj.)
- Zhvillimi i produktit (produkti i turizmit bregdetar, kulturor, natyror, shëndetësor, kulinarisë, biçikletave, detar, rural dhe malor, ekoturizmit, sportit dhe aventurës, biznesit dhe konferencave, etj.)
- Zhvillimi i burimeve njerëzore (krijimi i strukturave të formimit dhe trajnimit profesional në fushën e shërbimeve dhe turizmit, etj.)
- Investimet (rritja e investimeve strategjike, përmirësimi i klimës së investimit, tërheqja e investimeve private, etj.)
- Menaxhimi i procesit të zbatimit dhe monitorimit të strategjisë së turizmit.

Megjithëse aktualisht turizmi bregdetar konsiderohet si produkti turistik më i rëndësishëm në Shqipëri, Draft-Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2017-2022, evidenton katër produkte turistike kryesore:

- Turizmi bregdetar, i cili bazohet në aktivitetet e “diellit dhe detit”;
- Turizmi i kulturës, i cili bazohet në vlerat historike e arkeologjike, trashëgiminë kulturore, trashëgiminë fetare, kulinarinë, folklorin, artin, etj.;
- Turizmi natyror, i cili bazohet në vlerat natyrore, mjedisore, ekologjike, florën dhe faunën, etj.;
- Turizmi MICE (Meetings-Incentives-Conferences-Events), bazuar në aktivitetin e konferencave, panairove, mbledhjeve, takimeve të biznesit, etj.

Krahas produkteve kryesore, evidencohen dhe produkte me ndikim në rritje, si:

- Turizmi detar
- Turizmi i biçikletave
- Turizmi shëndetësor
- Kulinaria
- Turizmi rural dhe malor
- Turizmi i sportit dhe aventurës
- Ekoturizmi

² Sot, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

³ Draft-Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2017-2022”

Zhvillimi i produkteve turistike synon të zgjerojë gamën e turistëve që vizitojnë Shqipërinë, duke u fokusuar në segmentet e moshave të reja (18-24 vjeç), familjarët, moshë e tretë, si dhe grupmosha 50-65 vjeç.

Diversifikimi i ofertës turistike kombëtare dhe afërsia gjeografike e produkteve të ndryshme turistike, mundëson pozicionimin e Shqipërisë si një destinacion tërheqës. Ashtu si theksohet në Draft-Strategjinë e Zhvillimit të Turizmit 2017-2022”, hartimi i një plani kombëtar sektorial për turizmin është hapi fillestar drejt vizionit strategjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të turizmit në vend.

Në këtë kontekst, Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit për Rajonin e Alpeve Shqiptare do të synojë t’i përgjigjet jo vetëm problematikave, objektive dhe orientimeve strategjike kombëtare, por dhe problematikave specifike të rajonit të Alpeve Shqiptare për 15 vitet e ardhshme. Planifikimi cilësor i kësaj zone është kushti kryesor për zhvillimin e turizmit afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

1.3

ZONAT E MBROJTURA MJEDISORE & TË TRASHËGIMISË KULTURORE


Zonat e rëndësisë së veçantë me interes në territorin e PKST-Alpe përbëhen nga Parku Kombëtar i Luginës së Valbonës, Parku Kombëtar i Thethit, Rezervati Strikt Natyror / Rezervat Shkencor i Luginës së Lumit të Gashit, Qendra Historike e Mbrojtur e Thethit, Zona e Mbrojtur Arkeologjike e Komanit, monumente natyrore, pasuri ujore, pyje e kullota, hidrocentrale, pika kufitare, monumente të trashëgimisë kulturore, qendra historike, etj.

Sot, si rezultat i një procesi riorganizimi të menaxhimit të parqeve, janë formuar tre parqe të reja që mbulojnë me shumë se 61% të sipërfaqes së zonës në studim. Këto parqe janë:

- Parku Kombëtar i Alpeve Shqiptare, kategoria e II-të, në të cilin përfshihen tre parqet ekzistuese: Parku Kombëtar i Luginës së Valbonës (me një sipërfaqe prej 8000 ha), Parku Kombëtar i Thethit (me një sipërfaqe prej 2,630 ha) dhe Rezervati Strikt Natyror i Luginës së Lumit të Gashit (me një sipërfaqe prej 3000 ha.)
- Parku Bashkiak Nikaj - Mërtur, kategoria IV e mbrojtjes, që korrespondon me të gjithë sipërfaqen e njësisë administrative Lekbibaj në Bashkinë Tropojë.
- Parku Bashkiak i Shkrelit, kategoria IV e mbrojtjes, që korrespondon me të gjithë sipërfaqen e njësisë administrative të Shkrelit në Bashkinë Shkodër.
- Ndërkohë, Bashkia Vau i Dejës ka nisur aplikimin për të shpallur liqenin artificial të Komanit si Park Rajonal, gjë që e shton akoma edhe më shumë sipërfaqen e zonave të mbrojtura që preken nga ky plan.

Prania e këtyre zonave dhe parqeve të mbrojtura me rëndësi kombëtare e rajonale, e bën sistemin natyror të ketë një trajtim të veçantë jo vetëm për nga rëndësia por edhe për nga vlerat unike të tij.

PKST-Alpe i konsideron këto zona si të rëndësishme për zhvillimin dhe promovimin e turizmit. Në këtë kontekst, PKST-Alpe do të bazohet në planet e menaxhimit të parqeve dhe ndërhyrjet e lejuara nga këta të fundit, si dhe me rekomandimet e ruajtjes së qendrave historike e arkeologjike. Në vijim po përmbledhim shkurtimisht një informacion mbi këto zona të rëndësisë kombëtare.



3. Rrjeti i zonave të mbrojtura

1.3.1 Parku Kombëtar i Alpeve


Parku Kombëtar i Alpeve Shqiptare (me një sipërfaqe prej 86.086,34 ha) shtrihet në territorin e tre bashkive: Malësisë së Madhe, Shkodrës dhe Tropojës. Gjeografikisht ky park është pjesë përbërëse e një parku më të madh që ndahet në tri shtete, në Malin e Zi si “Prokletije” dhe në Kosovë si “Bjeshkët e Nemuna”.

Plani i menaxhimit të propozuar për Parkun Kombëtar të Alpeve Shqiptare është hartuar në vitin 2015, dhe së bashku me dy parqet e tjera përtej kufirit do të kompletojnë zonat e mbrojtura të Alpeve Ballkanike.

Parku i alpeve ndahet në katër zona kryesore menaxhuese sipas hartës në vijim:

- Nën-zona qendrore, mbrojtje strikte
- Nën-zona e menaxhimit efektiv
- Nën-zona e përdorimit tradicional
- Nën-zona e zhvillimit të qëndrueshëm

Plani i menaxhimit ka përcaktuar në detaje funksionet, aktivitetet e lejuara, të kushtëzuara e të ndaluara si dhe procedurat dhe strukturat përkatëse.



4. Plani i menaxhimit. Parku Kombëtar i Alpeve

Emërtimi i zonave	Lejohet	Nuk lejohet
Zona qendrore	<ul style="list-style-type: none"> - Kërkimi shkencor, studimet dhe monitorimi sipas programeve të paracaktuara. - Janë të lejuara me autorizim të veçantë të AdPKN ndërhyrjet përmirësuese të përkohshme vetëm në rastet e fatkeqësive natyrore apo të shkaktuara nga njerëzit, zjarret, sëmundjet, dëmtuesit, largimin e mbetjeve të ngurta, plastike, inertet, etj., dhe të vendosjes së infrastrukturës për informimin e vizitorëve dhe të turistëve. 	Aktivitetet sociale, ekonomike dhe eko-turistike

Emërtimi i zonave	Lejohet	Nuk lejohet
Zona e menaxhimit efektiv	<ul style="list-style-type: none"> - Mundësi hyrëse për publikun e prirur për të respektuar kufijtë e zonës. - Zhvillimi i veprimtarive eko-turistike, argëtuese, sportive, shpirtërore dhe manifestime popullore, në mënyrë që të respektohen funksionet, vlerat ekologjike, peizazhi natyror-kulturor. - Grumbullimi i bimëve mjekësore, prodhimet e dyta pyjore, përdorimi i ujërave për pirje dhe sportet ujore, pasi merret pëlqimi i administratës së parkut. 	Veprimtaritë që shkaktojnë zaptime të territorit, shqetësime, dëmtime, ndotje dhe zhurma të theksuara
Zona e përdorimit tradicional	<ul style="list-style-type: none"> - Është e destinuar kryesisht për zhvillimin e veprimtarive tradicionale të banorëve të zonës, menaxhimin e tokës bujqësore, pemtarisë, blegtorisë, pyjeve të karakterit vendor, kullotat, ujërat, burimet e tjera natyrore, monumentet natyrore, kulturore e shpirtërore dhe peizazhi rural, në përputhje me objektivat e caktuara për parkun nga planet lokale të zhvillimit dhe PIM. - Mundësi hyrëse për publikun e prirur për të respektuar kufijtë e zonës dhe veprimtaritë shoqërore. - Kërkimi shkencor, studimet, monitorimi dhe veprimtaritë promovuese, edukative dhe ndërgjegjësuëse në lidhje me mënyrën e jetesës së banoreve, kulturën dhe historinë e tyre, praktikave ndërtimore, zakonet, ritet, këngët, vallet, veshjet, vlerat shpirtërore dhe prodhimet tradicionale. 	Zona duhet të garantojë që të mos çenohet ndërveprimi harmonik i natyrës me kulturën përmes mbrojtjes së cilësisë së peizazhit, përdorimit të kontrolluar e të vazhdueshëm të tokës, ujërave, pyjeve, kullotave, bimëve mjekësore dhe veprimtarive artizanale.
Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm	<ul style="list-style-type: none"> - Banorët dhe biznesi mund të vazhdojnë mënyrën e tyre të jetesës, të praktikave ndërtimore, zhvillimin e veprimtarive sociale e kulturore karakteristike, tradicionale dhe agro-turistike. - Subjektet private, publike dhe çdo individ mund të kryejë veprimtari ekonomike nën monitorimin e organeve kompetente shtetërore, të administratës dhe të qeverisjes vendore, vetëm nëse ato përputhen me strategjinë e zhvillimit të qëndrueshëm, me të gjithë rregullat e administrimit të parkut dhe të kontrollit të planifikuar. 	

- Kërkojnë miratim nga organet shtetërore kompetente të projekteve përdorimi i ujërave sipërfaqësore, nëntokësore dhe i burimeve për nevoja urbane, bujqësore, akuakulturë, peshkim, industriale, tregtare, HEC, eko-turizëm dhe për qëllime të tjera.

- Mundësi hyrëse për publikun e prirur për të respektuar kufijtë, veprimtaritë shoqërore dhe të zbavitjes në natyrë të hapur.


Tabela 2. Zonat e lejimit dhe përjashtimit për Parkun Kombëtar të Alpeve

1.3.2 Parku Bashkiak Nikaj-Mërtur

Parku Natyror Bashkiak Nikaj-Mërtur përfaqëson një zonë unike përsa i përket peizazhit dhe gërshetimit të vlerave natyrore me ato kulturore.

Sipas planit të menaxhimit, parku përbëhet nga këto nën-zona menaxhimi:

- Zona qendrore
- Zonat e përdorimit tradicional
- Zona e zhvillimit të qëndrueshëm



5. Parku bashkiak Nikaj-Mërtur. Plani i menaxhimit

Emërtimi i zonave	Lejohet	Nuk lejohet	Aktivitetet që kërkojnë miratim
Zona qendrore	<ul style="list-style-type: none"> - Monitorimi shkencor si pjesë e sistemit të monitorimit ekologjik. - Menaxhimi thelbësor si kontrolli e largimi i specieve jo-native, duke përfshirë largimin e plehrave dhe mirëmbajtjen e shtigjeve. - Do të lejohet akses për shkencëtarët /menaxherët që ndërmarrin aktivitetet e përshkruara të monitorimit për të asistuar objektivat e menaxhimit. - Akses i kufizuar dhe i kontrolluar publik për aktivitetet me bazë edukuese e natyrore, përfshirë aksesin publik me guida kur është e përshtatshme. 	<ul style="list-style-type: none"> Peshkimi, gjuetia, korrja dhe grumbullimi i paautorizuar i bimëve mjekësore e prodhimeve të tjera pyjore e jo-pyjore, shkatërrimi apo cënimi i florës e faunës së egër indigjene. - Menaxhimi i habitatit përveç kontrollit/largimit të specieve të huaja. - Kullotja e bagëtive dhe çdo formë bujqësie. - Aktivitetet pyjore - Hyrja e paautorizuar me çdo lloj automjeti - Shkarkimi i plehrave - Ndërtimi e operimi i strukturave industriale - Ndërtimi i vendbanimeve - Çdo përdorim kimikatesh (fertilizues, biocide, etj.), largimi i agregateve dhe futja e specieve të huaja. 	<p>Aktivitetet që nuk janë as të lejuara e as qartësisht të papajtueshme me qëllimet e zonës, përfshirë monitorimin dhe kërkimin e papërcaktuar shkencor që nuk është pjesë e sistemit të monitorimit ekologjik, me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e rezervës.</p>
Zona e përdorimit tradicional	<ul style="list-style-type: none"> - Zonat formale të shërbimit për piknik - Godinat e shërbimit e qendrat e vizitorëve - Parkingu i makinave, zonat e shërbimit dhe kampingut - Zonat me fusha të vogla sporti - Ndërtesat e vogla të hoteleve e restoranteve - Akses i pakufizuar për ecje - Alpinizmi, kalërimi dhe aktivitetet e tjera argëtuese me bazë ekologjike dhe natyrore 	<ul style="list-style-type: none"> Aktivitetet në kundërshtim me qëllimet e zonës, përfshirë: - Gjuetinë - Korrjen - Grumbullimin e paautorizuar - Shkatërrimin ose cënimin e faunës dhe florës së egër indigjene; - Menaxhimin e habitatit përveç kontrollit të specieve jo-native; - Kullotjen e bagëtive dhe çdo formë bujqësie; - Aktivitetet pyjore; 	<p>Aktivitet që nuk janë as të lejuara e as qartësisht të papajtueshme me qëllimet e zonës, përfshirë monitorimin dhe kërkimin e papërcaktuar shkencor me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e parkut, ndërtimin e vendbanimeve dhe strukturave shoqëruese të përcaktuara për përdorime turistike të menaxhuara të parkut,</p>

Emërtimi i zonave	Lejohet	Nuk lejohet	Aktivitetet që kërkojnë miratim
	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillimi i turizmit me bazë komuniteti si hotelet familjare dhe kthimi i godinave ekzistuese tradicionale në godina turizmi - Kampimi gjatë natës do të lejohet në zona të caktuara në përputhje me rregulla të caktuara. - Aksesimi për qëllime kërkimi, edukimi, trajnimi, monitorimi, me objektiva të përcaktuara. - Menaxhimi do të kufizohet në aktivitetet thelbësore si luftimi i zjarrit, kontrolli i specieve të huaja dhe në menaxhimin e ndikimit të vizitorëve duke përfshirë heqjen e plehrave, mirëmbajtjen e shtigjeve, kontrollin e erozionit dhe mirëmbajtjen e zonave të kampimit. 	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i vendbanimeve përveç atyre të autorizuara specifikisht për përdorime turistike të menaxhuara të parkut; - Ndërtimi i hoteleve komerciale, restoranteve, parkimeve, fushave të lojës dhe sportit, - Ndërtimi dhe operimi i strukturave industriale, guroret, minierat, nxjerrja e agregatëve dhe futja e specieve të huaja. 	<p>struktura të tjera të përcaktuara për turizëm dhe infrastruktura e shoqëruar me aktivitet komunale me bazë ekoturizmi.</p>
Zona e zhvillimit të qëndrueshëm	<ul style="list-style-type: none"> - Aktivitete aktuale ekonomike me kusht që të përputhen me të gjithë rregulloret e kontrollit e planifikimit të mjedisit, por dekurajohen zhvillimet e mëtejshme përveç atyre të lidhura me turizmin. - Kullotja e bagëtive dhe çdo formë e bujqësisë tradicionale - Përdorimi i pyjeve dhe kullotave me kushtin që të kenë miratimin e planeve komunale të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave të zonës, ose planeve specifike në 	<ul style="list-style-type: none"> - Grumbullimi i paautorizuar, shkatërrimi, apo cënimi i florës e faunës së egër - Shkarkimi dhe largimi i agregateve - Ndërtimi dhe operimi i strukturave industriale (pa studim VNM dhe leje mjedisore) - Futja e kultivimi i specieve të huaja të florës dhe faunes 	<p>Aktivitet që nuk janë as të lejuara e as qartësisht të papajtueshme me qëllimet e zonës, përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja e produkteve pyjore (p.sh. bimë mjekësore, kërpudha, mjaltë) - Monitorimi dhe kërkimi shkencor i papërcaktuar me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e parkut. <p>Aktivitetet që duhet të kenë VNM para aprovimit të mundshëm nga Autoriteti i Menaxhimit të Parkut</p>

Emërtimi i zonave	Lejohet	Nuk lejohet	Aktivitetet që kërkojnë miratim
	<p>funksion të parkut.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grumbullimi i druve të zjarrit e produkteve pyjore jo drunore (p.sh. kërpudha, bimë mjekësore, mjaltë) - Akses i pakufizuar për shëtitje, hipizem, vëzhgimi i zogjve, kanotazhi, garat sportive etj. - Kampimi gjatë natës do të lejohet në zona të caktuara në përputhje me rregullat përkatëse. - Përdorimi për qëllime edukimi, trajnimi dhe monitorimi - Menaxhim habitati duke përfshirë luftën ndaj zjarreve, kontrolli/largimi i specieve të huaja dhe menaxhimi i efekteve të vizitorëve, kontrolli i erozionit, mirëmbajtja e zonave të kampimit 		<p>përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndërtimi i vendbanimeve të reja, godinat e vizitorëve dhe infrastrukturës së turizmit, turizmi familjar dhe strukturat e tjera të turizmit, ndërtimi e rindërtimi i banesave me arkitekturë tradicionale për banorët vendas, godinat bujqësore, kufizimet e tokave përfshirë gardhet dhe muret me materiale jonatyrore dhe që shkaktojnë ndotje të peizazhit etj., çdo përdorim kimikatesh (fertilizim, biocide, etj.) dhe aktivitetet pyjore që nuk janë objekt miratimi nga planet komunale të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave. - Gjuetia e kontrolluar nga banorët lokalë, subjekte të monitorimit shkencor etj.

Tabela 3. Zonat e lejitimit dhe përjashtimit nga PM për Parkun Bashkiak Nikaj Mërtur


1.3.3 Parku Bashkiak i Shkrelit

Parku Natyror Bashkiak i Shkrelit ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 20.282 ha. Zona paraqet një potencial të madh në lidhje me zhvillimin e turizmit, bujqësinë dhe arkitekturën tradicionale të zonës. Në mënyrë të veçantë, arkitektura dhe peizazhi janë dy elementet që tërheqin më shumë turistët.

Zonimi i parkut përfaqëson një element shumë të rëndësishëm të tij. Ai ka si qëllim identifikimin e vlerave të veçanta të parkut dhe mundësinë për të aksesuar këto vlera. Gjithashtu zonimi parashikon edhe kufizimet përkatëse në rast se këto vlera çenohen. Gjithashtu zonimi ka si qëllim edhe identifikimin e aktiviteteve menaxhuese dhe prioriteteve përkatëse të tyre.

Parku ndahet në katër zona kryesore:

- Zona qendrore – e cila nga pikëpamja e vlerave natyrore dhe kulturore përfaqëson elementet më të rëndësishme të tyre.
- Zona e zhvillimit të qëndrueshëm - ku parashikohen aktivitete të ndryshme që do të zhvillohen në harmoni të plotë me natyrën, kulturën dhe traditat e zonës.
- Zona e përdorimit tradicional – përfaqëson zonën e cila do të ndjekë të njëjtën rrjedhë zhvillimi ashtu siç ka qenë deri tani, duke kufizuar vetëm aktivitetet intensive që shihen si çënuese të vlerave të parkut.
- Zona e shërbimit për vizitorët – përfaqëson një zonë me ndërtime (bare, restorante, hotele) dhe që është në funksion të vizitorëve.



5. Parku Bashkiak i Shkrelit. Plani i menaxhimit

Emërtimi i zonave	Lejohet	Nuk lejohet	Aktivitetet që kërkojnë miratim
Zona qendrore	<p>- Monitorimi shkencor si pjesë e sistemit të monitorimit ekologjik dhe menaxhimit thelbësor si kontrolli/largimi i specieve jo-native, duke përfshirë largimin e plehrave dhe mirëmbajtjen e shtigjeve.</p> <p>- Akses i përshkruar për ndërmarrin aktivitetet e përshkruara të monitorimit për të asistuar objektivat e menaxhimit.</p> <p>- Akses i kufizuar dhe i kontrolluar publik për aktivitete me bazë edukuese e natyrore, përfshirë aksesin publik me guida kur është e përshtatshme.</p>	<p>- Peshkimi, gjuetia, korrja dhe grumbullimi i paautorizuar i bimëve mjekësore e prodhimeve të tjera pyjore e jo pyjore, shkatërrimi apo cënimi i florës e faunës së egër indigjene.</p> <p>- Menaxhimi i habitatit përveç kontrollit/largimit të specieve të huaja</p> <p>- Kullotja e bagëtive dhe çdo formë bujqësie</p> <p>- Aktivitetet pyjore</p> <p>- Hyrja e paautorizuar e çdo automjeti</p> <p>- Shkarkimi i plehrave</p> <p>- Ndërtimi e operimi i strukturave industriale</p> <p>- Ndërtimi i vendbanimeve</p> <p>- Çdo përdorim kimikatesh (fertilizues, biocide, etj.)</p> <p>- Largimi i aggregateve dhe futja e specieve të huaja</p>	Aktivitetet që nuk janë as të lejuara e as qartësisht të papajtueshme me qëllimet e zonës, përfshirë monitorimin dhe kërkimin e papërcaktuar shkencor që nuk është pjesë e sistemit të monitorimit ekologjik, me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e rezervës.
Zona e përdorimit tradicional	Përforcimi i zonës sensitive për të lejuar vizitorët e shumtë është lejuar në varësi të marrëveshjeve të hartuara, ku strukturat përfshijnë: zona formale shërbimi për piknik, godina shërbimi e qendra vizitorësh, parking makinash, zona shërbimi kampimi, zona me fusha të vogla sporti, ndërtesa të vogla hoteli e restorantesh; akses i pakufizuar për ecje, alpinizëm, kalërim dhe	Aktivitetet në kundërshtim me qëllimet e zonës, përfshirë gjuetinë, korrjen, grumbullimin e paautorizuar, shkatërrimin ose cënimin e faunës dhe florës së egër indigjene, menaxhimin e habitatit përveç kontrollit të specieve jo-native, kullotjen e bagëtive dhe çdo formë bujqësie aktivitetet pyjore, ndërtimin e vendbanimeve përveç	Aktivitetet që nuk janë as të lejuara e as qartësisht të papajtueshme me qëllimet e zonës, përfshirë: mbledhja e produkteve pyjore (p.sh bimë mjekësore, kërpudha, mjaltë), monitorimi e kërkimi shkencor i papërcaktuar me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e parkut. Aktivitetet që duhet të kenë VNM para aprovimit të mundshëm nga Autoriteti i Menaxhimit të Parkut

Emërtimi i zonave	Lejohet	Nuk lejohet	Aktivitetet që kërkojnë miratim
	<p>aktivitete të tjera argëtuese me bazë ekologjike dhe natyrore. Zhvillimi i turizmit me bazë komunitare si hotelet familjare dhe konvertimi i godinave ekzistuese tradicionale si godina turizmi. Kampimi gjatë natës do të lejohet në zona të caktuara në përputhje me rregulla të caktuara. Do të lejohet aksesimi për qëllime kërkimi, edukimi, trajnimi dhe monitorimi me objektiva të përcaktuara. Menaxhimi do të kufizohet në aktivitetet thelbësore si luftimi i zjarrit, kontrolli i specieve të huaja dhe në menaxhimi i ndikimit të vizitorëve duke përfshirë heqjen e plehrave, mirëmbajtjen e shtigjeve, kontrollin e erozionit, mirëmbajtjen e zonave të kampimit.</p>	<p>atyre të autorizuara specifikisht për përdorime turistike të menaxhuara të parkut, ndërtimin e hoteleve komerciale, restoranteve, parkimeve, fushave të lojës dhe sportit, ndërtimin dhe operimin e strukturave industriale, guroret, minierat, nxjerrjen e agregatëve dhe futjen e specieve të huaja.</p>	<p>përfshijnë: ndërtimin e vendbanimeve të reja, godinat e vizitorëve dhe infrastrukturën e turizmit, turizmin familjar dhe struktura të tjera turizmi, ndërtimin e rindërtimit e banesave me arkitekturë tradicionale për banorët vendas, godinat bujqësore, kufizimet e tokave përfshirë gardhet dhe muret me materiale jo-natyrore dhe që shkaktojnë ndotje të peizazhit etj., çdo përdorim kimikatesh (fertilizim, biocide, etj.) dhe aktivitetet pyjore që nuk janë objekt aprovimi nga planet komunale të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave. Gjuetia e kontrolluar nga banorët lokalë, subjekte të monitorimit shkencor etj.</p>
<p>Zona e zhvillimit të qëndrueshëm</p>	<p>Lejohen aktivitetet aktuale ekonomike me kusht që të përputhen me gjithë rregulloret e kontrollit e planifikimit të mjedisit por dekurajohen zhvillimet e mëtejshme përveç atyre të lidhura me turizmin. Aktivitetet kryesore mund të jenë kullotja e bagëtive dhe çdo formë e bujqësisë tradicionale; përdorimi i pyjeve dhe kullotave me kushtin që</p>	<p>Aktivitetet në kundërshtim me qëllimet e zonës, duke përfshirë: grumbullimin e paautorizuar, shkatërrimin apo cënimin e florës e faunës së egër natyrore, shkarkimin, largimin e agregatëve, ndërtimin dhe operimin e strukturave industriale (pa studim VNM dhe leje mjedisore) dhe futjen e kultivimit e</p>	<p>Aktivitetet që nuk janë as të lejuara e as qartësisht të papajtueshme me qëllimet e zonës, përfshirë: mbledhja e produkteve pyjore (p.sh bimë mjekësore, kërpudha, mjaltë), monitorimi e kërkimi shkencor i papërcaktuar, me kusht që efektet e tij të mos dëmtojnë qëllimet e parkut. Aktivitetet që duhet të kenë VNM para aprovimit të mundshëm</p>

Emërtimi i zonave	Lejohet	Nuk lejohet	Aktivitetet që kërkojnë miratim
	<p>të kenë miratim e planeve komunale të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave të zonës ose plane specifike në funksion të parkut. Grumbullimi i druve të zjarrit e produkteve pyjore jo drunore (p.sh. kërpudha, bimë mjekësore, mjaltë) mund të jenë aktivitete të tjera të mundshme, si edhe aksesimi i pakufizuar për shëtitje, hipizmi, vëzhgimi i zogjve, kanotazhi, garat sportive etj. Kampimi për natën do të lejohet në zona të caktuara në përputhje me rregullat përkatëse. Përdorimi për qëllime edukimi e trajnimi dhe monitorimi të përcaktuar, menaxhim habitati duke përfshirë luftën ndaj zjarreve, kontrolli e largimi i specieve të huaja dhe menaxhimi i efekteve të vizitorëve, kontrolli i erozionit dhe mirëmbajtja e zonave të kampimit.</p>	<p>specieve të huaja të florës dhe faunës.</p>	<p>nga Autoriteti i Menaxhimit të Parkut përfshijnë: ndërtimin e vendbanimeve të reja, godinat e vizitorëve dhe infrastrukturën e turizmit, turizmin familjar dhe strukturat e tjera të turizmit, ndërtimin e rindërtimin e banesave me arkitekture tradicionale për banorët vendas, godinat bujqësore, kufizimet e tokave përfshirë gardhet dhe muret me materiale jonatyrore që shkaktojnë ndotje të peizazhit etj. Çdo përdorim kimikatesh (fertilizim, biocide, etj.) dhe aktivitetet pyjore që nuk janë objekt miratimi nga planet komunale të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave. Gjuetia e kontrolluar nga banorët lokalë, subjekte të monitorimit shkencor etj.</p>
<p>Zona e shërbimit për vizitorët</p>	<p>Është e dedikuar për zhvillimin e infrastrukturës turistike, por jo pa rregullore. Këto rregullore duhet të miratohen dhe të vendosen nga këshilli bashkiak / i njësisë vendore në bashkëpunim të ngushtë me administratën e parkut dhe të bordit të menaxhimit të Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit. Në përgjithësi, turizmi në zonën e zhvillimit të qëndrueshëm është i bazuar kryesisht në shtëpi pritjeje (<i>guest houses</i>), shërbime për fjetje dhe ushqime, ndërsa në zonën e shërbimit për vizitorët turizmi është i bazuar në hotele dhe njësi më të mëdha të shërbimeve turistike.</p>		

Tabela 4. Zonat e lejimit dhe përjashtimit nga PM për Parkun Bashkiak të Shkrelit

1.3.4 Thethi - Qendër e mbrojtur historike

Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, me vendimin nr. 76, datë 11.4.2017, në mbështetje të nenit 28 dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar me propozimin e Institutit të Monumenteve të Natyrës, vendosi:

- Miratimin e propozimit për shpalljen “Qendër Historike të Thethit dhe rregulloren për administrimin e saj”.

Qendra historike e fshatit Theth që propozohet, është pjesa me vlera urbanistiko - arkitektonike e fshatit e cila mbart vlera të rëndësishme historike. Ajo dokumenton rrugën e zhvillimit historik të fshatit drejt krijimit të një qendre të banuar dhe tiparet urbanistiko - arkitekturore që u formuan gjatë historisë së saj. Pjesa dërrmuese e fshatit ruan ndërtime të vjetra me vlera arkitektonike e konstruktive dhe rrjetin karakteristik rrugor. Këto ndërtime janë të lidhura me mjedisin tradicional i cili është pjesë e qendrës historike. Brenda kësaj qendre përfshihen monumente kulturore të kategorisë së parë, si banesa e Lulash Kecit (Muzeu Etnografik i Dukagjinit), kulla e Nikollë Zef Koçekut (kulla e ngujimit), etj.

Krahas këtyre ndërtimeve, në këtë zonë janë ndërtuar banesa që ndonëse nuk kanë numër të madh ambientesh, dallohen nga përpunimi mjaft më i pasur arkitektonik. Këto ndërtime janë më të vonshme dhe të përhapura në zona të kufizuara si në Theth të Dukagjinit e Vermosh të Kelmendit.



7. Zona e shpallur, Qendër e Mbrojtur Historike e Thethit

1.3.5 Monumente kulture dhe natyre në zonë

Edhe pse trashëgimia kulturore e Shqipërisë së veriut është padyshim domethënëse dhe komplekse, vetëm disa zona me trashëgimi kulturore të palëvizshme janë mbrojtur zyrtarisht. ⁴Në zonën e PKST-Alpe mund të përmendim një sërë monumentesh kulture :

Bashkia Tropojë - Kalaja e Shoshanit, Kalaja e Lekës, Qyteza e Rosujës, Shpella e Dragobisë, Mulliri i Bajram Currit, Banesa e Mehmet Ramës, Banesa e Bajram Osunit, Banesa e Sali Manit, Kulla e Mic Sokolit.


Bashkia Shkodër - Banesa e Lulash Kecit, Banesa e Ndue Mark Kolës, Banesa e Marash Kolës, Banesa e Shkurte Aliajt, Banesa e Zef Koçekut.


Bashkia Vau i Dejës - Banesa e shkrimtarit Martin Camaj, Kalaja e Dalmaces, Varrezat e lashta të Komanit.

Bashkia Malësia e Madhe - Kalaja e Ballecit, Ura e Tamarës mbi lumin e Cemit dhe hani pranë saj.

Monumentet e natyrës janë të pranishme kudo në zonë duke përbërë një nga potencialet kryesore të rajonit. Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare", përcaktohen 88 monumente natyrore brenda territorit që prek PKST-Alpe, si: burime ujore, cirqe akullnajore, grupe drurësh dhe habitatesh, gurë dhe shkëmbinj me forma krateri, hinka dhe gropa karstike, kanione, gryka dhe ura shkëmbore, liqene akullnajore, lugina dhe lugje akullnajore, shpella karstike, tarraca dhe morene akullnajore, ujëvara, etj.

⁴ Burimi: Ministria e Kulturës





KOSOVË

DEÇ

PLAVË

GUCI

Vendkalimi kufitar
Vermosh-Guci

Vendkalimi kufitar
Qafa e Vranicës-Plavë

MARGEGAJ

TROPOJË

Vendkalimi kufitar
Qafa Morinë-Gjakovë

SHALË

BUJAN

BAJRAM CURRI

BASHKIA SHKODËR

LEKBIBAJ

BASHKIA TROPOJË

SHOSH

TEMAL

BASHKIA FUSHË

BASHKIA VAU I DEJËS

SHLLAK

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

LEGJENDË

Monumentet e natyres, klasifikimi

- Liqen akullnajor
- Dru
- Kanyon
- Luginë e Luginë akullnajoresh
- Buriu
- Gme
- Shpellë karstike
- Rrase
- Terrace
- Ujera
- Cirk akullnajor
- Hinë, gropë, pus

Monumentet e kultures

- Bashkia Tropojë:** Kalaja e Stoshanit, Kalaja e Lekës, Qyteza e Rosujës, Shpella e Dragobisë, Mulliri i bajram Currit, Banesa e Melmet Rumbës, Banesa e Bajram Osunit, Banesa e Sali Mani, Kulla e Mic Sokolit.
- Bashkia Shkodër:** Banesa e Lutash Kecit, Banesa e Nduc Mark Kolës, Banesa e Marush Kolës, Banesa e Shkurte Alja, Banesa e Zef Koçekut.
- Bashkia Vau i Dejës:** Banesa e Shkrimtarit Martin Cunoj, Kalaja e Dalmaces.
- Vatërrëz e Lashtë të Komunit.**
- Bashkia Malësi e Madhe:** Kalaja e Ballecit, Ura e Taurës rabi Iuam Ceruit, Vukërit dhe Hami prave sej.

1.3.6 Kufizime të tjera


Kufijtë e planifikimit të PKST-Alpe prekin një sërë elementesh të rëndësishme kombëtare dhe rajonale, të cilat nga rëndësia përcaktojnë nëse mund të zhvillohen në një zonë të caktuar. Për këtë janë marrë në konsideratë ligje dhe VKM nga sektorë të ndryshëm në varësi të elementeve që ndodhen në zonë.


Zakonisht këto elemente përbëhen nga zona me karakteristika të ndryshme zhvillimi dhe breza të rezervuar, ku në varësi të kuptimit në legjislacione të ndryshme shfaqen si breza të rezervuar, brigje apo zona “buferike”.

Harta në vijim përcakton territoret ku zhvillimi është i kushtëzuar nga këto elemente:

- parqet kombëtare dhe bashkiake (orientime, kushtëzime apo ndalime sipas secilës nën-zonë të parkut përkatës);
- zona e mbrojtur e Thethit ku aplikohet rregullore specifike;
- zonat e mbrojtura përgjatë lumenjve, përrinjve dhe ujërave në përgjithësi;
- zonat e kufizimeve pranë infrastrukturës kryesore;
- identifikimi i monumenteve dhe distancat mbrojtëse pranë tyre deri në formulimin e studimeve specifike nga strukturat përkatëse.

Zbërthimi i mëtejshëm i PKST-së së Alpeve nga planet e përgjithshme vendore ose nga plane sektoriale të infrastrukturës dhe shërbimeve publike, do të detajojë e plotësojë më tej këtë informacion, duke dhënë një panoramë shumë të qartë për bashkitë në mundësitë për zhvillim të territorit.





KOSOVË

PLAVE

Vendkalimi kufitar
Vermosh-Guci

GUCI

Vendkalimi kufitar
Qafa e Vranices - Plave

Vendkalimi kufitar
Qafa Morinë - Gjakovë

Iballë

LEGJENDE

Planifikimi

- Kufi planifikimi PKST Alpe
- QYTET
- FSHAT
- Qendra Historike Tërth
- Curraj | Ederri. ZONE ME RENDESIE KOMBETARE
- SHTIGUJE

BREZ | REZERVUAR, INFRASTRUKTURE

- B
- C
- BREZ | REZERVUAR, VENDBANIME

INFRASTRUKTURE

- B
- C
- E
- F
- SH_B
- SH_A
- SH_S
- MORFOLOGJIA MBI 1700 m
- Rrjet_Hidro
- Hidrografia_Bufler_20m
- Hidrografia_Bufler_50m
- Hidrografia_Bufler_100m
- Hidrografia_Bufler_200m

Zonimi | parqeve / zonave te mbrojtura

Zonimi PK Alpe

- Zona Qendrore
- Zona e Mikrozonave Eshelje
- Zona e Periferiare Tërthore
- Zona e Zhvenditje Qendrore

Zonimi Parku Bashkiak Nikaj - Murtur

- Mirreprejvite
- Zhvillim i Qendrore
- Vendbanim Tërthore

Zonimi Parkut Bashkiak Shkrel

- Zona Qendrore
- Zona e Zhvenditje te Qendrore
- Zona e Periferiare Tërthore
- Zona e Zhvenditje te Periferiare

1.3

VIZIONI & ORIENTIMET STRATEGJIKE

“Në 2031, Alpet e Shqipërisë do të jenë një rajon që manifeston ekuilibrin midis njeriut dhe natyrës, që ruan vlerat mjedisore dhe promovon identitetin, trashëgiminë kulturore e historike, duke zhvilluar një turizëm të qëndrueshëm që i përgjigjet tregut dhe nevojave socio-ekonomike, duke u bazuar në hierarkinë e qendrave të specializuara që funksionojnë si një rrjet organik.

Kështu, “Bjeshkët e Nemuna” do të jetë një rajon ku kërkuesit e eksperiencave, udhëtarët, vizitorët dhe banorët e zonës do të sigurohen që malet janë vendi nga ku shikojmë si ka qenë bota pa ne dhe si do të jetë në të ardhmen ”

- *“manifeston ekuilibrin midis njeriut dhe natyrës”* – qëllimi i këtij plani është zhvillimi i një turizmi të qëndrueshëm që do jetë në harmoni me mbrojtjes së mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe mirëqenies së komunitetit vendas.
- *“kërkuesit e eksperiencave, udhëtarët, vizitorët dhe banorët e zonës”* – do të jenë të shumtë personat që frekuentojnë Alpet e Shqipërisë, gjë që flet për një rajon ku mund të gesh natyrën, pushimin dhe kushtet e veçanta të jetesës e turizmit.
- *“ruan, promovon, zhvillon”* – Alpet e Shqipërisë janë një krahinë e cila ka mundësi të konkurrojë në rang vendi dhe rajoni duke bashkëpunuar me aktorët vendas dhe ndërkuftarë për të arritur një ekonomi dhe turizëm të qëndrueshëm. Në të njëjtën kohë, ky rajon ruan vlerat kulturore dhe trashëgiminë së bashku me potencialet natyrore që kanë zonat e mbrojtura, duke i promovuar dhe zhvilluar në bazë të karakterit dhe identitetit që mbar-tin.
- *“si ka qenë bota pa ne dhe si do të jetë në të ardhmen”* – qëllimi i këtij plani është që rajoni i Alpeve të Shqipërisë t’i shërbeje jo vetëm komunitetit dhe vizitorëve të sotëm, por gjithashtu të sigurohet që brezat e ardhshëm do të kenë mundësinë të shijojnë këtë zonë dhe të njihen me historinë, vlerat dhe traditat e saj.
- *“hierarkia e qendrave të specializuara”* – në zonën e PKST-Alpe mendohet të krijohet një hierarki qendrash bazuar në specializimin e tyre sipas karakterit dhe potencialit që mbar-tin.
- *“rrjet organik”* – pavarësisht shumëllojshmërisë së sistemeve territoriale, zona e Alpeve të Shqipërisë do të funksionojë si një sistem organik i mirëkoordinuar në nivel rajonal dhe vendor.

Alpet Shqiptare do të hyjnë në një cikël të ri të zhvillimit të turizmit me një qasje tjetër territoriale më të ekuilibruar, me qëllim ruajtjen e mjedisit, një ekonomi lokale të integruar me industrinë e turizmit dhe një industri të suksesshme turistike të fokusuar në segmentet e turizmit natyror dhe kulturor.

Deklarata e mësipërme për vizionin e Alpeve Shqiptare është gjithashtu në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2017-2022, ku zona e alpeve është identifikuar për segmentet e sipërpërmendura të kërkesës për turizëm. Për më tepër, e njëjta gjë vjen nga analiza e situatës aktuale, si dhe nga vlerësimi i kërkesës së tregut të turizmit të kryer nga ekipi i punës në verën e vitit 2016.

Vizioni i zhvillimit ka për qëllim parashikimin e së ardhmes së planifikuar të alpeve, duke përshkruar karakteristikat e zonës nëse ky plan përmbushet me sukses. Konkretisht, Alpet Shqiptare do të presin çdo vit një numër më të lartë turistësh që do të përfitojnë nga shërbime cilësore të larmishme në lokalitete të specializuara e me avantazhe konkurruese.

Vizioni synon alpe lehtësisht të aksesueshme dhe të përmirësuara në aspektin e shërbimeve dhe cilësisë, si për turistët ashtu edhe për banorët vendas. Ndërkohë, zonat e mbrojtura natyrore do të akomodojnë segmente të veçanta të turizmit natyror dhe ekologjik. Ky segment i turizmit natyror dhe ekologjik do të jetë në përputhje me ofertën e kapaciteteve akomoduese brenda kuadrit të qëndrueshmërisë. Segmenti i synuar mund të jetë më i vogël për nga numri i turistëve por më i lartë për nga shpenzimet dhe ndërgjegjësimi ndaj mjedisit. Vizioni i mësipërm do të zërthehet në tre objektiva strategjike:

OS1. EKUILIBËR MIDIS NATYRËS DHE ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Turizmi shpeshherë stimulon masat për të mbrojtur ose ruajtur natyrën, por paralelisht aktivitetet e këtij sektori paraqesin një rrezik të konsiderueshëm për sa i përket ndikimit mjedisor. Zhvillimi i industrisë së turizmit është i lidhur ngushtë me parqet dhe sistemin natyror, ndërkohë që ndikimi mjedisor i aktiviteteve turistike intensifikohet me rritjen e kërkesës turistike. Kështu, marrëdhënia mes aktivitetit turistik dhe mjedisit duhet të garantojë një efekt reciprok pozitiv.

Evidentohen disa lloj marrëdhëniesh ndërmjet turizmit dhe mbrojtjes së natyrës: marrëdhënie konfliktuale, bashkëjetuese dhe simbiotike.

- Marrëdhënia konfliktuale ndodh kur zhvillimi i turizmit shfaq vetëm efekte të dëmshme në mjedis.
- Bashkëjetesa ndodh kur të dyja palët përfitojnë efekte pozitive. Gjithsesi, kjo bashkëjetesë duket e rrallë për t'u arritur, sidomos për raste si ai i turizmit malor në alpe, kërkesa për të cilin vjen gjithmonë duke u rritur.
- Marrëdhënia simbiotike arrihet kur përfitimet si për turizmin dhe ruajtjen e natyrës arrijnë në një ekuilibër.

Turizmi dhe zonat e mbrojtura në këtë rajon do të synojnë një marrëdhënie simbiotike, pasi zona të tilla ofrojnë vlera, mjedis dhe burime tërheqëse për vizitorët. Turizmi i qëndrueshëm kërkon medoemos ruajtjen e natyrës, dhe në këtë mënyrë mund të mbështesë mirëmbajtjen ose përmirësimin e zonave natyrore dhe rritjen e parashikuar të prurjes së vizitorëve. Nga ana tjetër, burimet apo potencialet natyrore nuk do të mund të promovohen dhe të vlerësohen nëse nuk ka turizëm. Një objektiv i tillë është jetik si për sektorin dhe përfitimet që lindin nga ai, ashtu edhe për asetin kryesor, natyrën, dhe është një nga prioritetet kryesore të zhvillimit të rajonit.

Ky objektiv citon mbështetjen e zhvillimit të turizmit me një perspektivë strategjike për të gjithë rajonin e Alpeve Shqiptare, duke siguruar kontrollin e presionit njerëzor në mjedisin natyror. Prurjet e turizmit, veçanërisht atij të huaj, janë gjithnjë në rritje, dhe deri tani zhvillimi i turizmit në këtë zonë të ndjeshme dhe të brishtë nga ana mjedisore është menaxhuar me iniciativa individuale e pa një qasje të gjerë, përveç disa vepërimitarish apo aktiviteteve nga donatorë e aktorë të ndryshëm të cilët kanë përkrahur zhvillimin e turizmit. Veprimet e këtyre të fundit kanë qenë efektive në shkallë lokale dhe kryesisht në disa nga zonat kyçe (si Thethi). Megjithatë, duke filluar nga sezoni i ardhshëm është e nevojshme të hartohet një qasje strategjike globale për të zvogëluar ndikimet negative të rritjes së presionit njerëzor, duke rritur në të njëjtën kohë ndikimin pozitiv dhe të ekuilibruar në cilësinë e jetës për banorët vendas. Kjo realizohet duke ruajtur si asetet natyrore ashtu edhe ato kulturore, pra ato të cilat përbëjnë tërheqjen më të madhe turistike.


Ekuilibri i presionit njerëzor në mjedisin natyror është qëllimi kryesor dhe një mundësi unike pikërisht në këtë fazë të zhvillimit të turizmit në zonat natyrore të Alpeve Shqiptare.

OS2. RITJA E PRODUKTIVITETIT TË TURIZMIT

Turizmi sot është një nga sektorët më të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm ndaj ndryshimeve ekonomike dhe sociale. Një sektor i tillë ka kapacitetin për të krijuar vende pune dhe për të zgjeruar shërbimet dhe produktet për vizitorët dhe popullsinë lokale. Falë sektorit të turizmit ofrohen alternativa për aktivitetet ekonomike të reja dhe ekzistuese, vende të reja pune, zhvillim social etj. Përmirësimi i produktivitetit të turizmit synon uljen e sezonalitetit. Produktiviteti ka të bëjë me të bërit shumë duke shfrytëzuar elementet e pakta në zotërim, dhe rritja e tij arrihet nga bashkëpunimi i një sërë aktorësh në ekonomi - punonjës e biznese, investitorë dhe qeverisës. Në fund të fundit, për të përmirësuar produktivitetin duhet përmirësuar cilësia e ideve, e cila më pas shton vlerën e mallrave dhe shërbimeve.

OS3. PROMOVIMI DHE MARKETIMI I ALPEVE SI NJË DESTINACION I VEÇANTË

Bizneset turistike, krahas operatorëve të ndryshëm turistikë, qeverisjes vendore dhe sektorëve përkatës siç është transporti, duhet të ndajnë përgjegjësitë për krijimin e një eksperience autentike e të suksesshme në rajonin e alpeve. Eksperiencat natyrore, kulturore, historike dhe peizazhistike në rajon, duke qenë elementet kryesore tërheqëse për vizitorët, kërkojnë standarde të larta menaxhimi dhe promovimi. Menaxhimi efektiv dhe promovimi i duhur i rajonit kërkon një qasje të integruar, duke marrë parasysh nevojat e vizitorëve, banorëve dhe mjedisit. Rritja e nivelit të kënaqësisë nga eksperiencia e vizitorëve të huaj dhe vendas dhe inkurajimi për të zgjedhur rajonin e alpeve si destinacion turistik, janë elementet kryesore në rritjen e përgjithshme të kërkesës dhe përfitimeve nga sektori i turizmit.





02

PROPOZIMET & PËRCAKTIMET TERRITORIALE

- 2.1 PRODUKTET TURISTIKE QË MUND TË ZHVILLOHEN
- 2.2 PROJEKSIONET PËR SEKTORIN E TURIZMIT NË ALPET SHQIPTARE
- 2.3 SEGMENTET KRYESORE QË DO TË SYNOHEN NË TË ARDHMEN
- 2.4 LOKALITETET TURISTIKE DHE KARAKTERISTIKAT E TYRE
- 2.5 MBROJTJA E PEIZAZHIT DHE SHPALLJA E ZONAVE TË RËNDËSISË KOMBËTARE
- 2.6 KARAKTERISTIKAT DHE VEÇORITË E LOKALITEVEVE

2.1

PRODUKTET TURISTIKE QË MUND TË ZHVILLOHEN NË ALPET SHQIPTARE

Bazuar në rezultatet e analizës, pasuritë natyrore dhe kulturore të zonës (parqe natyrore dhe monumente kulture e natyre), traditave dhe potencialeve njerëzore të rajonit, si dhe në strategjitë e zhvillimit të sektorit turistik në alpe, rezulton që produktet turistike mund të diversifikohen dhe pasurohen me nënprodukte apo aktivitete të ndryshme.

2.1.1 Klasifikimi i produktit turistik

Vlerësohet se në zonën e alpeve mund të zhvillohen 5 produkte turistike kryesore dhe 20 nënprodukte turistike të cilat i japin zonave të ndryshme një karakter të veçantë.

Produktet turistike që mund të zhvillohen ose përmirësohen janë përmbledhur si më poshtë:

- **Turizmi natyror** u referohet turistëve që duan të eksplorojnë një shumëllojshmëri burimesh natyrore duke përjetuar eksperiencë ose aventura lidhur me natyrën dhe traditën lokale.
 - Turizmi i qëndrueshëm / Ekoturizmi / Turizmi ekologjik është i orientuar drejt ekosistemeve, biodiversitetit dhe ekologjisë. Turistët shfaqin një interes për edukimin dhe sensibilizimin ndaj problematikave mjedisore, duke praktikuar aktivitete që tentojnë të ruajnë ekuilibrin mes mjedisit dhe turizmit.
 - Turizmi malor dhe i hapësirave natyrore u referohet turistëve të cilët nëpërmjet një eksperiencë aktive duan të eksplorojnë peizazhe dhe masive malore me vlera të larta natyrore dhe peizazhistike.
 - Turizmi i parqeve dhe zonave të mbrojtura është i orientuar drejt vizitave në parqe natyrore dhe zona të mbrojtura me biodiversitet të lartë.
 - Turizmi ujqor është i orientuar drejt eksperiencës dhe aktiviteteve të praktikuar në liqene, lumenj, përrenj etj.

- **Turizmi kulturor** u referohet turistëve të interesuar në trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale të një zone falë kulturës, traditës, njohjes me stilin e jetesës, folklorin, festave kulturore lokale etj.

- Turizmi i historisë dhe kulturës lokale i referohet turizmit që ka të bëjë me historinë, traditën, monumentet e kulturës, vlerat arkitektonike, folklorin dhe rregullat sociale.
- Turizmi industrial dhe artizanal i referohet turizmit që ka të bëjë me kulturën prodhuese të së shkuarës, të tashmes dhe të ardhmes, karakteristikat ose specifikat e zonës si artizanati dhe industria (aktivitet prodhuese: uzina, fabrika, ateliere, mini-era, hidrocentrale).
- Turizmi fetar dhe i objekteve të kultit i referohet turizmit që ka të bëjë me përmirësimin e gjendjes morale apo shpirtërore të vizitorëve.
- Turizmi shkencor është i orientuar drejt shkencës, pedagogjisë dhe kërkimit në fusha të ndryshme të shkencës e natyrës. Këta turistë kërkojnë të zgjerojnë horizontin intelektual në fushën e shkencave ekzakte dhe natyrës.
- Turizmi krijues një turizëm i organizuar rreth aktiviteteve krijuese, bashkëpunuese dhe edukative. Këta turistë kërkojnë të angazhohen në mësimin e traditave lokale, valleve, veglave muzikore, artizanatit lokal, gatimet, etj.

- **Turizmi rural** është një formë turizmi e praktikuar në ambiente rurale, duke vlerësuar cilësinë e jetës në fshat dhe produktet vendase.
 - Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore është forma e turizmit që ka si objekt eksplorimin e prodhimit bujqësor dhe blegtoral të një zone së bashku me vlerat peizazhistike, traditën dhe karakterin rural.
 - Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale i referohet turizmit që ka të bëjë me specialitetet gastronomike, produktet ushqimore dhe pijet vendase.

- **Turizmi i aventurës dhe sportit** i referohet turistëve të interesuar në aktivitete argëtuese, rekreative dhe sportive.
 - Turizmi argëtues dhe rekreativ i referohet turizmit që bazohet në nevojat për aventurë dhe adrenalinë.
 - Turizmi argëtues / rekreativ i “butë”, ku turistët kërkojnë një nivel të moderuar të përfshirjes fizike.
 - Turizmi argëtues / rekreativ “aktiv”, ku turistët kërkojnë një nivel të lartë përfshirjes fizike, dhe faktori rrezik i përgjigjet sfidës fizike personale.
 - Turizmi i aeronautikës: parashutizëm, paragliding, sky-diving, parapent
 - Turizmi i çiklizmit: është i orientuar drejt eksperiencës dhe aktiviteteve të lidhura me çiklizmin.
 - Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit: është i orientuar drejt eksperiencës dhe aktiviteteve të ecjes, marshimit apo ngjitjeve në shpate malore në nivele të ndryshme vështirësie.
 - Turizmi i speleologjisë: i referohet turizmit që ka të bëjë me vizitat dhe eksplorimin e shpellave.

- **Turizmi urban:** i referohet turizmit që mbështetet në nevojat urbane.
 - Turizmi i eventeve: bazohet në eventetë organizuara në një zonë të caktuar.
 - Turizmi shëndetësor: i referohet turizmit për qëllime shëndetësore dhe kurative, duke pasur në fokus shëndetin e vizitorëve dhe aktivitetet kurative.
 - Turizmi i biznesit ose profesional: i referohet turizmit që orientohet drejt aktiviteteve që lidhen ngushtë me formimin profesional ose kulturën e ndërmarrjes.

- Turizmi social dhe i solidaritetit: orientohet drejt turizmit që mbështet popullsinë lokale në nevojë dhe mundëson aktivitete turistike për popullsinë me të ardhura të ulëta.

2.1.2 Aktivitetet kryesore që mund të zhvillohen sipas produktit turistik

Llojet e turizmit së bashku me aktivitetet që propozohen për destinacionet e veçanta të rajonit të alpeve do të ndahen sipas kategorive dhe nën-kategorive të mëposhtme:

Kategoria	Nën-kategori	Aktivitete turistike
TURIZMI NATYROR	Turizmi i qëndrueshëm, ekoturizmi, turizmi ekologjik	Vizita në zona me biodiversitet të lartë, ekosisteme të ndryshme, rezerva natyrore dhe parqe natyrore; Studim i florës dhe faunës; Kurse dhe aktivitete sensibilizuese për problematikat mjedisore, për ruajtjen e biodiversitetin dhe speciet në zhdukje.
	Turizmi malor dhe i hapësirave natyrore	Shëtitje në natyrë dhe shtigje panoramike (në këmbë, kuaj dhe mushkë); Vizita në monumente të natyrës (gjeomonumente, ujëvara, kanione, pyje, lumenj, përrenj, shpella, korridore të gjelbra); Piknikë; Shëtitje me ski; ski nordikë; ecje me raketa dhe slita.
	Turizmi i rezervave dhe zonave të mbrojtura	Vizita në zona të mbrojtura, rezerva natyrore, monumente të natyrës etj.
	Turizmi i lumenjve	Vizita në brigje dhe gjire natyrore me vlera peizazhistike dhe nëpër gjeomonumente ujore; Aktivitete ujore si peshkim, kanoe; kajak, not, <i>canyoning</i> , <i>waterballs</i> , <i>rafting</i> .
TURIZMI KULTUROR	Turizmi i historisë dhe kulturës lokale	Vizita në muze, monumente të kulturës, site arkeologjike, kulla historike, fshatra historike me vlera arkitektonike, vende historike dhe legjendare, galeri arti etj.; Njohje me zakonet dhe rregullat sociale të zonës, folklorin dhe legjendat lokale; Kurse kërcimi të valleve popullore, të veglave muzikore lokale etj.; Udhëtime në itinerare kulturore.
	Turizmi industrial dhe artizanal	Vizita në atelierët e artizanatit, hidrocentrale dhe mullinj; Kurse për prodhimin dhe blerje të produkteve të artizanatit.
	Turizmi fetar dhe i objekteve të kultit	Vizita dhe pelegrinazh në monumentet e kultit dhe në vende të shenjta; Pjesëmarrje në ceremonitë fetare.
	Turizmi shkencor	Studim i florës dhe faunës, specieve të mbrojtura ose në zhdukje, eksplorim i etnografisë dhe arkitekturës lokale, studim astronomik etj.
	Turizmi krijues	Atelie kuzhine, qëndisjeje, poçerie, pikturë, vizatimi, skulpturë.
TURIZMI RURAL	Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore	Vizita në ferma bujqësore, blegtorale dhe baxho, degustim i produkteve lokale, pjesëmarrje në aktivitetet e fermës korrije dhe mbledhje e produkteve bujqësore lokale.
	Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale	Bare dhe restorante me ushqime dhe pije lokale, blerje e produkteve lokale, mësim i proceseve të përpunimit dhe përgatitjes së produkteve specialiteteve lokale.

Kategoria	Nën-kategori	Aktivitete turistike
TURIZMI I AVENTUR ËS DHE SPORTIT	Turizmi argëtues dhe rekreativ	Aktivitete të ndryshme si: <i>mountain-board</i> , <i>acrobranches</i> , kërcim me elastik, xhiro me balonë, <i>paint-ball</i> , <i>speed-mountain</i> , tenis, volejbol, futboll, basketboll, ping-pong, <i>zip-line</i> , organizimi i garave të orientimit etj.; Aktivitete dimërore si: <i>slita</i> , <i>speed-riding</i> , <i>snow-kite</i> .
	Turizmi i çiklizmit	Gara çiklistike, shëtitje me biçikleta, çiklizëm malor
	Turizmi i speleologjisë	Vizita në shpella, speleologji
	Turizmi i parashutizmit	Parashutizëm, <i>paragliding</i> , <i>sky-diving</i> , <i>parapent</i>
	Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit	Ecje në natyrë (<i>hiking / trekking</i>), alpinizëm, <i>via ferrata</i>
TURIZMI URBAN	Turizmi i evenimenteve	Pjesëmarrje në evenimente kulturore, sportive, folklorike, kinematografike, teatrale dhe bujqësore, festivale, panaire dhe ekspozita;
	Turizmi shëndetësor	Shërbime në qendra kurative reumatologjie, kardiologjie, ortopedike, <i>SPA</i> , qendra estetike dhe dietetike, joga, <i>fitness</i> , mjekësi alternative etj.
	Turizmi i biznesit ose profesional	Pjesëmarrje në konferenca, mbledhje dhe takime profesionale, pjesëmarrje në evenimente certifikimi dhe formimi profesional.
	Turizmi social dhe i solidaritetit	Aktivitete me interes publik për të mbështetur popullsinë lokale; Pjesëmarrje në kampe verore; Aktivitete rekreative dhe edukative për njerëzit në pamundësi financiare; Aktivitete sensibilizuese për grupet në nevojë.

Tabela 5. Aktivitetet kryesore që mund të zhvillohen sipas produktit turistik

2.2

PROJEKSIONET PËR SEKTORIN E TURIZMIT NË RAJONIN E ALPEVE

Numri i turistëve të huaj në Shqipëri është dhjetëfishuar në 15 vitet e fundit, ku vetëm në 2015-ën janë matur 4,13 milionë vizitorë. Megjithëse turizmi bregdetar (“rërë, det dhe diell”) përbën produktin kryesor për të vizituar Shqipërinë, është e nevojshme t’u jepet rëndësi edhe produkteve të tjera turistike.

Bazuar në tendencat aktuale dhe në projeksionin e numrit të vizitorëve të huaj në Shqipëri, pritet që numri i vizitorëve të huaj të arrijë numrin 7,9 deri 9,4 milionë në vitin 2031. Megjithëse vlerësohet se Alpet Shqiptare janë frekuentuar nga rreth 120,000 vizitorë të huaj dhe shqiptarë në 2016, më pak se 3% e turizmit kombëtar, vërehet një frekuentim gjithnjë e më i lartë i zonës.

Tendencat tepër optimiste të projeksionit të vizitorëve të huaj në Shqipëri, si dhe pasuritë natyrore dhe kulturore të vendit, shfaqin qartë potencialin e zhvillimit të mëtejshëm të turizmit. Zhvillimi i produkteve të turizmit natyror, rural dhe malor, të sportit dhe aventurës, kulturës, kulinarisë, shëndetit etj., mundësojnë diversifikimin e produkteve turistike të Shqipërisë.

2.2.1 Karakteristikat e kërkesës turistike aktuale sipas segmenteve

Për të kuptuar tendencat, kërkesën turistike në rajon, avantazhet konkurruese dhe nevojat e diversifikimit të turizmit, 1405 vizitorë që kanë frekuentuar zonën e Alpeve Shqiptare janë intervistuar nëpërmjet një pyetësi të shpërndarë gjatë muajve qershor, korrik, gusht dhe shtator 2016. Pyetësi u hartua në 6 gjuhë të ndryshme (shqip, anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe spanjisht) dhe iu shpërnda vizitorëve të ndryshëm të zonës, të përzgjedhur rastësisht falë një stafi të trajnuar.

Pyetësi prej 25 pyetjesh u përqendrua në tre informacione kryesore:

- Informacion mbi udhëtimin
- Informacion mbi produktet e turizmit dhe eksperiencën në Alpet Shqiptare
- Informacion personal

Nga analiza e rezultateve të pyetësit evidentohen dy segmente kryesore: vizitorët e huaj dhe vizitorët shqiptarë.

Vizitorët e huaj përfaqësojnë pjesën më të madhe të vizitorëve që frekuentojnë Alpet Shqiptare (rreth 67%).



Kërkesa dhe segmenti turistik aktual		
Segmenti	Shqiptar	Të huaj
Vizitorët që rikthehen në Alpet Shqiptare		
Vizitorët që janë rikthyer në Alpet Shqiptare	44.20%	21.80%
Mosha		
25 deri në 45 vjeç	54.50%	63.50%
Gjinia		
Meshkuj	55.70%	63.8%
Edukimi		
Arsim universitar dhe pas universitar	77%	77%
Shpenzime		
Transporti	26.99 €	45.58 €
Akomodimi	24.25 €	23.13 €
Ushqime dhe pije	22.47 €	23.76 €
Tjetër	11.57 €	11.6 €
Gjithsej	66.86 €	80.93 €
Kanalet e informimit për Alpet Shqiptare		
Interneti	27.53%	42.56%
Rekomandim nga miqtë	24.29%	14.74%
Televizion	21.73%	9.62%
Libra turistike	4.92%	12.24%
Qëllimi i vizitës		
Kohë e lirë / Argëtim / Sporte	31.63%	38.64%
Pushim dhe çlodhje	46.36%	45.60%
Ushqimi dhe produkte lokale	17.67%	14.17%
Kohëzgjatja e qëndrimit		
1 natë	21.40%	4.50%
2-3 netë	49.70%	45.10%
4-7 netë	19.60%	36.40%
Tipi i akomodimit të përdorur		
Bujtina	58.94%	50.88%
Hotel	32.55%	24.68%
Kamping	7.23%	21.65%

Tipi i akomodimit që dëshirojnë të përdorin		
Bujtina	50.70%	56.25%
Kamping	13.61%	27.35%
Hotele / Hostel me buxhet të ulët	8.45%	10.04%
Hotele 2 deri në 3 yje	14.08%	5.12%
Hotele 4 deri në 5 yje	13.15%	1.24%
Arsyet për të zgjedhur Alpet Shqiptare (1 deri në 5, 5 vlerësimi maksimal)		
Interesi në cilësinë e panoramës dhe peizazhit natyror	4.62	4.43
Interesi për aventurë dhe aktivitete sportive	3.79	4.22
Interesi për komunitetet lokale dhe mënyra tradicionale e jetesës	4.03	4.18
Mikpritja e popullsisë lokale	4.32	4.14
Siguria e zonës	4.03	3.54
Aspektet kryesore të vlerësuara nga vizitorët (1 deri në 5, 5 vlerësimi maksimal)		
Panorama dhe peizazhi	4.45	4.54
Mikpritja e banorëve	4.34	4.39
Mundësia për të takuar banorët vendas	4.24	4.33
Mënyra tradicionale e jetesës	4.14	4.12
Pamja tërheqëse e zonës përreth strukturave të akomodimit	4.39	3.91
Dukuritë që mund të dëmtojnë mjedisin dhe bukuritë e Alpeve Shqiptare		
Menaxhim i dobët i mbetjeve	15.69%	20.92%
Prerja e pemëve	18.13%	17.49%
Zjarret në pyje	13.63%	14.06%
Gjuetia e paligjshme	9.01%	12.33%
Dëmtimi i terrenit natyror nga ndërtimet	10.18%	8.96%
Aktivitet e realizuara gjatë qëndrimit në Alpet Shqiptare		
Ecje në natyrë	16.00%	21.43%
Fotografi	14.16%	17.27%
Ngjitje në mal / alpinizmi	7.52%	11.35%
Piknik	9.41%	10.34%
Gastronomia lokale	9.97%	7.62%

Aktivitet që vizitorët dëshirojnë të realizojnë në të ardhmen		
Vizita në parkun kombëtar	5.09%	11.27%
Speleologji	8.93%	10.92%
Vizita pranë komuniteteve vendase	4.30%	10.71%
Ecje në natyrë	6.80%	6.87%
Ngjitje në mal / alpinizmi	6.71%	6.35%
Sporte dimërore	10.00%	5.13%
Ecje me kalë	7.31%	4.85%
Vizitorët që do të rekomandonin Alpet Shqiptare		
Vizitorët që do të rekomandonin Alpet Shqiptare	99.55%	99.78%

Tabela 6. Karakteristika e turizmit aktual sipas segmenteve

Nga rezultatet e pyetësorit të turizmit identifikohen karakteristikat kryesore:

Segmenti i vizitorëve shqiptarë

Vizitorët shqiptarë janë kryesisht të rinj (25-45 vjeç), me arsimim të lartë, të cilët preferojnë të strehohen në bujtina dhe hotele me pamje tërheqëse, për një periudhë kohore 2-ditore, duke shpenzuar rreth 67 euro në ditë. Interneti, rekomandimi i miqve dhe televizioni; janë kanalet kryesore që kanë nxitur interesin për të pushuar, relaksuar, argëtuar, zbavitur, për të kryer aktivitete sportive dhe përfituar nga gastronomia lokale e Alpeve Shqiptare. Aspektet kryesore që i shtyjnë vizitorët të frekuentojnë zonën e alpeve janë: interesi për natyrën, cilësia e peizazhit, mikpritja, stili i jetesës dhe mundësia për të takuar popullsinë lokale. Aktivitet kryesore që këta vizitorë kryejnë në zonë janë: ecja në natyrë, fotografitë, pikniku dhe gastronomia lokale. Megjithatë vizitorët vlerësojnë se ka një menaxhim të dobët të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi, eksperiencia dhe imazhi pozitiv i tyre për Alpet Shqiptare i orienton drejt besnikërisë dhe promovimit të zonës.

Segmenti i vizitorëve të huaj

Vizitorët e huaj janë kryesisht djem të rinj (25-45 vjeç), me arsimim të lartë, të cilët preferojnë të strehohen në bujtina dhe kampingje me pamje tërheqëse, për një periudhë kohore 3-ditore, duke shpenzuar rreth 81 euro në ditë, ku transporti zë rreth 56% të buxhetit të tyre ditor. Interneti, rekomandimi i miqve dhe librat turistike janë kanalet kryesore që kanë nxitur interesin për të

pushuar, për t'u relaksuar, argëtuar, zbavitur, për të kryer aktivitete sportive dhe për të përfituar nga gastronomia lokale e Alpeve Shqiptare. Aspektet kryesore që i shtyjnë vizitorët të frekuentojnë zonën e alpeve janë: interesi për natyrën, cilësia e peizazhit, aventura dhe sportet, mikpritja, stili i jetesës dhe mundësia për të takuar popullsinë lokale. Aktivitet kryesore që këta vizitorë kryejnë në zonë janë: ecja në natyrë, fotografitë, ngjitja në mal, alpinizmi dhe piknikët. Megjithatë vizitorët vlerësojnë se ka një menaxhim të dobët të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit në përgjithësi, eksperiencia dhe imazhi pozitiv që kanë për Alpet Shqiptare i orienton drejt besnikërisë dhe promovimit të zonës.

Krahas segmentit të vizitorëve të Alpeve Shqiptare, pyetësori mundëson dhe identifikimin e avantazheve konkurruese kryesore të këtij rajoni, të cilat janë:

- cilësia e peizazhit natyror;
- mikpritja;
- mundësia për të takuar popullsinë lokale;
- stili i jetesës;
- gastronomia;
- ecja në natyrë dhe alpinizmi.

Ruajtja e avantazheve të tilla konkurruese do të garantojë qëndrueshmërinë e zhvillimit ekonomik të Alpeve Shqiptare.

2.2.2 Projektioni i kërkesës turistike

Kërkesa aktuale e tregut turistik të Alpeve Shqiptare dhe tendencat e identifikuar nga metoda ekonometrike e "Delphi"-t, parashikojnë një zgjatje të sezonit turistik dhe një rritje të konsiderueshme të numrit të turistëve për 15 vitet e ardhshme. Përkthyer në shifra, numri i turistëve (pra i vizitorëve që qëndrojnë të paktën një natë në territor) nga 67.000 turistë në vitin 2016, pritet të arrijë në 578.000 turistë në vitin 2031.

Rritja e kërkesës turistike vjen si pasojë e përmirësimit të faktorëve si: promovimi i burimeve natyrore dhe gastronomisë tradicionale, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve akomoduese, zhvillimi i atraksioneve të veçanta, përmirësimi i sistemit të transportit duke përfshirë ndërlihdjen me qendrat kryesore të vendit, sinjalistikën, parkimin dhe zhvillimin e telekomunikacionit. Këta janë faktorët kryesorë, përmirësimi i të cilëve do të sjellë dhe zgjatjen e sezonit turistik, nga 5 muaj në vitin 2016 në 10 muaj në vitin 2031.

Bazuar në indikatorët kryesorë të zhvillimit të ardhshëm të turizmit në Alpet Shqiptare të evidentuara nga modeli ekonometrik, mund të vlerësojmë edhe projektionin e qëndrimit të turistëve në territor. Duke u bazuar në indikatorë si aksesibiliteti, menaxhimi i burimeve natyrore, larmishmëria dhe veçantia e atraksioneve, cilësia e shërbimeve dhe e sistemit të akomodimit, mund të propozohet projektioni i kërkesës së net-qëndrimit të turistëve në territor.

Numri i net-qëndrimeve vjetore për vitin 2031 do të arrijë vlerat nga 2.022.000 në 2.600.000 net-qëndrimi në vit.

Viti	Sezoni turistik (muaj)	Rritja e frekuentimit turistik vjetor	Numri i turistëve	Vlerësimi i numrit të net-qëndrimeve në vit
2017	6	3%	69.010	241.535 - 310.545
2018	6	4%	71.770	251.195 - 322.965
2019	6	6%	76.077	266.270 - 342.347
2020	7	8%	82.163	287.571 - 369.734
2021	7	11%	91.201	319.204 - 410.405
2022	7	12%	102.145	357.508 - 459.653
2023	8	14%	116.445	407.558 - 524.003
2024	8	15%	133.912	468.692 - 602.604
2025	8	17%	156.677	548.370 - 705.047
2026	9	19%	186.445	652.558 - 839.003
2027	9	22%	227.463	796.121 - 1.023.584
2028	9	24%	282.054	987.189 - 1.269.243
2029	10	25%	352.568	1.233.988 - 1.586.556
2030	10	27%	447.762	1.567.167 - 2.014.929
2031	10	29%	577.612	2.021.642 - 2.599.254

Tabela 7. Vlerësimi i net-qëndrimit në 2031

Bazuar në vlerat e net-qëndrimit vjetor, kohëzgjatjen e sezonit turistik, dhe nga shembujt ndërkombëtarë të shfrytëzimit të sistemit të akomodimit në zona të ngjashme, mund të përafrojmë nevojat për strehimin turistik në zonë.

Viti	Sezoni turistik (muaj)	Rritja e frekuentimit turistik vjetor	Numri i turistëve	Vlerësimi i numrit të shtretërve
2017	6	3%	69.010	3399 - 4370
2018	6	4%	71.770	3500 - 4501
2019	6	6%	76.077	3641 - 4681
2020	7	8%	82.163	3859 - 4962
2021	7	11%	91.201	4168 - 5358
2022	7	12%	102.145	4626 - 5948
2023	8	14%	116.445	5181 - 6662
2024	8	15%	133.912	5907 - 7594
2025	8	17%	156.677	6793 - 8733
2026	9	19%	186.445	7947 - 10.218
2027	9	22%	227.463	9457 - 12.159
2028	9	24%	282.054	11.538 - 14.835
2029	10	25%	352.568	14.307 - 18.395
2030	10	27%	447.762	17.884 - 22.994
2031	10	29%	577.612	22.713 - 29.202

Tabela 8. Vlerësimi i nr të shtretërve për 2031

Fakti se zona e Alpeve Shqiptare në vitin 2016 ka ofruar një kapacitet prej vetëm 2877 shtretërisht, dhe se numri i shtretërve të nevojshëm për të mirëpritur turistët e ardhshëm (në 2031) luhet nga 22.700 në 29.200 shtretër, shfaq qartë presionin për struktura të reja akomoduese në të ardhmen.

Duke marrë parasysh kërkesën aktuale për llojin e sistemit të akomodimit dhe tendencat e kësaj kërkesë, vlerësohet se nevojiten më shumë se 12.500 shtretër në strukturat akomoduese të tipit bujtina / fjetje dhe mëngjes (B&B), 7000 akomodime në strukturat e kampingut dhe 6100 shtretër në strukturat hoteliere.

	Bujtina / B&B	Kamping	Hotel / Hostel / Motel	Gjithsej
Akomodimi që do të preferonin turistët aktualë në të ardhmen	55%	24%	21%	100%
Numri i shtretërve	12.492 – 16.061	5451 – 7008	4770 – 6132	22.713 – 29.202

Tabela 9. Projektioni i nr të shtretërve dhe preferencat për akomodimin

Nëse do të konsiderojmë këtë kërkesë potenciale (22.713 - 29.202 shtretër) me mundësitë e vetë territorit (vlerat natyrore, kulturore, traditën, kufizimet e zhvillimit, parimet e dokumenteve të planifikimit, etj.), rezulton një kërkesë shumë e lartë, gjë që do të dëmtojë dhe do të ndikojë negativisht në avantazhet konkurruese të rajonit (sipas kësaj kërkesë vlerësohet se nevojiten rreth 690-890 bujtina dhe 105-135 struktura hoteliere në total).

Për këtë arsye është e domosdoshme që kjo kërkesë të orientohet dhe rregullohet sipas kapacitetit optimal akomodues të territorit. Instrumenti më efikas rezulton krijimi i një oferte turistike bazuar në një vlerësim të ngarkesës turistike dhe kapacitetit akomodues të territorit.

2.2.3 Vlerësimi i “kapacitetit mbajtës” dhe akomodues të territorit

Zhvillimi i sektorit të turizmit ushtron një presion të lartë në territor, duke ndikuar në sistemin imobiliar, në mjedis, natyrë, burime natyrore, kulturë, struktura sociale, aktivitete ekonomike, përdorimin e tokës, etj.

Për këtë arsye është e nevojshme të vlerësohet “ngarkesa turistike” dhe “kapaciteti akomodues turistik”.

“Ngarkesa turistike” vlerëson numrin e vizitorëve të cilët mund të frekuentojnë një destinacion turistik pa cenuar ekosistemin, florën, faunën, ekonominë, vlerat sociale, kulturore dhe mjedisore të këtij destinacioni. Për të vlerësuar ngarkesën turistike dhe akomoduese; është kryer një vlerësim ekonometrik i cili bazohet në indikatorë sasiorë dhe cilësorë si: ndikimi mjedisor, ndikimi në florën dhe faunën, demografia, kapacitetet e infrastrukturës së furnizimit me ujë, kapaciteti i infrastrukturës së trajtimit të ujërave të zeza, aksesit dhe transportit në zonë, kapaciteti energjetik, ndikimi në arkitekturën tipike, punësimi, numri i shtretërve, zona të mbrojtura, zona të urbanizuara, zona rurale etj.

Nga aplikimi i këtij modeli, vlerësohet se ngarkesa turistike mbi të cilën çënohen ndjeshëm aspektet mjedisore, sociale dhe infrastrukturore të Alpeve Shqiptare, është 18.000 deri në 20.000 vizitorë në ditë.

Nëse këto vlera tejkalojnë, rritet konsiderueshëm edhe rreziku që industria e turizmit të ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedis. Për më tepër, tejkalimi i ngarkesës turistike optimale ka një efekt të drejtpërdrejtë mbi efikasitetin turistike të Alpeve Shqiptare, situatë kjo që ka për efekt afatgjatë stagnacionin ose rënien e numrit të turistëve.

Krahas ngarkesës turistike, modeli ekonometrik lejon të llogarisim edhe “kapacitetin akomodues turistik optimal”, pra kapacitetet akomoduese të një destinacioni turistik pa transformuar në mënyrë të dëmshme këtë të fundit.

Nga vlerësimi përcaktohet se numri i shtretërve të strukturave akomoduese komerciale që nuk çënon në mënyrë të ndjeshme karakteristikat mjedisore, sociale, ekonomike dhe kulturore të destinacionit turistik (Alpet Shqiptare), vlerësohet të jetë rreth 11.000 deri në 12.000 shtretër.

Nëse tejkalojnë vlera prej 12.000 shtretërish, rritet tej mase rreziku që sistemi i akomodimit turistik të ndikojë ndjeshëm në mjedis, natyrë dhe sistemin imobiliar.

2.3

SEGMENTET KRYESORE QË SYNOHEN NË TË ARDHMEN

Duke marrë në konsideratë potencialin e aktiviteteve turistike, eksperiencat që mund të zhvillohen në zonën e Alpeve Shqiptare, konkurrencën ndërkombëtare, dhe duke u përqendruar në turizmin e aventurës dhe aktiviteteve të ecjes në

Segmentimi i tregut	Pjesa e tregut
1. Tregu ndërkombëtar	67%
a) Eksplorues aktivë	(20%)
b) Eksplorues urbanë të rinj	(40%)
c) Vizitorë afatshkurtër nga Kosova	(4%)
d) Eksplorues urbanë nga Kosova	(3%)
2) Tregu shqiptar	33%
e) Familje	(20%)
f) Eksplorues urbanë të rinj	
i. Eksplorues aktivë	(10%)
ii. Konsumatorë relaksi	(3%)

Tabela 10. Segmentimi i tregut

1. Tregu ndërkombëtar

a) Eksploruesit aktivë
Eksploruesit aktivë të huaj vijnë kryesisht nga vendet e Evropës Qendrore, Izraelit dhe SHBA. Këta vizitorë janë në një moshë 40-65 vjeç, me arsim të lartë dhe në gjendje të mirë financiare. Ky segment do të vizitojë alpet në grupe të vogla, të cilët do të qëndrojnë 5 deri në 10 ditë, dhe do të preferojnë të shoqërohen nga guida turistike për të njohur më mirë zonën. Ecja në natyrë, eksperiencat e ndryshme kulturore, akomodimi tradicional i pastër dhe komod, produktet ushqimore cilësore dhe gastronomia e pasur, janë elementet kryesorë tërheqëse. Eksploruesit aktivë të huaj kërkojnë informacion dhe orientim të plotë mbi vlerat natyrore dhe kulturore të zonës.

b) Eksploruesit urbanë
Eksploruesit urbanë të huaj vijnë kryesisht nga vendet e Evropës Qendrore dhe SHBA. Këta vizitorë janë në një moshë relativisht të re, 25-35 vjeç, me arsim të mesëm e të lartë dhe në gjendje financiare modeste. Ata do t'i vizitojnë alpet në grupe miqsh, duke e organizuar vetë udhëtimin. Këta turistë do të qëndrojnë 5 deri në 10 ditë dhe do të kryejnë ecje në natyrë, do të vizitojnë monumentet e kulturës lehtësisht të aksesueshme dhe do të zgjedhin akomodim të thjeshtë.

c) Vizitorët afatshkurtër nga Kosova
Eksploruesit afatshkurtër nga Kosova janë në një moshë rreth 25-65 vjeç, me një arsim të mesëm dhe të lartë, në një gjendje financiare të mesme dhe të lartë, që do t'i vizitojnë alpet me familjen ose me grupe miqsh. Këta vizitorë do të orientohen drejt gastronomisë lokale dhe do të vizitojnë monumentet e kulturës lehtësisht të aksesueshme, duke kërkuar një akomodim të pastër dhe komod.

ç) Eksploruesit urbanë nga Kosova
Eksploruesit urbanë nga Kosova vijnë kryesisht nga Gjakova, Peja dhe Prizreni. Këta vizitorë janë në një moshë rreth 25-45 vjeç, me një arsim të mesëm dhe të lartë dhe në një gjendje financiare modeste. Ky segment turistësh do t'i vizitojë alpet me grupe të organizuara ose vetorganizuara që do të qëndrojnë nga 1 deri në 3 netë. Përveç tyre, në këtë segment përfshihen edhe vizitorë që do ta frekuentojnë zonën me ture të organizuara e do të qëndrojnë relativisht më gjatë, nga 2 deri në 7 netë. Këta turistë do të zhvillojnë ecje në zonat natyrore më interesante dhe do të vizitojnë monumentet e kulturës. Ky segment shfaq një interes të lartë për aktivitetet kulturore, gastronominë lokale dhe akomodimin e pastër dhe komod.

2. Tregu shqiptar

d) Familjet

Vizitorët familjarë vijnë kryesisht nga qytetet e mëdha të Shqipërisë, ku prindërit janë në një moshë rreth 35-55 vjeç, me arsim të mesëm dhe të lartë me një situatë financiare komode, të cilët do të qëndrojnë nga 2 deri në 7 netë. Këta turistë do të zhvillojnë ecje në natyrë dhe vizita në monumente natyrore, do të zgjedhin akomodim të pastër dhe komod dhe do të përfitojnë nga produktet dhe gastronomia lokale. Ky segment shfaq një interes të lartë për aktivitete edukative dhe argëtuese për fëmijët.

dh) Eksploruesit urbanë në moshe të re

i. Eksploruesit aktivë

Eksploruesit urbanë aktivë në moshë të re vijnë kryesisht nga qytetet e mëdha të Shqipërisë dhe janë në një moshë 18-35 vjeç, me arsim të mesëm dhe të lartë, me të ardhura modeste, që do të vizitojnë me grupe të mëdha të vetorganizuara dhe do të qëndrojnë në zonë nga 4 deri në 7 ditë. Këta vizitorë do të zhvillojnë ecje në natyrë dhe do të zgjedhin struktura akomoduese të thjeshta.

ii. Konsumatori i relaksit

Konsumatorët e relaksit vijnë kryesisht nga qytete e mëdha të Shqipërisë, janë në një moshë rreth 25-35 vjeç, me arsim të mesëm dhe të lartë dhe me të ardhura të larta. Këta vizitorë do t'i vizitojnë alpet individualisht ose në grupe të vetorganizuara miqsh, duke qëndruar nga 1 deri në 2 netë, dhe duke shfaqur një interes të lartë për cilësinë e akomodimit dhe ushqimit, për aktivitetet kulturore dhe aktivitetet argëtuese të jetës së natës.

2.4

LOKALITETET TURISTIKE & KARAKTERISTIKAT E TYRE

Koncepti i zhvillimit për rajonin e Alpeve Shqiptare konsiston në identifikimin dhe fuqizimin e lokaliteteve sipas një hierarkie të veçantë brenda këtij rajoni, por në të njëjtën kohë duke respektuar hierarkinë që ka përcaktuar Plani i Përgjithshëm Kombëtar. Lokalitetet janë kategorizuar në nivele të ndryshme zhvillimi duke u bazuar tek profilet, specializimet e veçanta të secilës prej tyre për sa i përket shërbimeve, aktiviteteve segmenteve të turizmit dhe llojit të strukturave të akomodimit.

Klasifikimi është bërë bazuar në kërkesën turistike, praninë e monumenteve të trashëgimisë kulturore, elementeve të arkitekturës tradicionale që duhen ruajtur, si dhe vlerave natyrore dhe peizazhiste të rrethinave të lokalitetit. Për sa i përket llojit të strukturave akomoduese, në zonën e planifikimit të PKST-Alpe lejohen tipologjitë e strukturave turistike si: bujtina, fjetje & mëngjes, fjetina, hotele, resorte, kamping, qendra kurative, motele, strehime alpine, të shpërndara këto sipas niveleve të lokaliteteve.

Kur bëhet fjalë për ato lokalitete në të cilat do të lejohen struktura akomoduese të tipit bujtinë, fjetje & mëngjes apo fjetinë, përparësi do të ketë përdorimi i strukturave të banesave ekzistuese boshe apo të braktisura, kjo për të ruajtur tipologjinë karakteristike hapësinore dhe arkitekturore të fshatrave. Ndërkohë hapësirat përreth këtyre strukturave, konkretisht oborret e banesave, parashikohet të shfrytëzohen si hapësira të dedikuara për kamping me kushtet e nevojshme të infrastrukturës që i nevojitet këtij lloji shërbimi. Në këto hapësira propozohet gjithashtu vendosja e strukturave të përkohshme prej druri për akomodim apo shërbim restoranti, krijimi i këndeve rekreative dimërore dhe verore, etj.

Në lokalitetet ku do të lejohen strukturat e akomodimit të tipit hoteleri, këto të fundit do të ndahen në 4 nënkategori sipas kapacitetit dhe llojit të strukturës:

- Hotele me kapacitet të ulët
- Hotele me kapacitet të mesëm
- Hotele me kapacitet të lartë
- Hotele të shpërndara

Në rastin e lejimit të ndërtimit të strukturave të tipit resort apo qendra kurative, do të duhet të respektohen dimensionet dhe elementet arkitektonike autoktone të zonës, të mbështetura në një studim fizibiliteti.

Në lokalitetet ku parashikohet lloji i strukturave akomoduese e tipit kamping me çadra, ky i fundit do të respektojë së pari planet e menaxhimit të parqeve.

Hapësirat dhe sheshet e dedikuara për kamping me kamper do të përcaktohen në afërsi të vendbanimeve dhe akseve kryesore të lëvizjes dhe do të jenë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme si shërbimet higjienike, elektrike, etj.

Në zonë përgjithësisht përparësinë do ta kenë transformimet, ripërdorimet apo restaurimet e objekteve ekzistuese, ndërsa për strukturat e reja, prioritet do të kenë elementet e arkitekturës tradicionale në përputhje me karakterin e tipologjisë hapësinore ekzistuese. Për këtë arsye duhen kufizuar strukturat e tipit motel, dhe çdo strukturë e re duhet të integrohet në peizazhin natyror malor duke përdorur materiale lokale dhe duke respektuar morfologjinë e terrenit.

Në rastin e strukturave të veçanta të dedikuara për sporte dimri, pistat për ski, pistat për trampolina me ski, zonat e rezervuara për aktivitetet me ski dhe snowboard, etj., duhen të konsiderohen me interes publik dhe të klasifikohen sipas një rregulloreje dhe legjislacioni të veçantë.

Janë identifikuar 4 nivele lokalitetesh si në vijim:

2.4.1 Niveli I⁵ : Lokalitetet urbane

“Portat hyrëse” të rajonit të Alpeve Shqiptare: Bajram Curri dhe Koplík

Këto lokalitete shërbejnë si “porta hyrëse” për në alpe, duke pasur një funksion pritës dhe shpërndarës për të gjithë rajonin e Alpeve Shqiptare.

Koncepti “portës hyrëse” këtu i referohet “portës” apo stacionit të parë të ndalesës për rajonin e Alpeve Shqiptare, dhe nuk duhet të ngatërrohet me “portat” e përcaktuara nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar.

Këto “porta” janë të pozicionuara në mënyrë strategjike në lindje dhe në perëndim të rajonit të alpeve, dhe janë të pajisura me shërbime informative të standardeve të duhura, shërbime turistike dhe struktura akomoduese të llojeve të ndryshme për një numër të madh turistësh. Gjithashtu, këto qendra ofrojnë një shumëllojshmëri aktivitete turistike, argëtuese e kulturore, tregje të produkteve vendase dhe të punimeve artizanale, etj.

Sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar, Bajram Curri dhe Koplík kategorizohen si qendra të niveleve të ndryshme, ku Bajram Curri është përcaktuar si qendër sekondare urbane dhe Koplík si qendër terciare urbane. Sipas konceptit të zhvillimit të PKST-Alpe, Bajram Curri dhe Koplík kategorizohen të dyja në nivelin e parë.



⁵ Shënim: Kategoritë e mësipërme janë të përshkruara në mënyrë të përgjithshme për të zbrëthyer konceptin e zhvillimit të rajonit. Ndërkohë që të gjitha lokalitetet të të gjitha kategorive do të pajisen me pasaportën përkatëse dhe me ndërhyrjet e detajuara në skemat e çdo lokaliteti.

Këto lokalitete dhe nivelet e tyre janë përcaktuar bazuar në kritere si: numri i popullsisë, infrastruktura, shërbimet, afërsia me korridoret e rëndësisë kombëtare (porte, aeroporte, hekurudha, akse automobilistike, etj.), dhe do të ofrojnë shërbime administrative, shërbime publike, shërbime transporti publik, qendër informacioni, hoteleri, bujtina, bar - restorant, si dhe tregje lokale për produktet vendase blegtorale dhe bujqësore.

Megjithëse lokalitetet e nivelit të parë nuk përbëjnë destinacion turistik kryesor krahasuar me lokalitetet e tjera të alpeve, Bajram Curri dhe Koplík marrin një karakter apo funksion të caktuar përsa i përket strategjisë së zhvillimit të këtij rajoni, duke shërbyer si qendra pritëse dhe shpërndarëse për fluksin e turistëve në rajonin e Alpeve Shqiptare. Këto lokalitete karakterizohen nga një shumëllojshmëri shërbimesh turistike, administrative, shëndetësore dhe nga një aktivitet njerëzor më të dendur.

2.4.2 Niveli II⁶ : Lokalitetet “ndërmjetëse”

Tamarë, Lugina e Kirit, Koman, Tropojë e Vjetër, Dushaj, Nënmaoriq, Vermosh, Valbonë, Lekbibaj, Bogë, Razëm, Reç.


Lokalitetet e nivelit të dytë janë destinacione më në brendësi të rajonit të alpeve. Këto porta do të presin prurje më të larta vizitorësh se lokalitetet e nivelit të tretë dhe të katërt, por investimet në infrastrukturë dhe shërbime do të synojnë intensitet më të ulët se lokalitetet e nivelit të parë.

Niveli i dytë përfshin lokalitetet që kanë akses të mirë ose janë pranë akseve kryesore rrugore, kanë shërbime publike bazë, si dhe potencial për zhvillim të strukturave të ndryshme turistike. Rrethinat e lokaliteteve kanë avantazhe mjedisore e kulturore.

⁶ Shënim: Kategoritë e mësipërme janë të përshkruara në mënyrë të përgjithshme për të zbrëthyer konceptin e zhvillimit të rajonit. Ndërkohë që të gjitha lokalitetet të të gjitha kategorive do të pajisen me pasaportën përkatëse dhe me ndërhyrjet e detajuara në skemat e çdo lokaliteti.

Këto lokalitete do të shërbejnë si një zonë “tampon” apo shfryrjeje e vizitorëve për lokalitetet e nivelit të tretë dhe të katërt, për shkak se këto lokalitete kanë potencial të mbajnë një vëllim më të lartë turistësh pa përkeqësuar presionin antropik mbi zonat e mbrojtura mjedisore dhe biodiversitetin. Disa nga këto lokalitete sot janë krejt të pazhvilluara, por sipas strategjisë së zhvillimit të rajonit të alpeve, ato do të pajisen me akses dhe shërbime të nevojshme për banorët dhe turistët (përmendim këtu luginën e Kirit), kështu do të kontribuojnë në një ekonomi të qëndrueshme e në zhvillim në të gjithë rajonit dhe më gjerë.

Për tërhequr një numër turistësh më të lartë se lokalitetet e nivelit të tretë, këto zona kanë nevojë për investime të koordinuara, pajisje me shërbime dhe evente zbavitëse e kulturore, duke ndikuar kështu në mbrojtjen e parqeve natyrore të cilat do të kenë një turizëm më të ndjeshëm ndaj mbrojtjes së natyrës.




2.4.3 Niveli III⁷: Lokalitetet “bërthamë”

Lëpushë, Vukël, Theth, Rragam, Çerem, Curraj i Epërm.

Në këtë lokalitet përfshihen lokalitetet më të njohura turistike të Alpeve Shqiptare, të cilat ndërthurin vlera të larta mjedisore me karakteristika të arkitekturës tradicionale që duhen ruajtur. Këto lokalitete ndodhen në zemrën e zonave të mbrojtura natyrore që do të synojnë segmente specifike për të akomoduar një vëllim të kufizuar turistësh për të ruajtur e mbështetur ekuilibrin mes mjedisit dhe vendbanimeve tradicionale.

Në këto lokalitete, investimet në akomodim dhe shërbime synojnë një shkallë më pak intensive, gjithmonë duke u mbështetur në mënyrë strikte në rregulloret dhe planet e menaxhimit të parqeve. Lokalitetet e nivelit të tretë do t’i nënshtrohen një vëllimi më pak intensiv për sa i përket ndërhyrjeve dhe projekteve lidhur me akomodimin.



⁷ Shënim: Kategoritë e mësipërme janë të përshkruara në mënyrë të përgjithshme për të zbërthyer konceptin e zhvillimit të rajonit. Ndërkohë që të gjitha lokalitetet të të gjitha kategorive do të pajisen me pasaportën përkatëse dhe me ndërhyrjet e detajuara në skemat e çdo lokaliteti.

2.4.4 Niveli IV⁸: “Lokalitete natyrore” të Alpeve Shqiptare

Sulbicë, Blini i Gurit të Lekës - lumi i Shalës

Ky nivel përfshin ato lokalitete me karakter tërësisht natyror, ku synohet promovimi i këtij lloji turizmi, ruajtja e tipareve natyrore dhe impakti zero ose minimal i infrastrukturës. Këto lokalitete janë kryesisht të pozicionuara në zona me vlera të larta natyrore, ku aksesit i turistëve do të jetë i kufizuar dhe i kontrolluar. Në këto zona, investimet do të mbështeten plotësisht në rregullat e zonave të mbrojtura, rrjedhimisht në një shkallë shumë pak ose aspak intensive. Ndërhyrjet këtu do të jenë vetëm përmirësuese, me kusht që efektet e tyre të mos dëmtojnë qëllimet e zonës strikte natyrore dhe peizazhit në tërësi.



2.4.5 Rrezja e influencës


Rrezja e influencës orienton ndërveprimin e parë të turistit me territorin, dhe bazohet në distancën e shërbimeve, atraksionet natyrore e kulturore dhe gjithashtu nga përqendrimin e strukturave akomoduese. Kjo rreze është e lidhur me mundësitë e aksesit me automjete, biçikleta dhe këmbë.


Lokalitetet e nivelit të parë kanë një rreze influencë ndërveprimi prej 20 km, bazuar në përqendrimin e shërbimeve kryesore, ekonomike, sociale dhe infrastrukturore që kanë një impakt më të lartë në territor. Këto do të jenë zonat me mbulimin më të shpeshtë me transport publik si përgjigje e dendësisë urbane.

Lokalitetet e nivelit të dytë kanë një rreze influencë prej 10 km, ku aksesit ndodh kryesisht me automjete. Ato janë lokalitete të mirëaksesueshme me potencial dhe lidhje me transportin publik. Në rastin e lokaliteteve të nivelit të dytë, Koman dhe Dushaj, është përcaktuar se rrezja e influencës është vetëm 3 km, duke qenë se janë lokalitete “tranzit” të lidhura me transportin liqenor si destinacione të mirëfillta turistike.

Lokalitetet e nivelit të tretë dhe të katërt kanë një rreze influencë prej 5 km, për shkak se në këto qendra do të promovohet lëvizja në këmbë dhe me biçikleta.

⁸ Shënim: Kategoritë e mësipërme janë të përshkruara në mënyrë të përgjithshme për të zbrëthyer konceptin e zhvillimit të rajonit. Ndërkohë që të gjitha lokalitetet të të gjitha kategorive do të pajisen me pasaportën përkatëse dhe me ndërhyrjet e detajuara në skemat e çdo lokaliteti.





LEGJENJE

- Kufiri Administrativ
- Kufiri përshkrimi POST Alpe
- Fshat
- Shtetja
- Infrastruktura rrugore
- Linjat e transportit turistik

Itinerare turistike

- Uraza lindore
- Uraza perëndimore
- Uraza e prancizme
- Uraza e jashtme

Lokalitetet

Niveli i hierarkise

- (Large circle)
- (Medium circle)
- (Small circle)
- (Star)

INFLUENCA E LOKALITETEVE

Niveli

- 1 (Blue)
- 2 (Red)
- 3 (Yellow)
- 4 (Green)

Zonimi i pargëve / z. mbrojtura
Zona e PR Alpe

- Zona Ceramit
- Zona e Monumentit Eskuz
- Zona e Peshkëve Tripostall
- Zona e Zivillimit të Comarumit
- Zona Parku Bioshik (Kujaj - Mitite)
- Zona Qendrore Mbrojtje Niveli
- Zona e Peshkëve Tripostall
- Zona e Zivillimit të Comarumit
- Zona Pisha Qendrore Niveli
- Zona Qendrore
- Zona e Peshkëve Tripostall
- Zona e Shpatit të Vllashit
- Zona e Zivillimit të Comarumit

Sherbime dhe Aktivitete

- Limani aksionale
- Limani e propozuar
- Qazax
- Monumenti kulture
- Monumenti natyre
- Muze
- Ngjije shkenimore
- Parkim
- Teleshkoll
- Objekte kull
- Pika vizjente
- Q. shëndetësore
- Sipella
- Stane

10. Harta e nivelit dhe influencës së lokaliteteve

2.4.6 Kapaciteti akomodues optimal i lokaliteteve

Me identifikimin e lokaliteteve turistike të rajonit të Alpeve Shqiptare, është vlerësuar edhe kapaciteti akomodues optimal i secilit lokalitet. Ky kapacitet ka për qëllim të llogarisë numrin e akomodimeve (shtretërve) për të orientuar dhe shpërndarë ofertën turistike bazuar në parimet e PPK-së, zonave të mbrojtura mjedisore dhe të vetë Strategjisë të Zhvillimit të Turizmit në Alpe.

Në përcaktimin e kapacitetit akomodues, krahas parimeve të mësipërme janë marrë në konsideratë edhe faktorët e mëposhtëm si situata aktuale e akomodimeve, nevojat për përmirësime, rritja e cilësisë të strukturave, diversifikimi i ofertës së tipologjisë akomoduese, atraksionet e secilit lokalitet dhe masat për ruajtjen e florës e faunës, respektimin e tipologjisë urbane dhe arkitektonike të secilit lokalitet.

Këto parashikime do të orientojnë edhe nevojat e lokaliteteve për kapacitetet e infrastrukturës së furnizimit me ujë, kapacitetet e infrastrukturës së trajtimit të ujërave të zeza, përmirësimet e aksesit dhe transportit në zonë, kapacitetet energjitike, forcën e punës dhe nevojat për rritje kapacitetesh, etj.

Tejkalimi i kapacitetit akomodues optimal maksimal transformon në mënyrë të dëmshme destinacionin turistik, duke pasur për efekt sekondar cënimin e qëndrueshmërisë turistike dhe dëmtimin e avantazheve konkurruese të Alpeve Shqiptare.

Rezultatet e vlerësimit shfaqin intervalin në të cilin ndodhet kapaciteti akomodues optimal. Rezultatet për secilin lokalitet përmbledhen si në vijim:

Emri	Kapaciteti akomodues optimal (shtretër)	
	Minimumi	Maksimumi
Bajram Curri	500	550
Bogë	450	500
Çerem	150	200
Curraj i Epërm	250	300
Dushaj	100	150
Koman	200	250
Koplik	600	650
Lekbibaj	250	300
Lëpushë	550	600
Lugina e Kirit	150	200
Blini i Gurit të Lekës	200	250
Nënnavriq	700	750
Razëm	700	750
Reç	200	250
Rragam	150	200
Sulbicë	150	200
Tamarë - Selcë	600	650
Theth	1500	1550
Tropojë e Vjetër	650	700
Valbonë	1600	1650
Vermosh	950	1,000
Vukël	500	550
Gjithsej	11.100	12.200

Tabela 11. Kapaciteti akomodues optimal

Nëse do të bazohemi në kapacitetin akomodues optimal dhe në tendencat aktuale të kërkesës turistike për akomodim, mund të llogarisim afërsisht edhe numrin e shtretërve sipas tipit të strukturave akomoduese.


Për këtë qëllim, kapaciteti akomodues optimal ndahet në tre kategori kryesore strukturash akomoduese:


- Grupi 1 – Struktura hoteliere, më të cilat nënkuptohen hotele, hotele të shpërndara, motele, qendra kurative dhe resorte.
- Grupi 2 – Struktura akomoduese si: bujtina, fjetina, fjetje & mëngjes dhe strehim alpin.
- Grupi 3 – Struktura akomoduese si: kamping me çadra dhe kamping për kamper.

Nga kjo përlllogaritje rezulton se në zonën e studimit të PKST-Alpe mund të zhvillohen rreth 5610 - 6105 shtretër të strukturave të grupit 2, rreth 2920 - 3240 shtretër të strukturave të grupit 3, dhe rreth 2575 - 2860 shtretër të strukturave të grupit 1.

	Kapaciteti akomodues optimal	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3
Emri	(shtretër)	(shtretër)	(shtretër)	(shtretër)
Bajram Curri	500 - 550	450 - 495	0	50 - 55
Bogë	450 - 500	90 - 100	248 - 276	113 - 126
Çerem	150 - 200	0	105 - 140	45 - 60
Curraj i Epërm	250 - 300	125 - 150	75 - 90	50 - 60
Dushaj	100 - 150	70 - 105	10 - 15	20 - 30
Koman	200 - 250	140 - 175	20 - 25	40 - 50
Koplik	600 - 650	540 - 585	0	60 - 65
Lekbibaj	250 - 300	50 - 60	138 - 166	63 - 75.6
Lëpushë	550 - 600	0	385 - 420	165 - 180
Lugina e Kirit	150 - 200	30 - 40	83 - 111	38 - 51
Blini i Gurit të Lekës	200 - 250	0	40 - 50	160 - 200
Nënnavriq	700 - 750	140 - 150	385 - 413	175 - 188
Razëm	700 - 750	140 - 150	385 - 413	175 - 188
Reç	200 - 250	40 - 50	110 - 138	50 - 63
Rragam	150 - 200	0	105 - 140	45 - 60
Sulbicë	150 - 200	0	30 - 40	120 - 160
Tamarë - Selcë	600 - 650	120 - 130	330 - 358	150 - 163
Theth	1500 - 1550	0	1050 - 1085	450 - 465
Tropojë e Vjetër	650 - 700	130 - 140	358 - 386	163 - 176
Valbone	1600 - 1650	320 - 330	880 - 908	400 - 413
Vermosh	950 - 1000	190 - 200	523 - 551	238 - 251
Vukël	500 - 550	0	350 - 385	150 - 165
Gjithsej	11,100 - 12,200	2575 - 2860	5610 - 6105	2920 - 3240

Tabela 12. Kapaciteti akomodues optimal sipas kategorive të strukturave akomoduese





11. Kapaciteti akomodues optimal sipas kategorive të strukturave akomoduese për çdo lokalitet

2.5

MBROJTJA E PEIZAZHIT & SHPALLJA E ZONAVE TË RËNDËSISË KOMBËTARE

2.5.1 Çështjet e rëndësisë kombëtare

Zona në studim ka vlera dhe pasuri të shumta natyrore dhe kulturore, sikurse dëshmohet dhe nga prania e zonave të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Komiteti i Trashëgimisë Botërore i mbledhur në Krakovë, Poloni në datën 7 korrik 2017, miratoi zgjerimin e Zonës së Trashëgimisë Botërore të pyjeve të vjetër të ahut (*fagus sylvatica*, L.) me dy zona të tjera nga Shqipëria, njëra nga të cilat është zona e lumit të Gashit (Tropojë), duke e përfshirë atë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

PSKT-Alpe, bazuar në parimin e ruajtjes dhe promovimit të vlerave territoriale si dhe të trashëgimisë materiale e jomateriale, propozon si tema për t'u trajtuar në nivel kombëtar:

1. Ruajtjen e karakteristikave të peizazhit, si në zonat e mbrojtura mjedisore ashtu dhe në zonat jashtë parqeve. Ndër këto karakteristika veçojmë:

a. Vlerat natyrore:

- Kreshtat dhe majat e maleve terrenet e kullotave alpine
- Luginat e lumenjve dhe grykat e maleve me shpate të pjerrëta
- Liqenet alpine dhe zona natyrore përreth
- Gjeomonumentet

b. Peizazhin e krijuar nga dora e njeriut

- Peizazhet bujqësore-kulturore të mbrojtura (parcelizimi, kulturat bujqësore tradicionale, rrethimet tradicionale etj.)
- Fshatrat tradicionale: në tipologjinë arkitektonike dhe në tipologjinë hapësinore
- Monumentet e Trashëgimisë Kulturore dhe Historike
- Kullat dhe objektet individuale të banimit

Këto çështje duhet të detajohen më tej duke krijuar një pasqyrë të gjendjes aktuale, si dhe të paraqesin masa e mjete për ndërhyrje konservuese, restauruese apo thjesht mbrojtëse.

2. Zhvillimi i strukturave të sporteve dimërore dhe skive duhen të konsiderohet me interes publik, duke i klasifikuar këto struktura sipas një rregulloreje dhe legjislacioni të veçantë. Ndërtimi i strukturave të tilla ka aspekte pozitive si rritjen e sezonit turistik dhe zhvillimin ekonomik të zonës, gjë që ndikon negativisht në peizazh dhe në mjedis. Ndaj është i rëndësishëm që të hartohet një studim para-fizibiliteti që do të shtjellojë analizën territoriale, sociale, mjedisore dhe ekonomike të zonës së ndërhyrjes, si kusht për shqyrtimin e kërkesave dhe aplikimeve.

3. Curraj i Epërm është një zonë e karakterizuar nga peizazhet piktoreske por dhe nga elementet e ruajtura të arkitekturës tradicionale. Për këtë arsye ai konsiderohet një territor ku zhvillimi i turizmit duhet të orientohet jo vetëm me rregulla por edhe me ndërhyrje konkrete, si në nivelin infrastrukturor ashtu dhe në elementet restauruese, promovuese dhe në rritjen e kapaciteteve njerëzore.

Për Currajin e Epërm mund të hartohet një Plan i Detajuar për Zona të Rëndësisë Kombëtare (PDZ-RK) si zberthim i PKST-Alpe.



12. Kufiri i propozuar i Zonës së Rëndësisë Kombëtare

2.5.2 Zona e Rëndësisë Kombëtare - fshati Curraj i Epërm

Curraj i Epërm përbën një ndër perlat e natyrës shqiptare. I vendosur në një lartësi 800-900 m mbi nivelin e detit, rrethuar nga pyje dhe malet e larta (më e larta ndër to është “Maja e Hekurave” prej 2559,5 m), përbën pa dyshim një zone të rëndësisë kombëtare për shkak të peizazhit të pakrahasueshëm dhe pozicionimit gjeografik në parkun bashkiak të Nikaj-Mërturit. Një ndër figurat e shquara të kombit, Bajram Curri, e kishte origjinën nga ky fshat. Për momentin, ky fshat është atraksioni kryesor për vizitorët në zonë. Sipas shumë studiuesve, thuhet se origjina e poezisë epike shqiptare, ndër të tjera edhe këngët e Mujit dhe Halilit apo ajo e Gjergj Elez Alisë, vijnë nga kjo zonë.

Aktualisht tiparet natyrore (malet e larta, luginat e thella, lumenjtë dhe pyjet), tradita shekullore e përdorimit të qëndrueshëm të tokës dhe ruajtja e arkitekturës, përfaqësojnë një harmoni të përsosur ndërmjet njeriut dhe natyrës.

Deri tani zona nuk ka vuajtur nga ndërtimi i pakontrolluar, nga shpyllëzimet në shkallë të gjerë, bujqësia intensive, ndotja dhe ndikimet e tjera të jetës moderne. Në përgjithësi peizazhi mund të krahasohet me atë të parkut fqinj të Valbonës dhe të Thethit, por këtu ai është më i fragmentarizuar.

Lugina e Currajt të Epërm është një vend i jashtëzakonshëm, i rrethuar me maja të larta dhe tërësisht i izoluar, pa asnjë akses rrugor apo të energjisë elektrike. Kjo luginë është kultivuar kohë më parë por pothuajse është braktisur tërësisht me kalimin e kohës.

Pavarësisht nga niveli i lartë i reshjeve vjetore, zona vuan nga thatësira gjatë çdo sezoni veror. Gjeologjia nëntokësore, e përbërë tërësisht nga gëlqerorë, është pjesë e formimit karstik të harkut Dinarik, që karakterizohet nga pamundësia për të mbledhur dhe për të ruajtur ujin. Kështu në zonë ekzistojnë vetëm dy lumenj të përherëshëm: lumi i Currajt dhe ai i Nikajt. Të dy këta lumenj të vegjël bashkohen në Currajn e Poshtëm dhe formojnë lumin kryesor të zonës që është lumi i Nikajt, me një gjatësi rreth 19 km dhe sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës 145 km².

Shpellat karstike të zonës janë pothuajse fare të panjohura dhe gati të pazbuluara. Alpet veriore janë shumë të pasura me shpella, ashtu si i gjithë rajoni i harkut Dinarik. Deri tani vetëm pak nga këto shpella janë hulumtuar pjesërisht. Megjithatë, deri më sot asnjë shpellë nuk është e hapur për publikun dhe ende nuk ka studime të plota shkencore për lashtësinë, formën, shtrirjen, florën dhe faunën e tyre. Disa shpella si “Bira e zezë” kanë filluar të studjohen dhe të përshkruhen në mënyrë shkencore, ndërkohë që specialistë vendas e të huaj po punojnë për studimin e shpellave të tjera të zonës.

Të dhënat demografike:

Fshati	Popullsia gjithsej	Numri familjeve	Meshkuj	Femra	0-18 vjeç	Mbi 19 vjeç
Curraji Epërm	91	39	37	54	10	81
Njësia Lekbibaj	2175	671	1045	1130	493	1682

Monumentet e natyrës:

Rrasa e Currajt: Ndodhet në afërsi të fshatit Curraj i Poshtëm, njësia Lekbibaj e bashkisë të Tropojës, 830 m mbi nivelin e detit. Ajo përbën një thepisje të linjës së shkëputjes, me shtrirje nga Curraj i Epërm në Currajin e Poshtëm, që në reliev shprehet me një gur të thepisur me një gjatësi 1100 m, gjerësi 450 m dhe lartësi 400 m. “Rrasa e Currajt” ka disa shkallëzime të lehta në murin e saj por është e pakalueshme. Ajo ka vlera shkencore (gjeologjike dhe gjeomorfologjike), didaktike, ekologjike dhe kulturore, dhe vizitohet duke ndjekur degëzimin e rrugës rurale që nis nga rruga automobilistike e Bajram Currit për në fshatin Lekbibaj. Për të arritur tek monumenti, duhet të ndiqet më pas rruga këmbësore.

“Shkëmbi i forcës”: Gjendet në afërsi të fshatit Curraj i Epërm, njësia Lekbibaj e bashkisë Tropojë, 1700 m mbi nivelin e detit. Përbën një thepisje të linjës së shkëputjes, që në reliev shprehet me një gur gëlqeror me formë të veçantë (gjysmë harku). Ky monument natyror ka një gjatësi prej 500-600 m, gjerësi prej 200-300 m dhe lartësi prej 400 m. Në të ka një shkallëzim por është i pakalueshëm. “Shkëmbi i forcës” ka vlera shkencore gjeologjike, gjeomorfologjike, historike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Ai vizitohet duke ndjekur itinerarin e degëzimit të rrugës automobilistike Bajram Curri - Lekbibaj - Curraj i Epërm.

Ndërkohë në zonë ndodhet edhe një monument kulture që është kulla e ngujimit të Currajt të Epërm.

Kulla e ngujimit gjendet në qendër të fshatit Curraj i Epërm, pranë urës që bashkon dy brigjet e lumit Curraj në lagjen Nikbibaj. Ajo është ndërtuar rreth viteve 1840-1850 dhe konsiderohet si një nga kullat e gurit më të vjetra në malësitë e veriut. Kulla e ngujimit është e vendosur mbi një masiv shkëmbor gëlqeror rreth 15 m të lartë që gjendet buzë lumit të fshatit e që bie thikë mbi sipërfaqen e ujit. Pikërisht mbi këtë masiv shkëmbor ose thep, siç e quajnë vendasit masivin shkëmbor, nisin themelet e kullës e cila ngrihet në lartësi dominuese në ambientin rrethues, prandaj është quajtur dhe “kulla e thepit”.

Vlerat kulturore

Festat e zonës së Nikaj-Mërturit

- Veçantitë e kësaj zone janë ritet pagane, të vetmit në Shqipërinë e veriut që vajtojnë të vdekurin nga kori i burrave dhe që festojnë natën e Buzmit ndryshe nga viset e tjera.
- Në Nikaj-Mërtur ndodhet kisha më e vjetër në Veri. Sipas studjuesve, e folura e kësaj zone dhe fjalët e shprehjet e rralla që përdoren nga banorët, kanë veçori specifike.
- Arkitektura e ndërtimit të kullave me frëngji është karakteristike për Nikaj-Mërturin. Në Curraj të Epërm ndodhet, tashmë e vetmuar, kulla 200-vjeçare.

Potencialet e zonës - zhvillimi i turizmit

Natyra. Zona përbën një oaz natyror me një me një pasuri të madhe të florës e faunës dhe male madhështore. Njerëzit që adhurojnë natyrën kanë mundësinë për të eksploruar një nga zonat natyrore më të pasura të vendit.

Alpinizmi. Mund të thuhet se kjo zonë është një ndër vendet më të përshtatshme në Shqipëri për alpinizëm. Relievi ofron kushte shumë të mira për zhvillimin e alpinizmit amator dhe sidomos atij profesionist, pasi e gjithë zona rrethohet nga maja mbi 2000 m dhe me rrëpira të theksuara. Vendet më të përshtatshme për alpinizëm janë: Maja e Jezercës (rreth 20 km larg nga njësia Lekbibaj) dhe ajo e Hekurave, të cilat ndodhen në kufi të zonës dhe janë atraksione të përhershme të alpinistëve.

Shpellat. Në zonë ekzistojnë disa shpella ende të paeksploruara dhe të papërshkruara plotësisht.

Pavarësisht se nuk janë ende të hapura për publikun, ato përbëjnë një atraksion të veçantë dhe një potencial shumë të rëndësishëm për zonën. Shpella më interesante janë: "Bira e zezë" në Qeresh (ku sipas gojëdhënave dalja e saj është në Plavë), shpella e "Shkamit të Rajës", shpella e Kakverrit, shpella e bregut të Drinit - nën ujë "Të the Drini qafën". Është e nevojshme që për këto shpella të kryhen hulumtime shkencore (flora dhe fauna e tyre, përmasat, drejtimet, sistemet, veçantitë e tyre, vlerësimi i potencialit turistik, etj.), dhe ato të përfshihen në hartat apo guidat turistike të parkut.

Sportet ujore, rafting. Ato mund të ushtrohen në në të dy degët e lumit të Mërturit, Curraj e Mulaq-Qeresh, por edhe në "Lumin e zi" që buron nga bjeshkët e Kakisë.

Kanotazhi. Liqeni i Komanit përbën një vend ideal për ushtrimin e këtij sporti në zonë. Gjatësia e liqenit që shtrihet në territorin e njësishëm është rreth 12 km.

Çiklizmi Malor. Përveç rrugës kryesore që lidh qendrën e njësishëm me Tropojën, të gjitha rrugët e tjera që përshkruajnë fshatrat e njësishëm janë të pashtruara. Këto rrugë përbëjnë një potencial të rëndësishëm për zhvillimin e këtij sporti në të dy drejtimet: vertikal - duke përshkruar rrugët nga pjesa e poshtme e parkut drejt alpeve (Lekbibaj - Gjonpepaj - Peraj - Vranë, Lekbibaj - Tetaj - Btoshtë etj.), dhe horizontal - Lekbibaj - Kolec, Lekbibaj - Palç, Lekbibaj - Salcë, Tetaj - Betoshë etj.

Hipizmi. Është gjithashtu një sport potencial në zonë. Përveçse është mënyra më e mirë për të vizituar zonën, ai mund të zhvillohet edhe në formën e sportit. Vendet më të përshtatshme për hipizëm janë akset Lekbibaj - Salcë dhe Lekbibaj - Vranë.

Aeronautika. Përveç të tjerash, aeronautika është një mundësi për të promovuar zonën. Vendet më të përshtatshme janë në afërsi të fshatit Salcë, mbi fshatin Palç dhe mbi fshatin Kolec.

Agroturizmi. Agroturizmi përbën një potencial të rëndësishëm për zonën. Përdorimi tradicional i tokës, punimi dhe mirëmbajtja e saj, kultivimi, vjelja dhe përpunimi i produkteve, blegtorja dhe përpunimi i prodhimeve blegtorale, mund të jenë zgjidhje afatgjata për fermerët. Ky potencial mund të zhvillohet duke organizuar ferma të ndryshme

të zonës që merren me bujqësinë dhe blegtorinë, së paku një të tillë për çdo fshat. Fermat duhet të zbatojnë praktika të mira në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, duke u fokusuar vetëm tek prodhimet organike. Fermerët duhet të mbështeten që të shesin prodhimet e tyre të freskëta, gjysmë apo krejtësisht të përpunuara. Etiketa dhe ambalazhimet e prodhimeve janë shumë të rëndësishme në këtë proces.

Kampingjet. Kampingjet janë potenciale të rëndësishme për t'u zhvilluar në zonë. Të tilla janë ato të çiklistëve të natyrës, motoçiklistëve apo vizitorëve në grupe që preferojnë të qëndrojnë në natyrë. Vendet e kampingjeve duhen përcaktuar paraprakisht dhe duhen përfshirë në hartat turistike apo guidat e zonës.


Turizmi kulturor. Zona është e pasur me rite, tradita dhe zakone nga më uniket në vend. Ekspozimi i veshjeve tradicionale dhe vizitat në familjet që i punojnë këto veshje, pjesëmarrja në festat lokale, dasmat etj., përbëjnë të gjitha atraksion për vizitorët. Gjithashtu zona ofron potenciale për piktorët dhe fotografët e apasionuar pas natyrës, pasi liqenet, lumenjtë dhe peizazhet janë unike.

Afërsia me parqet e tjera. Curraj i Epërm ndodhet në Parkun Natyror Bashkiak të Nikaj-Mërturit, në zemër të Alpeve Shqiptare. Ai ndodhet ndërmjet Parkut Kombëtar të Luginës së Valbonës dhe të Thethit. Afërsia me këto dy parqe e bën atë një destinacion të rëndësishëm që i shton vlerat të gjithë rajonit të alpeve.

Peizazhi atipik, vlerat natyrore dhe kulturore, potenciali i zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme turistike, pozicionimi gjeografik etj., e rendisin fshatin e Currajt të Epërm si një zonë të rëndësishme kombëtare që do të fuqizojë avantazhet konkurruese të Alpeve Shqiptare në tregun ndërkombëtar.

2.6 KARAKTERISTIKAT & VEÇORITË E LOKALITEVEVE (SKEDAT)

2.6.1 Koplík - niveli I




1	Vendodhja dhe përshkrimi	<p>Lokaliteti Koplík ndodhet në bashkinë Malësi e Madhe dhe përfshin qendrën administrative të kësaj bashkie. Ky lokalitet është më i madh gjatë aksesit perëndimor të alpeve.</p> <p>Qyteti i Koplíkut është jo vetëm qendra e lokalitetit, por dhe qendra administrative ku përqendrohen shërbimet publike, autoritetet shtetërore, aktiviteti tregtar, shërbimet komerciale dhe shëndetësore të të gjithë Bashkisë Malësi e Madhe.</p>
---	--------------------------	---

1		<p>Lokaliteti i Koplikut shfaq një karakter rural, të pozicionuar pranë brigjeve të liqenit të Shkodrës dhe pikës kufitare të Hanit të Hotit. Ai ndodhet jashtë zonës që studion plani, por për shkak të pozicionit në aksin Han i Hotit- Shkodër, është vendbanimi më i madh pranë aksesit perëndimor të alpeve.</p> <p>Vendbanimi ka karakter urban dhe pjesa më e madhe e ndërtesave janë struktura të ulëta të para viteve '90.</p> <p>Lokaliteti i Koplikut është konsideruar si pikënisje ose zonë hyrëse për në anën perëndimore të alpeve.</p> <p>Në lokalitet dhe në afërsi të tij gjenden monumente kulture dhe natyre.</p>
2	Fshatra ⁹	Koplik, Koplik i Sipërm, Zagorë, Lohë e Sipërme, Dedaj
3	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	<p>Lokaliteti Koplik, ndodhet në afërsi të zonës së mbrojtur mjedisore të Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit.</p> <p>Zhvillimi lokalitetit do të marrë në konsideratë Planin e Menaxhimit të Parkun Natyror Bashkiak të Shkrelit, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e shërbimeve të vizitorëve; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm; <p>dhe Rezervatin natyror të menaxhuar/ Park Natyror të Liqenit të Shkodrës (VKM nr. 684, datë 02.11.2005).</p> <p>Në lokalitet dhe në afërsi të tij gjenden monumente kulture dhe natyre.</p>
4	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi argëtues dhe rekreativ • Turizmi i evenimenteve • Turizmi ujor • Turizmi i biznesit ose profesional
5	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale • Turizmi i historisë dhe kulturës lokale • Turizmi industrial dhe artizanal • Turizmi krijues • Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore • Turizmi i çiklizmit • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit • Turizmi shëndetësor • Turizmi social dhe i solidaritetit
6	Shembuj aktivitetesh sipas turizmit kryesor	<p>Aktivitete të ndryshme rekreative si: shëtitje me biçikleta, xhiro me balonë, shëtitje në liqen, tenis, volejbol, futboll, basketboll, ping pong, paint-boll etj.</p> <p>Pjesëmarrje në evenimente, festivale, panaire, ekspozita në fusha të ndryshme si: kultura, sporti, folklori, kinematografia, teatri, bujqësia etj.</p> <p>Përdorimi i liqenit të Shkodrës për aktivitete nautike, si p.sh.: vizita në brigje dhe gjire natyrore me vlera peizazhiste ose gjeomonte ujore; aktivitete ujore si peshkim, kanoe, not, waterballs etj.</p>

⁹ Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

6		Pjesëmarrje në aktivitete profesionale, si: konferenca, mbledhje dhe takime profesionale, pjesëmarrje në evente certifikimi dhe formimi profesional etj.	
7	Tipologjia e strukturave akomoduese	Hotel me kapacitet të lartë, hotele me kapacitet të mesëm, hotele me kapacitet të ulët, shtëpi ose banesa me qira, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks, motel.	
8	Kapaciteti akomodues	Aktual	Optimal
		Total: 120 shtretër Hotel: 70 shtretër Bujtina: 0 shtretër Kamping: 50 shtretër	Total: 600-650 shtretër Grupi 1: 550 shtretër Grupi 2: 0 shtretër Grupi 3: 100 shtretër
9	Parkimet e nevojshme për turistët	60-70 vende parkimi publik për turistët Parkimet e terminalit turistik dhe pikës informative e logjistike, të përfshira në vlerën e mësipërme, do të përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura.	
10	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Pikë lidhëse e turizmit malor me atë liqenor (Liqeni i Shkodrës), përmirësimi i infrastrukturës të transportit.</p> <p>Sistemimi i hapësirës për terminalin turistik dhe pikë informative dhe logjistike në funksion të turizmit malor.</p> <p>Ndërtimi i strukturave të shërbimeve turistike: infopoint, dyqane, dhënie me qira automjetesh dhe pajisjesh për turizmin e aventurës dhe sportit.</p> <p>Përmirësim i infrastrukturës rrugore hyrëse në Alpe. Lidhja e turizmit me aktivitetet bujqësore të fshatit: tregje, panairë etj.</p>	
11	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë plani i menaxhimit të Rezervatit Natyror të Liqenit të Shkodrës.</p> <p>Lokaliteti i Koplikut, një zonë e konsoliduar urbane ndryshe nga lokalitetet e tjera më të ndjeshme nga pikëpamja mjedisore, është pika në të cilën takohet turizmi malor me atë liqenor. Në këtë lokalitet synohet zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për turizmin.</p> <p>Duhet të merren në konsideratë parashikimet e PPV Malësi e Madhe. Synohet ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore. Në zonë, krahas strukturave akomoduese, duhet të orientohet zhvillimi i strukturave të shërbimeve tregtare turistike dhe gastronomike.</p> <p>Gërshetim i turizmit natyror dhe atij të bizneseve dhe konferencave të lidhur me prodhimin ekonomik dhe bujqësor. Krijimi i një qendre turistiko-logjistike, e cila do të ketë në fokus kryesisht turistët, por do të shërbejë edhe për banorët.</p> <p>Kjo qendër synon të krijojë një pol të ri zhvillimi të dedikuar kryesisht për turistët. Rivitalizimi i hapësirës së zgjedhur do të ndikojë në përmirësimin e hapësirës publike nga ana arkitektonike dhe funksionale duke integruar shërbime të nevojshme për turistët. Përmirësimi i rrjetit infrastrukturor, veçanërisht segmenti Koplík - Koplík i Sipërm - Dedaj si rrugë hyrëse për në Alpet perëndimore.</p> <p>Në sistemin natyror lejohen kampingje me çadra si dhe struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën si në parametra ashtu dhe në materiale.</p>	

2.6.2 Bajram Curri - niveli I




1	Vendodhja dhe përshkrimi	<p>Lokaliteti i Bajram Currit ndodhet në bashkinë Tropojë dhe përfshin qendrën administrative të kësaj bashkie. Ky lokalitet është më i madhi pranë hyrjes lindore të alpeve.</p> <p>Qyteti i Bajram Currit është jo vetëm qendra e lokalitetit, por dhe qendra administrative ku përqendrohen shërbimet publike, autoritetet shtetërore, aktiviteti tregtar, shërbimet komerciale dhe shëndetësore të bashkisë Tropojë.</p> <p>Ky lokalitet shërben si zonë hyrëse për flukset turistike ndërkombëtare që vijnë nga Kosova.</p> <p>Vendbanimi ka karakter urban dhe pjesa më e madhe e ndërtesave janë struktura të para viteve '90.</p> <p>Qendra e qytetit është organizuar në dy sheshe të lidhur me njëri-tjetrin: sheshi kulturor pranë muzeut të Bajram Currit dhe sheshi administrativ pranë bashkisë.</p> <p>Në lokalitet dhe në afërsi të tij gjenden monumente kulture dhe natyre.</p>
2	Fshatra ¹⁰	Bajram Curri, Bujan, Gri, Lëkurtaç, Selimaj, Margegaj, Dojan, Bllatë, Koçanaj, Shoshan, Markaj, Babinë

¹⁰ Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

3	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	<p>Në afërsi të lokalitetit të Bajram Currit, ndodhen zonat e mbrojtura mjedisore të Parkut Kombëtar të Alpeve dhe Parkut Natyror Bashkiak Nikaj – Mërtur.</p> <p>Zhvillimi i lokalitetit do të marrë në konsideratë Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e menaxhimit efektiv; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm; <p>dhe Planin e Menaxhimit të Parkut Natyror Bashkiak Nikaj – Mërtur, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm. <p>Në lokalitet dhe në afërsi të tij gjenden monumente kulture dhe natyre.</p>						
4	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi i historisë dhe kulturës lokale • Turizmi argëtues dhe rekreativ • Turizmi i evenimenteve • Turizmi i biznesit ose profesional • Turizmi shëndetësor 						
5	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi malor dhe hapësirave natyrore • Turizmi ujor • Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore • Turizmi industrial dhe artizanal • Turizmi krijues • Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale • Turizmi i çiklizmit • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit • Turizmi social dhe i solidaritetit 						
6	Shembuj aktivitetesh sipas turizmit kryesor	<p>Vizita në muzeun e Bajram Currit dhe në monumentet e kulturës, kulla historike, vende historike dhe legjendare, galeri arti, njohje me zakonet dhe rregullat sociale të zonës, folklorin dhe legjendat lokale, kurse kërcimi të valleve popullore dhe të mësimin të veglave muzikore lokale, udhëtime nëpër itinerare kulturore etj.</p> <p>Aktivitete të ndryshme rekreative, si: shëtitje me biçikleta, xhiro me balonë, tenis, volejbol, futboll, basketboll, ping pong, paint-boll, zip-line, si dhe aktivitete dimërore si ski dhe slita, etj.</p> <p>Pjesëmarrje në evenimente, festivale, panairë, ekspozita në fusha të ndryshme si: kultura, sporti, folklori, kinematografia, teatri, bujqësia etj.</p>						
7	Tipologjia e strukturave akomoduese	<p>Hotele me kapacitet të lartë, hotele me kapacitet të mesëm, hotele me kapacitet të ulët, motele, shtëpi ose banesa me qira, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks.</p>						
8	Kapaciteti akomodues	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 50%; text-align: center;">Aktual</th> <th style="width: 50%; text-align: center;">Optimal</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><i>Total:</i> 350 shtretër</td> <td><i>Total:</i> 500-550 shtretër</td> </tr> <tr> <td>Hotel: 350 shtretër Bujtina: 0 shtretër Kamping: 0 shtretër</td> <td>Grupi 1: 500 shtretër Grupi 2: 0 shtretër Grupi 3: 100 shtretër</td> </tr> </tbody> </table>	Aktual	Optimal	<i>Total:</i> 350 shtretër	<i>Total:</i> 500-550 shtretër	Hotel: 350 shtretër Bujtina: 0 shtretër Kamping: 0 shtretër	Grupi 1: 500 shtretër Grupi 2: 0 shtretër Grupi 3: 100 shtretër
Aktual	Optimal							
<i>Total:</i> 350 shtretër	<i>Total:</i> 500-550 shtretër							
Hotel: 350 shtretër Bujtina: 0 shtretër Kamping: 0 shtretër	Grupi 1: 500 shtretër Grupi 2: 0 shtretër Grupi 3: 100 shtretër							

9	Parkimet e nevojshme për turistët	<p>50-60 vende parkimi publik për turistët</p> <p>Parkimet e terminalit turistik dhe pikës informative e logjistike të përfshira në vlerën e mësipërme, do të përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura.</p>
10	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Sistemimi i hapësirës për terminalin turistik.</p> <p>Ndërtimi i strukturave të shërbimeve turistike: infopoint, dyqane, dhënie me qira automjeteve dhe pajisjesh për turizmin e aventurës dhe sportit.</p> <p>Përmirësim i infrastrukturës rrugore hyrëse në Alpe.</p> <p>Lidhja e turizmit me aktivitetet kulturore dhe administrative të qytetit: muze, teatër, kinema, stadium, biblioteke, si dhe aktivitetet bujqësore të fshatrave përreth: tregje e panairë etj.</p> <p>Ndërtimi i një landfilli për mbetjet në Bashkinë e Tropojës që do t'i shërbejë të gjithë anës lindore të Alpeve shqiptare dhe lokaliteteve në afërsi të qytetit të Bajram Currit.</p>
11	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve dhe Parkut Natyror Bashkiak Nikaj – Mërtur.</p> <p>Lokaliteti i Bajram Currit është një zonë e konsoliduar urbane ndryshe nga lokalitetet e tjera që janë më të ndjeshme nga pikëpamja mjedisore. Është pika në të cilën takohet turizmi malor me atë urban. Në këtë lokalitet synohet zhvillimi i infrastrukturës mbështetëse për turizmin.</p> <p>Duhet të merren në konsideratë parashikimet e PPV Tropojë. Synohet ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore.</p> <p>Në zonë, krahas strukturave akomoduese duhet të orientohet zhvillimi i strukturave të shërbimeve tregtare turistike dhe gastronomike.</p>

2.6.3 Vermosh - niveli II




1	Vendodhja dhe përshkrimi	<p>Lokaliteti i Vermoshit ndodhet në skajin më verior të Republikës së Shqipërisë, në kuotën 1200 m mbi nivelin e detit, në njësinë administrative të Kelmendit. Lokaliteti ndodhet brenda kufirit të Parkut të Alpeve dhe aksesohet me rrugë automobilistike nëpërmjet lokalitetit të Tamarës dhe pikës kufitare me Malin e Zi, duke shërbyer si zonë hyrëse për flukset turistike ndërkombëtare që vijnë nga Mali i Zi.</p> <p>Peizazhi natyror dhe malor, lugina e gjerë, reshjet e dëborës që zgjasin afro 100 ditë në vit, cilësia e produkteve dhe nën-produkteve bujqësore, janë avantazhet kryesore të zonës, të cilat lehtësojnë zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme turistike.</p> <p>Lokaliteti lidhet me Lëpushën nëpërmjet shtigjeve natyrore.</p> <p>Lokaliteti karakterizohet nga arkitektura tipike e malësisë së Kelmendit. Banesat janë të shpërndara dhe nuk ka një qendër të konsoliduar të vendbanimeve.</p> <p>Në lokalitet gjenden pasuri natyrore, peizazhistike si dhe gjurmë të ngjarjeve historike.</p>
2	Fshatra ¹¹	Vermosh

¹¹ Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

3	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	<p>Lokaliteti Vermosh ndodhet në zonë e mbrojtur mjedisore të Parkut Kombëtar të Alpeve.</p> <p>Zhvillimi i lokalitetit do të bazohet në Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e menaxhimit efektiv; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm. <p>Në lokalitet gjenden pasuri natyrore, peizazhistike si dhe gjurmë të ngjarjeve historike.</p>
4	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit • Turizmi malor dhe hapësirave natyrore • Turizmi i parqeve dhe zonave të mbrojtura • Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore • Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale • Turizmi i qëndrueshëm / ekoturizëm / ekologjik
5	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi i historisë dhe kulturës lokale • Turizmi i aeronautikës • Turizmi industrial dhe artizanal • Turizmi shkencor • Turizmi krijues • Turizmi argëtues dhe rekreativ • Turizmi i çiklizmit • Turizmi i evenimenteve • Turizmi shëndetësor • Turizmi social dhe i solidaritetit
6	Shembuj aktivitetesh sipas turizmit kryesor	<p>Ecje dhe aktivitete në natyrë (hiking, trekking, alpinizëm, via ferrata etj.) Vizita në zona të mbrojtura, rezerva natyrore, monumente të natyrës etj.</p> <p>Shëtitje në natyrë dhe në shtigjet panoramike (në këmbë, kuaj dhe mushkë), vizita në monumente të natyrës (gjeomonumente, ujëvara, kanione, pyje, lumenj, përrenj, shpella, korridore të gjelbër), piknik, shëtitje me ski, ski nordike, ecje me raketa, slita etj.</p> <p>Vizita në ferma bujqësore, blegtorale dhe baxho, degustim i produkteve lokale, pjesëmarrje në aktivitetet e fermës, korrije dhe mbledhje e produkteve bujqësore lokale etj.</p> <p>Frekuentimi i bareve dhe restoranteve me ushqime dhe pije lokale, blerje e produkteve lokale, mësimi i proceseve të përpunimit dhe përgatitjes të specialiteteve lokale etj.</p> <p>Vizita dhe ekskursione në zona me biodiversitet të lartë, rezerva natyrore, parqe natyrore, studim i florës dhe faunës etj.</p> <p>Kurse dhe aktivitete sensibilizuese për problematikat mjedisore, për ruajtjen e biodiversitetin dhe specieve në zhdukje etj.</p>
7	Tipologjia e strukturave akomoduese	<p>Bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, hotele me kapacitet të ulët, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks, qendra kurative, shtëpi ose banesa me qira, resorte, strehime alpin.</p>

8	Kapaciteti akomodues	Aktual	Optimal
		Total: 157 shtretër Hotel: 16 shtretër Bujtina: 141 shtretër Kamping: 0 shtretër	Total: 950-1000 shtretër Grupi 1: 225 shtretër Grupi 2: 575 shtretër Grupi 3: 200 shtretër
9	Parkimet e nevojshme për turistët	95-105 vende parkimi publik për turistët Parkimet e stacioneve turistike dhe pikës informative e logjistike, të papërfshira në vlerën e mësipërme, do përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura.	
10	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Sistemimi i rrugës hyrëse dhe ndërtimi i infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve publike. Krijimi i parkimeve publike të përshtatur edhe për autobusë. Përcaktimi dhe vendosja e sinjalistikës në shtigjet drejt bjeshkëve dhe kullotave alpine (staneve), potenciale për zhvillimin e sporteve dimërore.</p> <p>Rinovimi i bujtinave në përshtatje me arkitekturën tradicionale. Pika promovimi dhe tregtimi të produkteve tradicionale gastronomike, etnografike dhe të artizanatit. Pika shitjeje guidash dhe produktesh në funksion të turizmit. Identifikimi i hapësirave të nevojshme për ngritjen e kampingjeve. Trajnimi i mikpritësve në ofrimin e shërbimeve dhe informacionit turistik për lokalitetin.</p>	
11	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve. Duhet të merren në konsideratë parashikimet e PPV Malësi e Madhe. Ruajtja e vlerave natyrore dhe kulturore është parësore për këtë zonë. Zona ka vlera të larta mjedisore, dhe ndërhyrjet duhet të jenë të mirëorientuara në ruajtjen e këtyre vlerave. Synohet shtimi i vendbanimeve ekzistuese dhe ndërtimi i strukturave akomoduese në to përpara shtrirjes në zona të reja.</p> <p>Zhvillimi i zonës duhet të marrë në konsideratë rigjallërimin e godinave aktualisht pa funksion, vlerësimin e peizazhit, ndërhyrjet rrikualifikuese në bujtinat ekzistuese dhe ndërtimin e strukturave të reja akomoduese.</p> <p>Përparësi ka rikonstrukcioni dhe kthimi i objekteve ekzistuese në hotele, bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, pika tregtimi, bare, restorante, etj., si dhe rinovimi, përmirësimi i standardeve dhe rritja e efikasitetit energjetike.</p> <p>Duhet të përmirësohet infrastruktura mbi shtratin e lumit. Rehabilitimi i qendrës së fshatit për aktivitete të ndryshme sociale si festa tradicionale apo evente turistike. Zona duhet të pajiset me infrastrukturë të përshtatshme për këto aktivitete duke sistemuar edhe ndriçimin urban. Në bujtina lejohet vendosja e çadrave dhe rulotëve brenda pronësisë së bujtinës. Në sistemin natyror lejohen kampingje me çadra, strehime alpine si dhe struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën si në parametra ashtu dhe në materiale. Stanet duhen kthyer në struktura akomoduese (rinovim, prishje dhe rindërtim). Përparësi është edhe krijimi i një pike informacioni dhe shërbimesh pranë pikës kufitare.</p>	

2.6.4 Tamarë-Selcë - niveli II




1	Vendodhja dhe përshkrimi	<p>Lokaliteti ndodhet në njësinë administrative të Kelmendit, është jashtë kufirit të Parkut të Alpeve dhe aksesohet me rrugë automobilistike nëpërmjet lokalitetit të Koplikut.</p> <p>Lidhet me Lëpushën nëpërmjet shtigjeve natyrore. Lokaliteti karakterizohet nga arkitektura tipike e malësisë së Kelmendit.</p> <p>Në lokalitet gjenden pasuri natyrore dhe peizazhistike.</p>
2	Fshatra ¹²	Tamarë, Brojë, Kozhnjë, Selcë
3	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	<p>Lokaliteti Tamarë-Selcë ndodhet në afërsi të zonës së mbrojtur mjedisore të Parkut Kombëtar të Alpeve.</p> <p>Zhvillimi lokalitetit do të marrë në konsideratë Planin e Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e menaxhimit efektiv; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm. <p>Në lokalitet gjenden pasuri natyrore dhe peizazhistike.</p>

¹² Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

4	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi malor dhe hapësirave natyrore • Turizmi ujor • Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit • Turizmi argëtues dhe rekreativ 										
5	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi i historisë dhe kulturës lokale • Turizmi industrial dhe artizanal • Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore • Turizmi krijues • Turizmi i çiklizmit • Turizmi i aeronautikës • Turizmi i evenimenteve • Turizmi shëndetësor 										
6	Shembuj aktiviteteve sipas turizmit kryesor	<p>Shëtitje në natyrë dhe në shtigje panoramike (në këmbë, kuaj dhe mushkë), vizita në monumente të natyrës (gjeomonumente, ujëvara, kanione, pyje, lumenj, përrenj, shpella, korridorë të gjelbër), piknik, shëtitje me ski, ski nordike, ecje me raketa, slita etj.</p> <p>Përdorimi i rrjedhës së lumit për aktivitete nautike, si p.sh.: vizita në brigje me vlera peizazhistike, gjeomonumente ujore, aktivitete ujore si peshkim, kanoe, kajak, rafting, canyoning, not etj.</p> <p>Frekuentimi i bareve dhe restoranteve me ushqime dhe pije lokale, blerje e produkteve lokale, mësimi i proceseve të përpunimit dhe përgatitjes të specialiteteve lokale etj.</p> <p>Ecje dhe aktivitete në natyrë (hiking, trekking, alpinizëm, via ferrata etj).</p> <p>Aktivitete të ndryshme rekreative si: shëtitje me biçikleta, mountain-bike, xhiro me balonë, mountain-board, kërcim me elastik, tenis, volejbol, futboll, basketboll, ping pong, paint-boll, zip-line, gara orientimi, aktivitete dimërore si ski, slita, snow-kite, ecje me raketa etj.</p>										
7	Tipologjia e strukturave akomoduese	Bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, kamping me çadra, kamping për kamper, kamping miks, hotele me kapacitet të ulët, qendër kurative, shtëpi ose banesa me qira, resorte.										
8	Kapaciteti akomodues	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Aktual</th> <th>Optimal</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Total: 22 shtretër</td> <td>Total: 600-650 shtretër</td> </tr> <tr> <td>Hotel: 0 shtretër</td> <td>Grupi 1: 150 shtretër</td> </tr> <tr> <td>Bujtina: 22 shtretër</td> <td>Grupi 2: 350 shtretër</td> </tr> <tr> <td>Kamping: 0 shtretër</td> <td>Grupi 3: 150 shtretër</td> </tr> </tbody> </table>	Aktual	Optimal	Total: 22 shtretër	Total: 600-650 shtretër	Hotel: 0 shtretër	Grupi 1: 150 shtretër	Bujtina: 22 shtretër	Grupi 2: 350 shtretër	Kamping: 0 shtretër	Grupi 3: 150 shtretër
Aktual	Optimal											
Total: 22 shtretër	Total: 600-650 shtretër											
Hotel: 0 shtretër	Grupi 1: 150 shtretër											
Bujtina: 22 shtretër	Grupi 2: 350 shtretër											
Kamping: 0 shtretër	Grupi 3: 150 shtretër											
9	Parkimet e nevojshme për turistët	<p>60-70 vende parkimi publik për turistët</p> <p>Parkimet e stacioneve turistike dhe pikës informative e logjistike, të papërfshira në vlerën e mësipërme, do përcaktohen në fazën e projektit të secilës nga këto struktura.</p>										
10	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Krijimi i parkimeve publike të përshtatur edhe për autobusë.</p> <p>Përcaktimi dhe vendosja e sinjalistikës në shtigjet drejt bjeshkëve dhe kullotave alpine (staneve), potenciale për zhvillimin e sporteve dimërore.</p> <p>Rinovimi i bujtinave në përshtatje me arkitekturën tradicionale.</p>										

10		<p>Pika promovimi dhe tregtimi të produkteve tradicionale gastronomike, etnografike, artizanati.</p> <p>Pika shitjeje guidash dhe produktesh në funksion të turizmit. Identifikimi i hapësirave të nevojshme për ngritjen e kampingjeve.</p> <p>Trajnimi i mikpritësve në ofrimin e shërbimeve dhe informacionit turistik për lokalitetin.</p>
11	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit duhet të merret në konsideratë sipas rastit Plani i Përgjithshëm Vendor dhe Planet e Detajuara Vendore.</p> <p>Zhvillimi i shërbimeve të akomodimit synon ruajtjen e vlerave natyrore. Zona ka vlera të larta mjedisore, dhe ndërhyrjet duhet të jenë të mirëorientuara për ruajtjen e këtyre vlerave.</p> <p>Synohet shtimi i vendbanimeve ekzistuese dhe ndërtimi i strukturave akomoduese në to, përpara shtrirjes në zona të reja.</p> <p>Synohen ndërhyrjet rikualifikuese në bujtinat ekzistuese dhe ndërtimi i strukturave të reja akomoduese.</p> <p>Zona duhet të pajiset me infrastrukturë të përshtatshme për aktivitete duke sistemuar edhe ndriçimin urban, veçanërisht në Selcë. Në Tamarë projekti i rikualifikimit urban duhet të shtrihet edhe në pjesën tjetër të qendrës.</p> <p>Duhet të riaktivizohen zonat ushtarake në shërbim të turizmit dhe komunitetit.</p> <p>Përparësi ka rikonstrukcioni dhe kthimi i objekteve ekzistuese në hotele, bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, pika tregtimi, bare, restorante, etj., si dhe rinovimi, përmirësimi i standardeve dhe rritja e efikasitetit energjetike.</p> <p>Në bujtina lejohet vendosja e çadrave dhe rulotëve brenda pronësisë së bujtinës.</p> <p>Në sistemin natyror lejohen kampingje me çadra, strehime alpine, si dhe struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën si në parametra ashtu dhe në materiale. Stanet duhen kthyer në struktura akomoduese (rinovim, prishje dhe rindërtim).</p>

2.6.5 Razëm - niveli II




1	Vendodhja dhe përshkrimi	<p>Lokaliteti i Razmës ndodhet në njësinë administrative të Shkrelit, jashtë kufirit të Parkut të Alpeve por pjesë e Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit. Aksesohet me rrugë automobilistike nëpërmjet lokalitetit të Koplikut.</p> <p>Ky lokalitet evidentohet si një ndër pikat turistike në afërsi me qytetin e Shkodrës, karakterizuar nga një pllajë karstike, zona të pyllëzuara, kullota alpine dhe një relief me kontraste të larta. Lokaliteti lidhet me lokalitetin e Bogës nëpërmjet shtigjeve. Lokaliteti karakterizohet nga arkitektura tipike e malësisë së Kelmendit.</p> <p>Është ndër zonat me traditë të hershme në fushën turizmit malor me pasuri të shumta natyrore dhe peizazhistike.</p>
2	Fshatra ¹³	Vrith, Razëm (Vrith), Bzhetë-Markaj, Vuç-Kurtaj
3	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	Lokaliteti Razëm ndodhet brenda zonës së mbrojtur të Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit.

¹³ Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

3		<p>Zhvillimi i lokalitetit do të bazohet në Planin e Menaxhimit të Parkut Natyror Bashkiak të Shkrelit, ku identifikohen nën-zonat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zonë qendrore; • Zonë e shërbimeve të vizitorëve; • Zonë e përdorimit tradicional; • Zonë e zhvillimit të qëndrueshëm. <p>Është ndër zonat me traditë të hershme në fushën turizmit malor ku gjenden pasuri të shumta natyrore dhe peizazhistike.</p>						
4	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi malor dhe hapësirave natyrore • Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore • Turizmi i gastronomisë dhe produkteve lokale • Turizmi argëtues dhe rekreativ • Turizmi i evenimenteve • Turizmi shëndetësor 						
5	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi industrial dhe artizanal • Turizmi krijues • Turizmi i çiklizmit • Turizmi i speleologjisë • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit 						
10	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Përcaktimi dhe vendosja e sinjalistikës në shtigjet drejt bjeshkëve dhe kullotave alpine (staneve), potenciale për zhvillimin e sporteve dimërore.</p> <p>Rinovimi i bujtinave në përshtatje me arkitekturën tradicionale.</p> <p>Identifikimi i hapësirave të nevojshme për ngritjen e kampingjeve.</p> <p>Trajnimi i mikpritësve në ofrimin e shërbimeve dhe informacionit turistik për lokalitetin</p> <p>Zbatimi i programeve të Planit të Menaxhimit të Parkut për orientimin e vizitorëve në zona të aksesueshme ose jo, rregullat e përdorimit të parkut etj.</p>
11	Kushte specifike për zhvillim	<p>Për zhvillimin e lokalitetit është e nevojshme të merret në konsideratë Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të Alpeve.</p> <p>Duhet të merren në konsideratë parashikimet e PPV Tropojë.</p> <p>Zhvillimi i shërbimeve të akomodimit synon ruajtjen e vlerave natyrore. Zona ka vlera të larta mjedisore dhe ndërhyrjet duhet të jenë të mirëorientuara në ruajtjen e këtyre vlerave.</p> <p>Stanet duhet të kthehen në struktura akomoduese (rinovim, prishje dhe rindërtim), duke minimizuar ndërhyrjet e reja. Prioritet janë rinovimi, përmirësimi i standardeve dhe rritja e efikasitetit energjetik. Në zonë duhet kufizuar aksesin e mjeteve private. Rrugët nuk duhet të jenë të asfaltuara.</p>


2.6.22 Blini i Gurit të Lekës - niveli IV



1	Vendodhja dhe përshkrimi	<p>Lokaliteti i Blini i Gurit të Lekës, lumi i Shalës, ndodhet në njësinë administrative Temal, jashtë kufirit të Parkut të Alpeve, dhe aksesohet nëpërmjet itinerarit lundruar apo me nëpërmjet shtigjeve natyrore me lokalitetin e Nënnavriqit.</p> <p>Lokaliteti lidhet me lokalitetin e Currajve të Epërm nëpërmjet shtigjeve.</p> <p>Lokaliteti karakterizohet nga arkitektura tipike e malësisë së Dukagjinit. Banesat janë të shpërndara dhe nuk ka një qendër të konsoliduar të vendbanimeve.</p> <p>Në lokalitet gjenden pasuri natyrore dhe peizazhiste.</p>
2	Fshatra ³⁰	Arrë, Vilë, Malagji-Kajvall, Pepsuj, Kllogjen, Toplanë, Sermë
3	Statusi si pjesë e zonave të mbrojtura	Në lokalitetin e Blinit të Gurit të Lekës, lumi i Shalës dhe në afërsi të tij, gjenden pasuri natyrore, peizazhiste, monumente kulturore si dhe site arkeologjike.
4	Turizmi kryesor	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi malor dhe hapësirave natyrore • Turizmi ujor
5	Turizmi mbështetës	<ul style="list-style-type: none"> • Turizmi i ecjes në natyrë dhe alpinizmit • Turizmi i speleologjisë

³⁰ Bazuar në Ligjin Nr. 115/2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"

6	Shembuj aktivitetesh sipas turizmit kryesor	<p>Shëtitje në natyrë dhe në shtigje panoramike (në këmbë, kuaj dhe mushkë), vizita në monumente të natyrës (gjeomonumente, ujëvara, kanione, pyje, lumenj, përrenj, shpella, korridore të gjelbër), piknik, shëtitje me ski, ski nordike, ecje me raketa, slita etj.</p> <p>Përdorimi i rrjedhës së lumit dhe liqenit të Komanit për aktivitete nautike, si p.sh. vizita në brigje me vlera peizazhistike, gjeomonumente ujore, aktivitete ujore si peshkim, kanoe, kajak, not etj.</p>	
7	Tipologjia e strukturave akomoduese	Kamping me çadra, bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina.	
8	Kapaciteti akomodues	Aktual	Optimal
		<p>Total: 0 shtretër</p> <p>Hotel: 0 shtretër</p> <p>Bujtina: 0 shtretër</p> <p>Kamping: 0 shtretër</p>	<p>Total: 200-250 shtretër</p> <p>Grupi 1: 0 shtretër</p> <p>Grupi 2: 50 shtretër</p> <p>Grupi 3: 200 shtretër</p>
9	Parkimet e nevojshme për turistët	15-25 vende parkimi publik për turistët	
10	Ndërhyrjet e nevojshme	<p>Ndërtim stacioni ankorimi vetëm për pasagjerë në brendësi të luginës së Shalës për mjete lundruese të kapacitetit të ulët.</p> <p>Përcaktimi dhe vendosja e sinjalistikës në shtigjet drejt bjeshkëve dhe kullotave alpine (staneve), potenciale për zhvillimin e sporteve dimërore.</p> <p>Rinovimi i bujtinave në përshtatje me arkitekturën tradicionale.</p> <p>Pika promovimi dhe tregtimi të produkteve tradicionale gastronomike, etnografike, artizanati.</p> <p>Pika shitjeje guidash dhe produktesh në funksion të turizmit.</p> <p>Identifikimi i hapësirave të nevojshme për ngritjen e kampingjeve.</p> <p>Trajnimi i mikpritësve në ofrimin e shërbimeve dhe informacionit turistik për lokalitetin</p>	
11	Kushte specifike për zhvillim	<p>Zhvillimi i shërbimeve të akomodimit, gastronomisë dhe rekreacionit synon ruajtjen e vlerave natyrore.</p> <p>PPV duhet të marrë në konsideratë densifikimin e fshatrave ekzistuese dhe ndërtimin e strukturave akomoduese në to përpara shtrirjes në zona të reja.</p> <p>Përparësi ka rikonstrukcioni dhe kthimi i objekteve ekzistuese në bujtina, fjetje dhe mëngjes, fjetina, pika tregtimi, bare, restorante, etj.</p> <p>Në bujtina lejohet vendosja e çadrave dhe rulotëve brenda pronësisë së bujtinës.</p> <p>Në sistemin natyror lejohen vetëm kampingje me çadra si dhe struktura për shërbime gastronomike dhe rekreative që duhet të jenë miqësore me natyrën si në parametra ashtu dhe në materiale.</p> <p>Zonat e moleve buzë liqenit si dhe shërbimet përkatëse do të trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.</p>	



MALI I ZI

PODGORICË

KOPLIK

POJENICË

KUI I VERMORIT

VER

VUKËL-NIKÇ

TAMARË

SELÇA

KOZHINJA

EROJA

BOGË

RAZËM

Vendkalimi kultur
Hani i Hotit-Bozha

SVRITHI

VUC-KURTAJ

BZHITA

ZAGORË

DEDAJ

LOHJA

ZAPARRANA

TOJSHTI

REÇ

UK-PAPAJ

KOPLIK

MOR-LARDGU

XHANI

BRUÇAJ

UKBIBAJ

BARCOLLA

Liqeni i Shkodres

SHKODËR


2.75

7.5

15

22.5

30



PLAVË

KOSOVË

DEÇAN

JUNIK

LIQENET
VERMOSH

LEPUSHË

GUÇI

SYLBICË-
DOBËRDOL

ÇEREM

VALBONË

RROGAM

THETH

TROPOJË
E VJETËR

CURRAJ
I EPËRM

BAJRAM
CURRI

LEKBIBAJ

DUSHAJ

NËNMAVRIQ

KIRI

PARKU I
BLINIT,
LUMI SHALËS

KOMAN

Legjendë

- Kufi Administrativ
- Kufi planifikimi PKST Alpe
- Kufi të qeverisjes vendore
- Fshat
- Infrastruktura rrugore
- Shtigje për këmbësorë

Aktivitetet dhe shërbime në zonë

- Kajak
- Monumete kulturore
- Monumete natyrore
- Muze
- Ngjitje shkëmbore
- Objekte kulturi
- Pika vrotjimi
- Qendra shëndetësore
- Shpella
- Stane

Lokalitetet / niveli i hierarkisë

- Kategorija e I, "Portat e Alpeve"
- Kategorija e II
- Kategorija e III
- Kategorija e IV, "Lokalitetet natyrore"

Pasaportat me llojet e turizmit të propozuar

- Turizëm primar
- Emri i lokalitetit
- Turizëm mbështetës

Llojet e turizmit të propozuar

- Turizmi i qëndrueshem / ekologjik / ekoturizëm
- Turizmi malor
- Turizmi i parqeve të mbrojtura
- Turizmi ujor
- Turizmi i historisë dhe trashëgimisë kulturore
- Turizmi industrial
- Turizmi fetar
- Turizmi shkencor
- Turizmi krijues
- Agroturizmi / Turizmi i fermave bujqësore
- Turizmi gastronomik dhe produkteve lokale
- Turizmi rekreativ dhe argëtues
- Turizmi çiklistik
- Turizmi i speleologjisë
- Turizmi i parashutizmit
- Turizmi i ecjeve në natyrë dhe alpinizmit
- Turizmi i eventimenteve
- Turizmi shëndetësor
- Turizmi i biznesit / i konferencave
- Turizmi social dhe i solidaritetit

03

AKSESI NË ZONË & ITINERARET TURISTIK

- 3.1 ITINERARET KRYESORE TURISTIKE
- 3.2 INFRASTRUKTURA E MOBILITETIT
- 3.3 TRANSPORTI DHE PARKIMI
- 3.4 SHTIGJET PËR KËMBËSORË DHE BIÇIKLETA

3.1

ITINERARET KRYESORE TURISTIKE

Krahas lokaliteteve, në zhvillimin e turizmit janë të rëndësishme edhe përcaktimet e akseve kryesore të lëvizjes. Janë përcaktuar 5 itinerare kryesore të qarkullimit që i shtohen të gjitha rrugëve të brendshme dhe shtigjeve natyrore të lira apo të menaxhuara.

Itinerari turistik është një trajektore e strukturuar, tematike ose e përgjithshme, në të cilën ofrohen produkte të ndryshme të industrisë së turizmit, duke përfshirë informacionin turistik, transportin, qëndrimin dhe akomodimin.

Në itineraret kryesore ndërthuret:

- a. lëvizja e automjeteve me lëvizjen e këmbësorëve;
- b. akseset për të gjithë përdoruesit, akseset për alpinizëm, ecja në natyrë dhe segmentet e lundrimit;
- c. ndërthuren itineraret lokale me ato ndërku-fitare që janë dhe pjesë e “Via Dinarika”.

Itineraret kryesore unazore janë:

a. Unaza e jashtme:

Shkodër - (Postribë) - Koman - Grykëderdhja e Shalës - Dushaj - Bajram Curri - Tropojë e Vjetër - Sulbicë - Çerem - (Mali i Zi) - Vermosh - Tamarë - Koplík - Shkodër

b. Unaza e brendshme:

Shkodër - Koplík - Bogë - Theth - Rragam - Valbonë - Bajram Curri - Dushaj - Lekbibaj - Vuksanaj - Kir - Shkodër

c. Unaza perëndimore:


Shkodër - Koplík - Bogë - Theth - Nënnavriq - Kir - Shkodër

d. Unaza lindore:

Bajram Curri - Dushaj - Lekbibaj - Curraj i Epërm - Dragobi - Çerem - Sulbicë - Tropojë e Vjetër - Bajram Curri

- e. Itinerari vozitës:** Vau i Dejës - Koman - Grykëderdhja e Shalës - Dushaj

Këto itinerare janë analizuar duke orientuar në to llojin e lëvizjes, ndërhyrjet e nevojshme dhe re-komandimet për transportin publik, терминаlet, parkimet etj.



MALI I ZI

TAME

LEPUS

VUKËL

TAMARË

BOGË

RAZËM


NË

KIRI

KOPLIK

REÇ

Liqeni i Shkodres



KOSOVË

SULBICË

ÇEREM

VALBONË

RROGAM

TROPOJË
E VJETËR

BAJRAM
CURRI

CURRAJ
EPËRM

LEKBIBAJ

DUSHAJ

THETH

NMAVRIQ

BLINI I GURIT
TË LEKËS

KOMAN

Legjendë

- Kufi Administrativ
- Kufi planifikimi PKST Alpe
- Kufi te Qeverisjes Vendore

Zonimi i parqeve

- Zonimi Parkut kombetar te Alpeve:
 - Zone Qendrore
 - Zone e Menaxhimit Efektiv
 - Zone e Perdorimit Tradicional
 - Zone e Zhvillimit te Qendrueshem

- Zonimi Parku Bashkiaq Nikaj - Merfuz:
 - Zone Qendrore, Mbrojtje Strikte
 - Zone e Perdorimit Tradicional
 - Zone e Zhvillimit te Qendrueshem

- Zonimi Parku Bashkiaq Shkret:
 - Zone Qendrore
 - Zone e Perdorimit Tradicional
 - Zone e Sherbimit te Vizitoreve
 - Zone e Zhvillimit te Qendrueshem

**Lokalitetet
Niveli i hierarkise**

- Kategoria e I
- Kategoria e II
- Kategoria e III
- Kategoria e IV
- Fshat
- Shlitje
- Infrastruktura rrugore

Itinerare turistike

- Unaza lindore
- Unaza perendimore
- Unaza e brendshme
- Unaza e jashtme

3.2

INFRASTRUKTURA E MOBILITETIT

Qëllimi i PKST-së për Alpet Shqiptare është mbështetja e zhvillimit të turizmit me anë të transportit të qëndrueshëm, duke përcaktuar dhe orientuar zgjidhjet alternative në aspektin e mobilitetit dhe integrimin e mënyrave të transportit në drejtim të zonës së alpeve dhe brenda saj. Në përcaktimin e skemës së lëvizjes janë marrë në konsideratë rekomandimet e PPK-së, Strategjisë Kombëtare të Transportit, si dhe sugjerimet e PPV-ve të bashkive që administrojnë këtë territor. Disa propozime nuk janë marrë në konsideratë, pasi përveç faktit që nuk janë në përputhje me orientimet e PPK-së, bien ndesh dhe me parimet e ruajtjes mjedisore dhe ndikojnë negativisht në zhvillimin turistik të territorit.

Një shembull është projekti i korridorit "Adriatik - Alpe "A-A", Shëngjin - Lugina e Drinit - Tropojë - Morinë" që propozon një aks përgjatë luginës së Drinit. Kështu do lidhej pjesa perëndimore me atë lindore të zonës së alpeve duke e kthyer në zonë tranzite për të gjitha llojet e mjeteve (për pasagjerë dhe mallra) që kalojnë nga Kosova në Shkodër dhe në portin e Shëngjinit.

PKST-Alpe rekomandon një lidhje me impakt të ulët të zonës lindore me atë perëndimore të alpeve duke lidhur fshatrat dhe duke përdorur gjurmët e rrugëve të ekonomive pyjore.

3.2.1 Infrastruktura e nevojshme

Bazuar në rrjetin rrugor ekzistues dhe duke analizuar tendencat e zhvillimit, është hartuar rrjeti rrugor kryesor i zonës në studim, si dhe është bërë klasifikimi i tij sipas kategorisë përkatëse. Kjo përfshin rikonstruktimin e rrugëve sipas klasifikimit të rrjetit rrugor, në funksion të zhvillimeve të pritshme të infrastrukturës jo vetëm në rang lokal por edhe kombëtar.

Kategoria e rrugëve ekzistuese sipas Kodit Rrugor	Gjatësia (km)	%
Rrugë të asfaltuara	103	19.72
Rrugë të pasfaltuara	419.4	80.28
Total	522.4	100

Tabela 13. Gjendja aktuale e rrjetit rrugor

Duke pasur parasysh se aktualisht rreth 80 % e rrugëve të zonës në studim janë të paasfaltuara, rikonstruktimi i tyre është i domosdoshëm në mënyrë që të kemi një zhvillim ekonomik dhe turistik të zonës. Më poshtë është paraqitur zhvillimi i rrjetit rrugor të zonës në studim, sipas klasifikimit bazuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë.


Duke u bazuar në itineraret kryesore, segmentet që kanë nevojë për përmirësim janë:

a) Unaza e jashtme: Shkodër - (Postribë) - Koman - Grykëderdhja e Shalës - Dushaj - Bajram Curri - Tropojë e Vjetër - Sulbicë - Çerem - Mali i Zi - Vermosh - Tamarë - Koplik - Shkodër

- Segmenti rrugor Vau Dejës - Koman është rrugë interurbane dytësore në gjendje të mjerueshme kryesisht të shtresës së asfaltit, i cili duhet të rikonstruktohet në mënyrë që të zvogëlojë kohën e udhëtimit dhe të rrisë sigurinë rrugore për në limanin e Komanit. Gjithashtu në këtë segment, si pjesë e itinerarit vozitës do të vendoset një linjë e re tragei si alternativë tjetër transporti me vlera turistike.
- Segmenti ujor Koman - Grykëderdhja e Shalës - Dushaj (Fierzë) është pjesë e itinerarit vozitës në të cilin duhet të rikonstruktohen limanet në Koman dhe Dushaj, si dhe të ndërtohen limanet ndërmjetëse përgjatë tij.
- Segmenti rrugor Tropojë e Vjetër - Sulbicë - Dobërdol - Çerem është rrugë e paasfaltuar, e cila duhet të mbetet në gjendje natyrore.
- Segmenti rrugor Çerem deri në kufirin me Malin e Zi (Vranicë) është rrugë në gjendje të mjerueshme, e cila duhet të rikonstruktohet.

b) Unaza e brendshme: Shkodër (Koplik) - Bogë - Theth - Rragam - Valbonë - Bajram Curri - Dushaj - Lekbibaj - Vuksanaj - Kir - Postribë - Shkodër

- Segmenti rrugor Koplik - Bogë është rrugë lokale, me dy korsi dhe e ngushtë, e cila duhet të zgjerohet deri në Dedaj dhe të klasifikohet si rrugë interurbane dytësore.



15. Harta e gjëndjes aktuale të rrjetit rrugor

- Segmenti Bogë (Qafë Thore) - Theth është i paasfaltuar dhe paraqet një rrezik të lartë për sa i përket sigurisë rrugore. Ky segment kërkon ndërhyrje të menjëhershme, duke e asfaltuar dhe pajisur me sinjalistikën e posaçme me qëllim zvogëlimin e kohës së udhëtimit dhe rritjen e sigurisë rrugore.
- Segmenti Theth - Valbonë lidhet me anën e shtigjeve për këmbësorë, të cilat kërkojnë ndërhyrje të lehta dhe pajisjen me sinjalistikën e posaçme dhe hartat përkatëse.
- Segmenti rrugor Lekbibaj - Vuksanaj - Kir është rrugë e paasfaltuar, ku segmenti Lekbibaj - Salcë dhe Vuksanaj - Lotaj duhet të rikonstruktohet. Ndërkohë PKS propozon ndërtimin e një rruge të re ndërmjet Lekbibajt dhe Lotajt, duke ndjekur gjurmët e ekonomive pyjore. Kjo rrugë do të lidhë pjesën perëndimore (Parkun Kombëtar të Thethit) me atë lindore (Parkun Kombëtar të Luginës së Valbonës) të Alpeve Shqiptare, duke ulur kështu kohën e udhëtimit dhe duke shtuar një alternativë të re të aksesimit të secilës pjesë me rrugë automobilistike.
- Segmenti rrugor Kiri (Lotaj) - Postrribë është rrugë lokale në gjendje të mjerueshme, e cila duhet të rikonstruktohet deri tek Ura e Mesit.

c) Unaza perëndimore: Shkodër - Koplik - Bogë - Theth - Ndërlytaj - Kir - Shkodër


- Segmenti rrugor Theth - Ndërlytaj - Kir (Lotaj) është rrugë në gjendje të mjeruar, e cila duhet të rikonstruhet dhe të lidhet me pjesën tjetër të unazës së brendshme (Kir (Lotaj) - Postribë), duke bërë të mundur një alternativë të dytë për hyrjen në Parkun Kombëtar të Thethit.


d) Unaza lindore: Bajram Curri - Dushaj - Lekbibaj - Curraj i Epërm - Dragobi - Çerem - Sulbicë - Dobërdol - Tropojë e Vjetër - Bajram Curri

- Segmenti Lekbibaj - Curraj i Epërm - Dragobi lidhet me anën e shtigjeve për këmbësorë, të cilat kërkojnë ndërhyrje të lehta dhe duhet të pajisjen me sinjalistikën e posaçme dhe panelet përkatëse.
- Segmenti rrugor Dragobi - Çerem është rrugë e paasfaltuar e cila duhet të rikonstruhet dhe të lidhet me unazën e jashtme në Çerem.

e) Itinerari vozitës: Vau i Dejës - Koman - Grykëderdhja e Shalës - Dushaj (Fierzë) - Kukës

- Në segmentet ujore Vau i Dejës - Koman dhe Dushaj - Kukës, PKS në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar propozon vendosjen e linjës së re të tragetit për secilin segment.





LEGJENDE

<ul style="list-style-type: none"> Kufi Administrativ Kufi planifikimi PKST Alpe Kufi te Qeverisjes Vendore 	<ul style="list-style-type: none"> Interurbane kryesore Interurbane dytesore Urbane dytesore Lokale Shteg kembesor
<p>Zonimi i parqeve</p> <ul style="list-style-type: none"> Zonimi PK Alpe Zone Qendrore Zone e Menaxhimit Efektiv Zone e Perdorimit Tradicional Zone e Zhvillimit te Qendrueshem 	<p>Rruget e Propozuara</p> <ul style="list-style-type: none"> Dragobi - Çerem - Vranicë Drisht - Koman Fushë Arrez - Fierzë Iballë - Fierzë Koplik-Dedaj Kukës - Has - Krumë - B.Curri Lekbibaj-Salocë Postribë - Prekal - Nderlysj - Theth Qafë Thora - Theth SH25 Vau Dejës - Koman - L. Koman Salocë - Vuksanaj Tamare - Niko - Vukel Vuksanaj - Lotaj
<p>Zonimi Parku Bashkiak Nikaj - Murtur</p> <ul style="list-style-type: none"> Zone Qendrore, Mbrojtje Strikte Zone e Perdorimit Tradicional Zone e Zhvillimit te Qendrueshem 	
<p>Zonimi Parku Bashkiak Shkrel</p> <ul style="list-style-type: none"> Zone Qendrore Zone e Perdorimit Tradicional Zone e Sherbimit te Vizitoreve Zone e Zhvillimit te Qendrueshem 	

Krahas itinerareve kryesore, PKST-Alpe ka evidentuar edhe akset kryesore hyrëse që kanë nevojë për rehabilitim:

- Aksi rrugor Vau Dejës - Koman, i cili do të zvogëlojë kohën e udhëtimit për në limanin e Komanit;
- Aksi rrugor Kukës - Has - Krumë - Bajram Curri, i cili duhet rehabilituar, zgjeruar dhe duhen përmirësuar rrezet e kthesave me qëllim uljen e kohës së udhëtimit për në pjesën lindore të alpeve, duke e bërë të panevojshëm kalimin e pikës kufitare nëpërmjet itinerarit Kukës - Qafë Morinë - Prizren - Gjakovë - Qafë Morinë - Bajram Curri;
- Aksi rrugor Fushë - Arrëz - Fierzë, i cili shërben për të aksesuar zonën lindore të alpeve nëpërmjet rrugës automobilistike ekzistuese;
- Aksi rrugor Iballë - Fierzë, i cili do të sjellë një alternativë tjetër për turistët që vijnë kryesisht nga pjesa e Shkodrës dhe Malit të Zi për të vizituar parkun e Valbonës;

- Aksi rrugor Tamarë - Vukël - Nikç, i cili do të zvogëlojë kohën e udhëtimit për në pjesën perëndimore të zonës së alpeve;
- Aksi rrugor Drisht - Koman, i cili aktualisht është i paasfaltuar dhe do të zvogëlojë kohën e udhëtimit për në limanin e Komanit.

Duke qenë se paralelisht janë duke u hartuar edhe Planet e Përgjithshme Vendore të bashkive përbërëse, theksojmë se disa nga rrugët e propozuara në PKST-Alpe janë parashikuar edhe në këto plane, si p.sh.:

- Aksi rrugor Prekal - Koman;
- Shkodër - Shalë - Theth - Bogë - Koplík;
- Vau i Dejës - Koman;
- Paç - Qafë Prush.

Nr.	Emërtimi i rrugës	Tipi i rrugës	Kategoria	(km)	Propozimi
1	SH25 Vau Dejës - Koman - Liqeni i Komanit	Rrugë interurbane dytësore	C	32,5	Rikonstruksion
2	Kukës - Has - Krumë - Bajram Curri	Rrugë interurbane dytësore	C	88,8	Rikonstruksion
3	Fushë Arrëz - Fierzë	Rrugë interurbane dytësore	C	68	Rikonstruksion
4	Iballë - Fierzë	Rrugë interurbane dytësore	C	18	Rikonstruksion
5	Tamarë - Vukël - Nikç	Rrugë lokale	F	16,7	Rikonstruksion
6	Drisht - Koman	Rrugë lokale	F	30	Rikonstruksion
7	Dragobi - Çerem - Vranicë	Rrugë lokale	F	16	Rikonstruksion
8	Koplík - Dedaj	Rrugë interurbane dytësore	C	12,7	Rikonstruksion
9	Lekbibaj - Salcë	Rrugë lokale	F	12	Rikonstruksion
10	Salcë - Vuksanaj	Rrugë lokale	F	9,3	Rrugë e re
11	Vuksanaj - Lotaj	Rrugë lokale	F	1,7	Rikonstruksion
12	Postribë - Prekal - Ndërlytaj - Theth	Rrugë lokale	F	71,5	Rikonstruksion
13	Qafë Thore - Theth	Rrugë lokale	F	14,7	Rrugë e re
Gjithsej				367,9	Rikonstruksion
				9,3	Rrugë e re

Tabela 14. Rrugët që do të rikonstruktohen dhe ndërtohen

3.2.2 Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore

Infrastruktura rrugore përbën një ndër asetet më të rëndësishme publike të një vendi, dhe së bashku me transportin jep një kontribut thelbësor në zhvillimin ekonomik. Faktet kanë treguar se vendet me infrastrukturë moderne, efikase dhe të sigurt, janë më të zhvilluar ekonomikisht, e për pasojë banorët e tyre kanë një cilësi jetese më të mirë. Për të përballuar kërkesat gjithnjë e në rritje të fluksit të turistëve, infrastruktura rrugore duhet të zgjerohet dhe zhvillohet. Krahas zgjerimit dhe zhvillimit, rëndësi të veçantë luan edhe mirëmbajtja në mënyrën e duhur. Degradimi i infrastrukturës rrugore fillon menjëherë pas ndërtimit të saj, sidomos në zonën e alpeve ku agjentët atmosferikë dhe mjedisorë për shkak të klimës malore përshpejtojnë shkatërrimin e shtresave të asfaltit.

Mirëmbajtja realizohet kryesisht në dy kategori: mirëmbajtje parandaluese dhe mirëmbajtje kapitale ose rehabilitim. Në mirëmbajtjen parandaluese bëjnë pjesë mirëmbajtja rutinë, ajo dimërore dhe e emergjencës. Mirëmbajtja rutinë nënkupton punimet e vogla periodike që kanë për qëllim ruajtjen e integritetit strukturor të rrugës, sigurinë dhe parandalimin e shkatërrimit të tyre. Nëse mirëmbajtja parandaluese nuk bëhet, ruajtja e infrastrukturës në kushte të mira dhe të sigurt bëhet më vonë edhe më e kushtueshme. Mirëmbajtja kapitale ose rehabilitimi nënkupton proceset e riparimit të segmenteve ekzistuese të shtresave të asfaltit, zëvendësimet e elementeve të rrugës, signalistikës, sistemet e shpatullave të rrugës, kanalizimeve, etj.

Klima malore dhe reshjet e borës në zonën e alpeve bëjnë që gjatë stinës së dimrit sezoni turistik dhe aksesit të jenë të kufizuara. Për këtë arsye, është e rëndësishme të theksohet se të gjitha rrugët që lidhin qendrat turistike dhe të banuara duhet të mirëmbahen gjatë të gjitha stinëve, si një nga nevojat kryesore që kanë banorët, hotelet dhe bujtinat e kësaj zone. Sistemimi i rrugëve sipas standardeve dhe mbajtja e tyre në nivel optimal operim, jo vetëm do të rrisë aksesueshmërinë dhe sigurinë rrugore, por do të nxisë edhe zhvillim ekonomik duke tërhequr më shumë turistë.

3.3

TRANSPORTI & PARKIMI

3.3.1 Linjat e transportit turistik

Aksesi me transport publik në zonë bëhet i mundur kryesisht me linjat ndërqytetore të qyteteve kryesore të rajonit të alpeve. Transporti në këto linja kryhet me autobusë 17-20 vende dhe me taksi 8+1, me frekuencë të pranueshme për banorët e qytetit të Bajram Currit dhe të Shkodrës. Ndërsa në qytetin e Koplikut transporti publik ka mangësi për shkak të kushteve të këqija infrastrukturore dhe kërkesës së ulët të udhëtarëve.

Nga secili qytet shpërndahen edhe linjat rreth-qytetëse, të cilat depërtojnë më në thellësi të zonës së alpeve, por për shkak të numrit të vogël të udhëtarëve ato operojnë me frekuencë më të ulët dhe me taksi 8+1. Një alternativë tjetër transporti është ai uJOR, me traget nga Komani në Fierzë. Aktualisht, për transportin e turistëve në zonën e alpeve operojnë disa agjenci turistike, të cilat nëpërmjet paketave të ndryshme turistike përfshijnë edhe transportin e turistëve.

Sistemi i transportit publik duhet të ristrukturohet në mënyrë që të gjitha zonat të mbulohen me shërbimin e transportit publik dhe bashkitë të lidhin linjat me njëra-tjetrën. Gjithashtu, të gjitha linjat e transportit publik duhet të integrohen me njëra-tjetrën në терминалет multimodale dhe të jenë të koordinuara me qëllim shmangien e pritjeve të gjata. Duke pasur parasysh tendencën e fluksit të turistëve, kapaciteti i këtij sistemi dhe frekuenca e shërbimit mund të jenë të luhatshme në varësi të sezonit turistik. Flota e mjeteve të transportit publik duhet të rinovohet dhe të ketë kushte më komode e sipas standardeve evropiane në lidhje me çlirimin e gazrave. Përveç transportit publik i cili do të shërbejë me orare dhe frekuenca të përcaktuara, duhet të merret në konsideratë edhe transporti i turistëve i realizuar nga operatorët turistikë, të cilët duhet të mbështeten nga bashkitë përkatëse.

Përveç linjave të transportit publik, duhet të parashikohet edhe transporti i dedikuar, i cili do të ndjekë itineraret kryesore dhe do të administrohet nga Bordi i Menaxhimit me anën e një rregulloreje të posaçme. PKST-Alpe ka propozuar disa linja të transportit turistik me automjete dhe me traget, të cilat janë:

A. Transport publik turistik me autobusë

- Linja Bajram Curri - Tropojë
- Linja Bajram Curri - Dushaj - Lekbibaj - Curraj i Epërm
- Linja Bajram Curri - Valbonë - Çerem
- Linja Koplik - Tamarë - Vukël - Nikç
- Linja Koplik - Tamarë - Lëpushë - Vermosh - Çerem - Bajram Curri ³¹
- Linja Koplik - Bogë - Theth - Kir - Shkodër
- Linja Koplik - Razëm
- Linja Shkodër - Kir - Vuksanaj - Lekbibaj - Bajram Curri

B. Transport publik turistik liqenor

- Linja Vau i Dejës - Koman
- Linja Koman - Fierzë (Dushaj)
- Linja Fierzë (Poravë) - Kukës

Për të siguruar vazhdimësinë e itinerarit liqenor ndërthuret transporti me traget me atë me autobusë në segmentet:

- Koman: Koman i Poshtëm - Koman i Sipërm
- Fierzë: Dushaj - Poravë

Në mënyrë që të rritet aksesueshmëria e zonës së alpeve në përputhje me Planin e Përgjithshëm Kombëtar, PKST-Alpe mbështet itinerarin vozitës Pulaj - Koman - Fierzë - Kukës, në të cilën mund të vendoset një linjë re trageti nga Vau i Dejës për në Koman dhe nga Kukësi për në Fierzë. Nga ana tjetër, itinerari Pulaj - Vau i Dejës mund të shërbejë si itinerar vozitës me varka të vogla, kanoe, kajak, etj. Ky itinerar shërben jo vetëm si një alternativë shtesë për të aksesuar këtë zonë por edhe si një itinerar turistik.

³¹ Ka kalim të detyruar në territorin e Malit të Zi për t'u rregulluar me marrëveshje dypalëshe

3.3.2 Terminalet dhe parkimet publike

Dukë marrë parasysh mungesën e theksuar të organizimit të sistemit të transportit publik dhe turistik në të gjithë zonën e Alpeve Shqiptare, PKST-Alpe propozon 2 terminale multimodale, 16 stacione të transportit publik e turistik dhe 9 limane.

Këto terminale do të bëjnë një integrim më të mirë të linjave të transportit publik si linjave ndërqytetore, linjave urbane, linjave të transportit ujor, linjës hekurudhore, linjave të guidave turistike, etj. Terminalet multimodale duhet të pozicionohen në zona lehtësisht të aksesueshme, jashtë qendrave të qyteteve, si dhe duhet të jenë sipas standardeve, të pajisura më vende parkimi për autobusë, taksi dhe automjete private, biletari, dyqane, tualete, dhoma pritjeje, zyrë informacioni, etj. Terminalet e reja, si bazë e krijimit të një transporti intermodal, do të shërbejnë si nje transferimi e udhëtarëve dhe turistëve në destinacione të ndryshme.


Transporti intermodal konsiston në kombinimin efikas të mënyrave të transportit, optimizimit të kohës së udhëtimit dhe zvogëlimit të kostos së udhëtimit, i cili ndihmon në zvogëlimin e çlirimit të gazrave të dëmshme në mjedis.

Në të dyja terminalet multimodale duhet të ketë edhe vende parkimi ku turistët mund të parkojnë automjetet e tyre, e më pas të përdorin transportin publik për të mbërritur në destinacionet e tjera turistike, duke kontribuar kështu në uljen e ndotjes së mjedisit. Gjithashtu, parkimet publike duhet të vendosen edhe në stacionet e transportit publik e turistik, si dhe limanet e parashikuara. Parkimet e stacioneve turistike do të përcaktohen në fazën e projektimit të secilës prej këtyre strukturave. Krahas parkimeve të integruara në strukturat e transportit, është e nevojshme të parashikohen dhe parkime publike për turistet. Këto parkime publike për turistët do të synojnë lehtësimin e aksesit turistik në territorin e Alpeve Shqiptare.

Terminale të transportit publik dhe turistik	
Limane	Limani - Kukës
	Limani - Shëngjergj (për pasagjerë)
	Limani - Fierza e Sipërme (Poravë)
	Limani - Dushaj
	Limani - Lugina e Shalës (për pasagjerë)
	Limani - Koman i Sipërm
	Limani - Koman i Poshtëm
	Limani - Shurdhaj
	Limani - Vau Dejës i Sipërm
Terminale intermodale	Terminali multimodal Bajram Curri
	Terminali multimodal Koplík
Stacione transporti publik dhe turistik	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Valbonë
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Lekbibaj
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Tropojë e vjetër
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Curraj i Epërm
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Dragobi
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Tamarë
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Vukël
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Nikç
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Lëpushë
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Vermosh
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Reç
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Bogë
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Razëm
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Theth
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Kir
	Stacioni i transportit publik dhe turistik - Ndërlisaj

Tabela 15. Terminalet dhe parkimet publike





PEJE

KOSOVË

DEÇAN

JUNIK

PLAVË

VERMOSH

USHË

SULBICË

ÇEREM

VALBONË

RROGAM

THETH

TROPOJË
E VJETËR

CURRAJ I
EPËRM

BAJRAM
CURRI

LEKBIBAJ

DUSHAJ

NËNMAVRIQ

BLINI I GURIT
TË LEKËS

KOMAN

Legjendë

- Kufi Administrativ
- Kufi planifikimi PKST Alpe
- Kufi te Qeverisjes Vendore

Zonimi i parqeve

- Parku Kombëtar i Alpeve Shajptare
- Zone Qendrore
- Zone e Menaxhimit Efektiv
- Zone e Përdorimit Tradicional
- Zone e Zhvillimit te Qendrueshem

- Parku Bashkiak Shkrel
- Zone Qendrore
- Zone e Përdorimit Tradicional
- Zone e Sherbimit te Vizitoreve
- Zone e Zhvillimit te Qendrueshem

- Parku Bashkiak Nikaj-Mërtur
- Zone Qendrore, Mbrojtje Strikte
- Zone e Përdorimit Tradicional
- Zone e Zhvillimit te Qendrueshem

- Fshat
- Shtigje
- Infrastruktura rugore
- Linjat e transportit turistik
- Monument kulture
- Lokalitetet / hierarkia
- Kategoria e I
- Kategoria e II
- Kategoria e III
- Kategoria e IV

- Itinerare turistike
- Unaza lindore
- Unaza perendimore
- Unaza e brendshme
- Unaza e jashtme
- Liman
- Port
- Stacione te mundshme te transportit publik
- Parkim
- Terminale

3.4

SHTIGJET PËR KËMBËSORË & BIÇIKLETA

Zona e Alpeve Shqiptare është një ndër pikat më tërheqëse për eksploruesit, turistët, alpinistët, çiklistët vendas dhe të huaj, të cilët duan të shijojnë peizazhin, të vizitojnë shtëpitë tradicionale veriore shqiptare (kullat), monumentet kulturore, zonat historike, të shijojnë ushqimin bio vendas, të ndjekin festivalet me muzikë dhe valle tradicionale, si dhe të njohin kulturën vendase shqiptare. Këtë zonë e bën akoma më tërheqëse terreni i thyer me shtigje që përshkohen me këmbë, me kafshë, biçikleta malore, etj., të cilat të japin mundësi të shijosh natyrën dhe të mbërrish në zona të virgjëra.

Banorët e zonës thonë se vite më parë, në mungesë të mjeteve motorike dhe infrastrukturës rrugore, këto shtigje shërbenin si rrugë lidhëse ndërmjet fshatrave të ndryshme brenda dhe jashtë kufirit. Këto shtigje kanë shkallë vështirësie të ndryshme, duke filluar nga ato më të lehtat deri tek më të vështirat, të cilat mund të kalohen vetëm nga alpinistët profesionistë. Aktualisht, në këtë zonë ndodhen 699,3 km shtigje për këmbësorë, nga të cilat 44 prej tyre me një gjatësi totale prej 585,6 km, dhe 13 shtigje për biçikleta me një gjatësi prej 172 km.

Vlen të theksohet se rrjeti i shtigjeve në zonën e alpeve ndërthuret me shtigjet e Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna në Kosovë dhe me ato të Parkut Kombëtar Prokletije në Malin e Zi.

Gjithashtu, referuar Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tropojë, në zonën ndërmjet Tropojës dhe Gjakovës ndodhen disa shtigje të vjetra për këmbësorë, të cilat do të rigjallërohen falë projektit “Shtigjet e Lirisë”:

- Parku Memorial Koshare - Gurra e Gatë - Qafa e Sulbicës - Lugina e Sulbicës - Stanet e Dobërdolit;
- Parku Memorial Koshare - Gurra e Gatë - Rrasa e Koshares - Padesh - Koshare;
- Tropojë - Sulbicë - Dobërdol - Valbonë - Çerem;
- Zalli i Rops - Liqeni i Tropojës - Qafa e Dobërdolit - Liqeni Zemër - Zalli i Rops;
- Maja e Markovcës - Çerem;

- Qafa e Borës - Stanet Qelaj (Vuthaj/Mal i Zi) - Qafa e Preslopit - Fshati Valbonë;
- Shtegu përgjatë lumit të Valbonës deri tek ujëvara, Hoxhaj - Maja Shkëlzenit;
- Lekbibaj - Curraj i Poshtëm - Curraj i Epërm;
- Lekbibaj - Rrasa e Currajve - Curraj i Epërm;
- Lekbibaj - Vrana - Qafa e Mrrisë - Curraj i Epërm;
- Lekbibaj - Shëngjergj - Botushë - Qereq - Mulaj - Curraj i Epërm;
- Bujan - Markaj - Cervena - Cukal - Maja e Hekurave;
- Maja Ujëza - Bujan - Markaj - Velesht - Qafa e Kolshit - Qereq - Mulaj - Curraj i Epërm;
- Kushnin - Qafa e Likenit - Kroni i Pojatës Vlahnes - Maja e Pashtrikut;
- Junik - Maja Rrasa e Zogut.


Për zonën e alpeve është i domosdoshëm një projekt i hartëzimit të shtigjeve. Shumë shtigje janë të pasinjalizuara e të paidentifikuara në harta tematike turistike. Shtigjet njihen individualisht vetëm nga udhërrëfyesit turistikë, dhe sinjalistikat përgjatë tyre janë bërë në mënyrë vullnetare nga grupe alpinistësh apo shoqata të ndryshme që operojnë në zonë. Disa shtigje shpeshherë janë të ngushta dhe kanë nevojë për ndërhyrje të lehta pa dëmtuar mjedisin, si dhe për vendosjen e sinjalistikës së nevojshme informuese, pikave të pushimit, linjave telefonike në raste emergjence, etj.

Nr.	Shteg për këmbësorë	Gjatësia (km)	Shkalla e vështirësisë së kalimit
1	Ura Shtrenjtë - Kir - Theth	82	-
2	Ndërlytaj - Syri Kaltër	3,7	-
3	Qafa e Thores - Syri Kaltër	3,4	-
4	Unaza e Thethit	10,1	-
5	Theth - Hardedaj	4,2	-
6	Theth - Maja e Arapit	10,0	-
7	Dragobi - Maja e Dhive	1,6	-
8	Jah Salihi - Bujan	6,7	-
9	Dragobi - Sulbicë	31,1	-
10	Kocanaj - Çerem	21,2	-
11	Markaj - Kuç	25,2	-
12	Dragobi - Stanet e Dobërdolit	9,8	-
13	Dragobi - Maja e Dhive	10,9	-
14	Dragobi - Maja e Dhive	2,3	-
15	Kroi Gjokollit	13,5	E vështirë
16	Abati - Peraj	13,7	Mesatare
17	Brashta - Salca	10,09	-
18	Brashta - Toplana	10,4	-
19	Berishë e Vogël - Ndreaj	2,3	-
20	Peraj - Salca	1,5	-
21	Valbonë - Maja Jezercës	8,7	E vështirë
22	Valbona - Maja e Roshit	6,2	-
23	Valbona - Maja e Thatë	7,8	-
24	Valbonë - Theth	12,65	-
25	Vuksanaj - Lekbibaj	23,2	-
26	Tropojë - Sulbicë	22,7	-
27	Dragobi - Çerem	9,2	-
28	Theth - Ujvara Grunas	2,1	-
29	Valbonë - Lugi Perslopit - Çerem	9,3	-
30	Maja e Kollatës - Lugu i Kollatës - Maja e Kollatës	4,5	-
31	Majat e Ballkanit	46,5	-
32	Via Dinarica	8,2	-
33	Bogë - Maja e Radohimës	11,2	Shumë e vështirë
34	Qafa e Thorës - Radohimë	6,2	Shumë e vështirë
35	Tamarë - Nikç	13,1	-
36	Nkic - Lëpushë	10,5	-
37	Nkic - Shnik	8,0	-
38	Razëm - Fushëzezë - Rapsh	19,1	-
39	Lëpushë - Greben - Vermosh	17,1	-
40	Lëpushë - Bjeshkë Morinë - Lëpushë	18,2	-
41	Vermosh - Velipojë - Vermosh	9,3	-
42	Tamarë - Brojë - Tamarë	7,9	-
43	Rapsh - Bratosh - Vrith - Razëm	16,4	-
44	Reç - Qafë Gradë - Repisht - Reç	13,2	-
TOTAL		585,6	-

Tabela 16. Shtigjet per kembesore

Nr.	Shteg për biçikleta	Gjatësia (km)
1	Tamarë - Nikç - Vukaj - Tamarë	20
2	Tamarë - Brojë - Tamarë	7,9
3	Shoshan - Bradoshnicë	9,2
4	Rrapshë - Bratosh - Vrith - Razëm	16,4
5	Reç - Qafë Gradë - Repisht - Reç	13,2
6	Reç - Qafë Gradë - Liqen - Reç	7,4
7	Razëm - Fushëzezë - Rrapshë	19,1
8	Rrapshë - Tamarë	17
9	Qafë Bordolec - Lëpushë - Budacë - Kanion	7,3
10	Lëpushë - Qafë Kërcum - Gropat e Selcës - Lëpushë	9,9
11	Lëpushë - Greben - Vermosh	17,1
12	Lëpushë - Bjeshkë Morinë - Lëpushë	18,2
13	Vermosh - Velipojë - Vermosh	9,3
TOTAL		172

Tabela 17. Shtigjet per biçikleta



18. Shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta



04

INFRASTRUKTURA & SHËRBIMET PUBLIKE

- 4.1 SHËRBIMI I FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME
- 4.2 SHËRBIMI I GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE URBANE
- 4.3 ENERGJIA DHE TELEKOMUNIKACIONI
- 4.4 QENDRAT SHËNDETËSORE DHE SKUADRAT E
KËRKIM-SHPËTIMIT
- 4.5 ORIENTIME NGA VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

4.1

SHËRBIMI I FURNIZIMIT ME UJË & KANALIZIMET

Krahas trajtimit të infrastrukturës rrugore, janë të domosdoshme edhe disa ndërhyrje të tjera në sektorët e infrastrukturës së shërbimeve publike si pjesë e rëndësishme e aksesit dhe funksionimit të turizmit në zonë.

Zona është e pasur me burime ujore, por në pjesën më të madhe të saj mungon infrastruktura e rrjeteve inxhinierike. Në alpe duhet ndërhyrë për ndërtimin e rrjeteve të mbulimit të lokaliteteve me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe njëkohësisht për të zëvendësuar rrjetet e ndërtuara nga vetë banorët të cilët nuk përputhen me kushtet teknike dhe çënojnë sigurinë e ujit të pijshëm.

Lokalitetet e nivelit I duke qenë zona urbane ose në afërsi të tyre kanë një shërbim më të mirë dhe të kontrolluar të furnizimit me ujë.

Lokalitetet e nivelit II kanë skema të pjesshme të furnizimit me ujë dhe është e nevojshme ndërhyrja për kompletimin e rrjeteve të shpërndarjes, zëvendësimin e linjave individuale të ndërtuara nga banorët si dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me ujë të pijshëm.

Lokalitetet e nivelit III janë ato zona që kanë një turizëm më të konsoliduar. Disa prej tyre nuk mbulohehen me shërbimin e furnizimit me ujë, dhe për këtë arsye është i nevojshëm ndërtimi i sistemeve të reja. Në lokalitetet kryesore që njihen për atraksionin turistik janë ndërtuar skema të pjesshme ujësjellësish; gjithsesi është i nevojshëm ndërtimi i rrjeteve inxhinierike të shpërndarjes për përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me ujë të pijshëm.

Lokalitetet e nivelit IV janë zona me dendësi shumë të ulët të popullsisë ku shërbimi sigurohet plotësisht në mënyra individuale duke shfrytëzuar burimet e zonës. Rekomandohet që në këto zona të ruhet peizazhi dhe karakteri natyror pa ndërhyrë në ndërtimin e rrjeteve inxhinierike. Cilësia e burimeve ujore duhet të mbahet nën monitorim nëpërmjet analizave periodike dhe mbrojtjes nga ndotjet e mundshme.

Llogaritja e kërkesës shtesë për ujë do të bazohet në numrin maksimal të akomodimeve që i përkastrukturave pritëse në zonën ku do të ndërtohen sistemet e ujësjellësve.

Projektet e ujësjellësit duhet të marrin parasysh dimensionimin e veprave bazuar mbi konsumin maksimal të ujit të pijshëm në zonë që përkon me pikun e sezonin turistik.

Para hartimit të projekteve të ujësjellësve, duhet të përditësohen dhe të kryhen studime të sakta hidrologjike që mundësojnë gjetjen e burimeve të sigurta për plotësimin e nevojave për ujë. Gjithashtu, duhet përcaktuar dhe shënuar zona përreth burimit të ujit të pijshëm sipas rregullores, dhe duhet monitoruar periodikisht cilësia e tij.

Në rastin kur komuniteti furnizohet nga një burim i vetëm uji, duhet bërë dublimi i linjës.

Gjatë trasimit të linjave të ujësjellësit, duhet shmangur kalimi në afërsi të zonave që kanë potencial ndotjeje.

Tubacionet duhen të hidroizolohen përpara se të vendosen në kanal dhe të termoizolohen nëse ekspozohen mbi tokë.

Duhet synuar aplikimi i skemave me gravitet duke shfrytëzuar topografinë e zonës dhe vendndodhjen e burimeve të ujit.

Në periudhën e ulët turistike, kur konsumi i ujit pakësohet ndjeshëm nga rënia e numrit të turistëve, mund të shfaqen problematikat e ndotjes së ujit në rrjet. Për këtë arsye, përpara nisjes së pikut turistik duhen pastruar dhe kontrolluar të gjitha strukturat përbërëse të veprës dhe duhen pajisur me ambiente klorinimi sistemet e furnizimit me ujë.

Pas ndërtimit të rrjeteve inxhinierike, duhen çmontuar dhe eliminuar sistemet individuale të përdorura nga banorët e zonës për të siguruar ujin e pijshëm pa zbatuar kushtet teknike dhe rregulloret përkatëse.

Duhet të nisin të zbatohen programe informuese mbi përdorimin efikas dhe kursimin e ujit në bazë konsumatori familjar, duke dhënë shtysë për përdorimin e teknologjive bashkëkohore siç janë kufizuesit e fluksit, elektro-shtëpiaket me konsum të ulët uji dhe deri tek mënyrat për mbledhjen dhe shfrytëzimin e ujërave të reshjeve për nevojat e përditshme.

Ndërhyrja për ndërtimin e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe impianteve të trajtimit është e nevojshme në të gjithë zonën.

Lokalitetet e nivelit I kanë nevojë për rehabilitimin e rrjeteve ekzistuese dhe ndërtimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe impianteve të trajtimit të tyre.

Lokalitetet e nivelit II kanë nevojë për ndërhyrje të plotë në ndërtimin e sistemit të kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit të ujërave të zeza.

Lokalitetet e nivelit III kanë nevojë për ndërhyrje të plotë në ndërtimin e sistemit të kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit të ujërave të zeza apo impianteve me fitodepurim.

Lokalitetet e nivelit IV janë zona me dendësi shumë të ulët të popullsisë dhe natyrë të paprekur. Rekomandohet që në këto zona të aplikohen vetëm skemat e trajtimit të ujërave të ndotura me sistemet e fitodepurimit aty ku mund të ketë përqendrim stanesh apo kampingesh.


Rrjetet e kanalizimeve duhen projektuar si rrjete të ndara për të gjithë zonën. Ujërat e pakontaminuara siç janë reshjet atmosferike, ujërat nga shkërrja e borës, ujërat e drenazheve etj., duhen mbledhur dhe kanalizuar veçmas ujërave të zeza. Kolektorët duhet të vendosen në krah të infrastrukturës rrugore, kurse vendosja e impianteve të trajtimit duhet të bëhet në ekstremin fundor të luginës, aq sa e lejojnë përlllogaritjet hidraulike dhe kushtet e terrenit për t'i shërbyer sa më shumë komuniteteve.

Vendi për ndërtimin e impiantit duhet të zgjidhet me kujdes, duke marrë parasysh shmangien e impaktit viziv, distancën nga qendrat e banuara dhe njëkohësisht afërsinë me një sistem kanalesh vaditës apo kullues ku mund të kryhet shkarkimi i ujërave të trajtuara.

Në rastin e strukturave akomoduese me përmasa të konsiderueshme (resorte, restorante) që kanë prurje të lartë të ujërave të ndotura, duhet të praktikohet ndarja e shkarkimeve që kryhen nga

ambientet e gatimit dhe ndarja e shkarkimeve të tualeteve.

Shkarkimet që kryhen nga ambientet e gatimit kanë përmbajtje të lartë vajrash dhe yndyrnash. Që në këtë fazë kryhet trajtimi fiziko-mekanik dhe ndarja e substancave më të lehta se uji që qëndrojnë pezull në sipërfaqe si vajrat dhe yndyrnat. Shkarkimet e tualeteve bëhen në kontenerë septikë të tipit Imhoff (me një ose më shumë dhoma sipas prurjeve të ujërave të ndotura), të dimensionuar sipas kapacitetit mbajtës të strukturës akomoduese.



Duke nxitur zbatimin e këtyre skemave të para-trajtimit të ujërave të ndotura, arrijmë zvogëlimin e dimensioneve të impiantit, uljen e gradës së trajtimit, uljen e kostove të ndërtimit, shfrytëzimit e mirëmbajtjes, si dhe minimizimin e impaktit në mjedis, çka është dhe elementi më i ndjeshëm i këtij plani.

Në fazën e projektimit duhet parë mundësia për të bërë një përfshirje kolektive të të gjitha strukturave sipas kushteve topografike dhe mënyrës së shpërndarjes që ato kanë në zonë.

Në rastin e komuniteteve shumë të vogla, strukturave turistike, kampingjeve dhe staneve që janë të distancuara dhe në zona të thella malore, në pamundësi për t'i ofruar shërbimin e kanalizimeve dhe impianteve të trajtimit, mund të aplikojmë skemat e impianteve me fitodepurim.

Kjo teknikë ka vite që aplikohet në alpet evropiane dhe në shtetet nordike, duke rezultuar e suksesshme dhe me kosto shumë të ulët ndërtimi dhe mirëmbajtjeje.


Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet në mënyrë natyrale nëpërmjet bimëve, duke krijuar një habitat bakterogjen që luan të njëjtin rol si biofiltrat e një impianti trajtimi.

Klima malore dhe fluksi shumë i vogël e i luhatsëm i prurjeve të ujërave të ndotura gjatë vitit, përbëjnë problem në shfrytëzimin e një impianti trajtimi me llum aktiv dhe biofiltra. Gjithashtu ngricat krijojnë probleme në tubacione dhe sistemet mekanike, ndërsa ulja e prurjeve të ujërave të ndotura për një kohë të gjatë bën të pamundur mbijetesën e mikroorganizmave në biofiltër. Aplikimi i këtyre sistemeve në rajone të ngjashme me alpet tona mbi 800 m.n.d, ka treguar që këto fenomene ndikojnë më pak në impiantet me fitodepurim për faktin se kanë aftësi të përshtatën më mirë me ndryshimet klimatike dhe ekosistemin.

Bimët që përdoren në këtë proces përzgjidhen në zonën ku do të ndërtohet impianti, dhe janë kryesisht specie që rriten në vende të lagështa, përreth vathëve të bagëtive, në afërsi të burimeve të ujit etj. Disa nga këto bimë që gjenden edhe në Alpet Shqiptare janë: typha angustifolia, caltha palustris, deschampsia cespitosa, epilobium angustifolia, germanium sylvaticum, veratrum album, etj. Sistemi funksionon me gravitet, duke i dërguar ujërat e ndotura në vaskat e impiantit me sipërfaqe rreth 1-1,2 m² për frymë.

Para dërgimit në vaska, uji ndotur duhet trajtuar paraprakisht me proces fiziko-mekanik për llumrat, vajrat dhe yndyrat siç u shpjegua më lart. Trajtimi efikas i ujit nga parametrat ndotëse nëpërmjet impiantit me fitodepurim, varion për BOD₅ 80-90%, TSS 90-95%, TN 30-50% dhe NH₄ 70-90%. Përveç trajtimit efikas të ujit, tipologjia e këtij impianti nuk ka impakt në mjedis pasi natyralizohet dhe njëkohësisht mundëson ripërdorimin e ujërave të trajtuar në sistemin e vaditjes.

Jetëgjatësia e këtyre impianteve varion nga 10-12 vjet, dhe më pas bëhet ndërrimi i shtresave mbushëse dhe zëvendësimi i bimëve. Impiantet me fitodepurim janë efikase për komunitete me popullsi që variojnë nga 50-2000 banorë.



4.2

SHËRBIMI I GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE URBANE

Aktualisht mungon një plan i menaxhimit të mbetjeve në zonë, gjë që sjell përkeqësimin e situatës dhe kthimin në vendburime ndotjeje të hapësirave ku grumbullohen mbetjet.

Kjo problematikë paraqitet më serioze në luginën e Valbonës dhe të Thethit, dhe po bëhet e dukshme edhe në zonën e Kelmendit.

Shkaqet e problematikës së mbetjeve lindin si pasojë e:

- mungesës së infrastrukturës për grumbullimin dhe përpunimin e mbetjeve;
- rritjes së numrit të vizitorëve në zonë;
- mungesës së ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me mbetjet dhe rreziqet që ato shkaktojnë në mjedis e në shëndetin e banorëve.

Kjo situatë ka krijuar një çështje vërtet serioze për zonat në fjalë ku mbeturinat grumbullohen kudo (në rrjedhjet e ujit, livadhet, pyjet, zonat e banuara, etj.). Shpeshherë edhe grupet e turistëve që vizitojnë rajonin e alpeve zgjedhin t'i hedhin mbeturinat në mjedis si në lumenj, përrenj, lugina etj., ashtu siç veprojnë edhe pjesa me e madhe e banorëve që jetojnë në zonë.

Asnjë nga zonat kryesore turistike si lugina e Valbonës, Thethi dhe Kelmendi, nuk ka landfill-e për trajtimin e mbetjeve urbane. Në shumicën e rasteve mungojnë koshat e mbeturinave, dhe shërbimi i grumbullimit të mbetjeve nga bashkitë pothuajse nuk ekziston. Në Valbonë ky shërbim realizohet privatisht nga grupe individuale. Mbjetet plastike (shishet, ambalazhet etj.) dhe mbetjet tekstile vërehen gjithmonë në shtretërit e lumenjve.

Zonat e depozitimit të mbetjeve në zonën e alpeve ndodhen në Bajram Curri dhe Lekbibaj. Por shpeshherë, krahas këtyre zonave përdoren edhe hapësira të pacaktuara si zonat në afërsi të shtretërve të lumenjve.

Një çështje tjetër që kërcënon mjedisin e rajonit të alpeve janë grumbujt e mbetjeve organike siç janë mbetjet ushqimore të gjeneruara nga familjet, mbeturinat e tregjeve të fruta-perimeve, të hoteleve, restoranteve, mbetjet që gjenerohen nga stallat e mbarështimit të kafshëve, etj.

Duke parë situatën e mbetjeve në këtë zonë, është me vend të propozohet një sistem i menaxhimit të integruar të mbetjeve në nivel rajoni, në mënyrë që të riciklohet dhe kompostohet një sasi e konsiderueshme e mbetjeve e cila të asgjësohet më pas në landfill-e të krijuara sipas standardeve evropiane.

Duhet që sistemi i grumbullimit të mbetjeve të bëhet me tre kosha, duke grumbulluar veçmas mbetjet e riciklueshme të thata, të riciklueshme të njoma dhe mbetjet e tjera. Ky sistem duhet të përmirësohet në mënyrë që të reflektojë nevojat aktuale të zonës së studimit. Kontenierët duhet të etiketohen me llojin e mbetjeve që përmbajnë, të jenë rezistentë ndaj lagështirës, plasaritjeve, thyerjeve, etj. Vendorsja e koshave duhet të bëhet në atë mënyrë që të mbulojë pjesën më të madhe të sipërfaqes, sidomos në zonat ku popullsia është më e dendur si nëpër parqet natyrore, sheshet e qyteteve, etj.

Për sa i përket mbetjeve organike, ato duhet të trajtohen nga çdo familje, stallë, dyqan, restorant, etj. Kompostimi duhet kryer në bazë njësishe administrative që paraqiten më të fokusuara tek prodhimi bujqësor dhe blegtoral si në Malësinë e Madhe, në rrethinat e Koplikut, rrethinat e Bajzës, fshatrat Reç, Dedaj, Zagorë dhe Repisht, në Shkodër dhe në fshatin Ndërlisaj, ndërsa në bashkinë Tropojë në njësitë administrative të Tropojës, Bujanit, Margegajt dhe Lekbibajt.

Gjithashtu, është e rëndësishme të kryhen studime më të thella dhe sondazhe në lidhje me sasinë dhe përbërjen e mbetjeve dhe ndotësve të rrezikshëm. Si rezultat i rritjes graduale të sasisë së mbetjeve në rajonin e alpeve, shihet i nevojshëm krijimi i disa pikave të transferimit të mbetjeve dhe më pas transportimit të tyre në landfill-et më të afërta. Stacionet e transferimit të mbetjeve duhet të vendosen aty ku është e nevojshme, sidomos në zonat që përbëjnë fluksin më të madh të gjenerimit të mbetjeve. Gjithashtu, do të nevojiten edhe mjete të reja për grumbullimin e mbetjeve për bashkitë përkatëse si dhe mjete për transferimin e mbetjeve në landfill.

Nga ana tjetër, fushatat ndërgjegjësuëse vlerësohen të rëndësishme për të promovuar sjelljet e mira mjedisore dhe ndarjen e mbetjeve, për të informuar mbi dëmet e shkaktuara nga hedhja e mbetjeve, si dhe për të promovuar ripërdorimin e materialeve të riciklueshme.

Për të përmirësuar situatën e krijuar nga mungesa e një menaxhimi të përshtatshëm të mbetjeve, shihet e nevojshme vendosja e disa masave zbutëse si më poshtë:

- Edukimi mjedisor në të gjithë zonën dhe për të gjithë kategoritë e popullsisë duke filluar me fëmijët;
- Krijimi i vend-grumbullimit të mbetjeve inerte (që rezultojnë nga proceset e ndërtimit);
- Inventarizimi i plotë i vend-grumbullimeve (të ligjshme ose jo) të mbetjeve;
- Minimizimi i mbetjeve (duke eliminuar mbetjet organike që mund të kompostohen e përdoren për plehërime);
- Pakësimi i mbetjeve përmes përdorimit të materialeve shumëpërdorimshme;
- Zbatimi i parimit 3R (Ripërdorim, Riciklim, Reduktim);
- Ricklimi dhe kompostimi i mbetjeve;
- Mbledhja e diferencuar e mbetjeve, duke ndarë fillimisht kategoritë bazë (letër, plastikë, qelqë, metale, dhe mbetje me bazë druri);
- Zhvillimi i infrastrukturës dhe përfshirja në planet rajonale e vendore të menaxhimit të mbetjeve;
- Transferimi i mbetjeve në landfill-e që plotësojnë standardet mjedisore, si mundësia më e përshtatshme nëse në zonë nuk ka të tilla.

4.3

ENERGJIA & TELEKOMUNIKACIONI

Energjia hidroelektrike është forma më e përdorur e energjisë së rinovueshme në Shqipëri, ashtu si në rajonin e Alpeve Shqiptare. Prania e hidrocentraleve më të mëdhenj në vend si kaskada e Drinit dhe një numër i madh hidrocentralësh të vegjël në zonë, mundëson prodhimin e mbi 75% të prodhimit në rang kombëtar. Problemet që hasen në zonë për sa i përket furnizimit me energji elektrike kanë të bëjnë më shumë me sistemin e shpërndarjes dhe jo me mungesën e prodhimit të energjisë elektrike. Rrjeti i amortizuar, në pjesën më të madhe të tij shfaq probleme gjatë pikut të kërkesës që përkon me sezonin turistik, si dhe gjatë stinës së dimrit. Aktualisht është në zbatim një projekt i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për kalimin e rrjetit nga 10 KV në 20 KV.

Ndriçimi publik ofrohet pjesërisht në lokalitetet e nivelit I dhe në ato lokalitete ku ka pasur ndërhyrje të rikualifikimeve të qendrave të fshatrave. Ky shërbim duhet të sigurohet përmes një ndërhyrjeje të kufizuar vetëm në qendrat e fshatrave të përcaktuar për rikualifikim nga ky plan. Ky kufizim bëhet me qëllim ruajtjen e karakterit të theksuar rural të lokaliteteve.

Përdorimi i energjisë eolike, duke u nisur edhe nga eksperiencat e rajoneve të ngjashme alpine, ka impakt jo pozitiv në krahasim me pritshmëritë. Shpejtësia e nevojshme e erës për prodhimin e kësaj energjie arrihet në majat e maleve. Instalimi i turbinave eolike në këto vende do të kishte impakt negativ në peizazh dhe do të kërkonte investime tepër të larta infrastrukturore për ndërtim dhe mirëmbajtje.

Përdorimi i energjisë diellore duhet nxitur nëpërmjet promovimit dhe formave lehtësuese për financimit e sistemeve që përdorin këtë formë energjie. Energjia diellore përdoret si burim nxehtësie dhe uji të ngrohtë për banesat nëpërmjet paneleve termale, dhe në formën e energjisë elektrike nëpërmjet sistemeve fotovoltaike. Kjo teknologji nuk ka impakt mjedisor dhe nuk ndikohet nga ndryshimet klimatike. Luhatja e rrezatimit mesatar ditor diellor në zonën e alpeve varion nga 3,2 - 3,8 kWh. Nxitja për përdorimin e energjisë

diellore për ngrohje do të çonte në konsolidimin e konsumit të burimeve të tjera të energjisë termike dhe madje në uljen e tyre, duke ndikuar pozitivisht në ekonomi dhe në mjedis.

Gjithashtu, duhet përmendur edhe varianti i parashikuar për një degëzim të gazsjellësit TAP drejt Kosovës në afërsi të Kukësit, dhe një tjetër degëzim që kalon nga Shkodra në drejtim të Malit të Zi. Të dyja këto linja transmetimi të gazit kalojnë tangent me rajonin e alpeve, duke mundësuar kështu një alternativë tjetër energjetike.

Energjia termike nga biomasa ose konkretisht djegia e drurit për ngrohje gjatë stinës së dimrit, vazhdon të jetë metoda më tradicionale dhe më e përhapur në zonën e alpeve. Një pjesë e strukturave akomoduese përdorin sisteme ngrohjeje qendrore nëpërmjet instalimit të kaldajave, duke përdorur si lëndë të parë peletin e importuar kryesisht nga Kosova. Përdorimi i kontrolluar i drurit si burim për prodhimin e energjisë termike mund të konsiderohet i qëndrueshëm nëse merren masa për ruajtjen e ekuilibrave në prerje dhe pyllëzim, duke nxitur njëkohësisht aplikimin e sistemeve termoizoluese të strukturave.

Djegia e drurit dhe biomasave të ngjashme çliron gazra të dëmshme në atmosferë, prandaj duhet detyruar përdorimi i filtrave të posaçëm për pakësimin e tyre.

Për rritjen e përdorimit efikas të energjisë në ndërtesa, duhen zhvilluar programe informuese për banorët dhe bizneset që operojnë në zonë. Masat që duhen marrë për rritjen e përdorimit efikas të energjisë janë: termoizolimi i ndërtesës, montimi i dritareve me dopio xham, instalimi i ngrohjes qendrore, përdorimi i elektro-shtëpiakeve efikase, përdorimi i burimeve të rinovueshme nëpërmjet sistemeve autonome në ndërtesë, etj.

Telekomunikacioni

Mbulimi i të gjithë zonës së alpeve me rrjet të telefonisë celulare duhet të trajtohet si një projekt prioritar. Sipërfaqja me shërbim të kufizuar apo pa mbulim me telefoni celulare është e konsiderueshme, sidomos në zonat më tërheqëse për turizmin.

Mungesa e rrjetit celular është shfaqur si problematikë si nga banorët e zonës edhe nga turistët, duke u renditur si shërbim i nevojshëm për thirrje ndihme në rast humbjeje apo aksidentimi.

Ndërkohë mbulimi me internet në zonë është tepër i kufizuar sidomos në zonat e thella, dhe ka shumë pak pika që e ofrojnë këtë shërbim në zonat turistike.

Interneti është kthyer në një mjet kyç për sa i përket orientimit të turistit, duke i mundësuar vetorganizimin, kontaktimin e strukturave akomoduese apo guidave turistike pa qenë nevoja për përfshirjen e ndërmjetësve, dhe duke e njohur me produktin turistik e përditësimin e ofertave në zonë.

Rezervimet dhe informimi online i mundëson turistit mirëinformimin mbi tarifatat dhe ofertat, si edhe operatorit turistik mirëmenaxhimin e akomodimeve dhe flukseve të mbërritjes në zonë.

Zbatimi i një projekti për ndërtimin e infrastrukturës së internetit në zonën e alpeve është me rëndësi, me prioritet lokalitetet që njihen tashmë si pika turistike dhe zonat që priten të kenë rritje të turizmit.

4.4

QENDRAT SHËNDETËSORE & SKUADRAT E KËRKIM-SHPËTIMIT

Sektori shëndetësor në zonën e studimit të PKST-Alpe ka nevoja të ndjeshme për investime dhe përmirësime në cilësinë e strukturave, në numrin e tyre dhe në personelin mjekësor. Personeli mjekësor në një territor të tillë duhet të trajnohet jo vetëm në shëndetësinë parësore por dhe në trajtimin e traumave dhe ofrimin e ndihmës së parë.

Nga analiza e shërbimit dhe infrastrukturës shëndetësore në zonë, më poshtë jepen disa sugjerime për të përmirësuar sistemin shëndetësor, jo vetëm për banorët e rajonit të Alpeve Shqiptare por edhe për turistët e shumtë që vizitojnë këtë rajon. Duhet të merret parasysh se ofrimi i një shërbimi shëndetësor cilësor dhe në kohë është një element i domosdoshëm për ofrimin e një turizmi funksional në zonë.

- Qendrat shëndetësore të kujdesit parësor së bashku me degët e tyre duhet të shihen si pika të rëndësishme me të cilat përballet fillimisht pacienti shqiptar ose ai i huaj, duke i kthyer ato në pika të besueshme dhe me shërbim cilësor;
- Duhet të parashikohet një plan investimesh me synimin që brenda një kohe të shkurtër dhe paralelisht me reformat në shërbimin shëndetësor parësor, të përmirësohet infrastruktura e qendrave shëndetësore të kujdesit parësor;
- Qendrat shëndetësore në zonë duhet të menaxhojnë buxhetin e tyre përkatës dhe të rrisin kapacitetet në bashkëpunim me organizata të ndryshme të shoqërisë civile që operojnë në fushën e shëndetësisë për të tërhequr fonde të tjera;
- Duhet të unifikohen shërbimet shëndetësore në të gjithë zonën;
- Duhet të përmirësohet infrastruktura në lidhje me pajisjet, medikamentet dhe dokumentacionin sipas standardit të miratuar dhe të riparohen të gjitha ambulancat e zonës;
- Duhet të investohet në rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve në zonat rurale;

- Mjekët e përgjithshëm që ndërkohe janë në detyrë, duhet të kryejnë specializimin e nevojshëm për të shërbyer si mjek familjeje;
- Duhet sjellë domosdoshmërisht një infermiere-mami në zonat rurale;
- Duhet të kryhet planifikimi dhe ndërtimi i laboratorëve pranë qendrave shëndetësore kryesore, ku të mund të kryhen analizat bazike;
- Duhet të analizohet mundësia e ofrimit të shërbimeve të specializuara shëndetësore në qendrat kryesore të zonës;
- Qendrat shëndetësore duhet të mbajnë regjistrat dhe të gjithë dokumentacionin e pacientëve sipas rregulloreve përkatëse;
- Nevojitet planifikimi i programeve të trajnimit për personelin mjekësor, duke përfshirë edukimin e vazhdueshëm mjekësor;
- Qendrat shëndetësore duhet të masin kënaqësinë e pacientëve të tyre dhe të krijojnë një bazë të dhënash të kompjuterizuara lidhur me këtë aspekt.

Shërbimi mjekësor modern e me pajisje të mira sjell përfitime jo vetëm për banorët e rajonit të alpeve por edhe për turistët që vizitojnë këto zona gjatë gjithë vitit e sidomos gjatë fluksit turistik. Për këtë arsye dhe në mbështetje të sezonit turistik, është i nevojshëm përforsimi i shërbimit shëndetësor me shërbim 24 orë dhe me pajisje të reja, furnizimi me barna dhe materiale mjekësore shtesë, në përgjigje të nevojave që ka sezoni turistik për shkak të rreziqeve që mund të kanosen në këto zona.

Krijimi i Skuadrave të Kërkim-Shpëtimit (SKSh) për monitorimin e zonës së alpeve u siguron turistëve dhënien e ndihmës së parë, dhe është një domosdoshmëri për shmangien e aksidenteve apo edhe tragjedive në këtë zonë. Prania e SKSh do të ofronte shërbim dhe siguri për vizitorët duke krijuar një klimë më të favorshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në zonat malore.

Pjesëtarët e SKSh duhet të trajnohen si nga ana fizike ashtu edhe logjistike. Ata duhet ta njohin mirë zonën dhe të zhvillojnë praktika në terrenin që mbulojnë. Formimi i tyre duhet bazuar mbi programe specifike dhe stimulime në të gjitha llojet e terrenit në alpe, si në shpella, hone, shpate vertikale, lumenj, liqene akullnajore, kavitete shkëmbinjsh, terrene të rrëshqitshme, etj.

Për secilin nga rastet e ndërhyrjes duhen krijuar rregulloret e ndërhyrjes, në mënyrë që çdo pjesëtar i SKSh të jetë i qartë për funksionin që do të kryejë, duke shmangur kështu kaosin dhe duke i shkurtuar kohën e dhënies së ndihmës të aksidentuarit. Pjesë e këtij grupi duhet të jenë edhe mjekët e urgjencës, të cilët gjithashtu duhet të jenë trajnuar në lidhje me teknikat e manovrimit në terrene të vështira. Përveç sigurimit të personelit, është e domosdoshme edhe pajisja me mjetet e duhura për kryerjen e këtyre operacioneve.

Në vendet perëndimore, grupet që operojnë në këto zona janë të pajisura me automjete tip fuoristradë (4x4), motoslita, pajisje trupore (kaskë, doreza, litarë, lopatë, sëpatë, etj.), kuti të ndihmës së shpejtë, qen kërkimi dhe shpëtimi, barrela, dhe në rastet më ekstreme kryhen ndërhyrje nga ajri me helikopterë, ku bëhet një koordinim mes SKSh, forcave ushtarake dhe atyre të emergjencave civile.

Thirrja për ndihmë

Në rast aksidentimi apo humbjeje në zonat malore, së pari duhet njoftuar SKSh. Personat që kryejnë aktivitete në zonat malore duhet të mbajnë me vete një telefon celular ose radio për të kryer thirrjen për ndihmë. Për të mundësuar kontaktin me SKSh duhet vënë në dispozicion një numër telefonie.

Përveç kësaj, zona shfaq edhe problematikën e mungesës së mbulimit me rrjet telefonie, sidomos në ekstremin verior të alpeve dhe në perimetrin e vijës kufitare. Nëse i dëmtuari nuk është në gjendje të bëjë thirrjen për ndihmë, atëherë një shoqërues i tij duhet ta ndihmojë duke u spostuar nga vendi ku ka ndodhur aksidenti në kërkim të sinjalit telefonik. Në rast se personat që duan të eksplorojnë këto zona dalin të vetëm në terren, këshillohet të njoftojnë familjarët ose të njohurit e tyre për itinerarin që do të kryejnë. Kur bëhet thirrje për ndihmë është e nevojshme të jepen informacione në lidhje me vendndodhjen e të dëmtuarit, llojin e dëmtimit që ka pësuar dhe informacione të tjera që do të kërkohen nga SKSh.

4.5

ORIENTIME NGA VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR

Arritja e objektivave mjedisore në fushat e përcaktuara nga zbatimi i planit të alpeve, kërkon zbatimin e një sërë masash zbutëse. Zbatimi i udhëzimeve të përgjithshme dhe i këtyre masave zbutëse do të parandalojë efektet negative dhe do të sigurojë arritjen e objektivave mjedisore. Duhet theksuar se lista e mëposhtme e masave specifike për zbutjen nuk është shteruese. Masa më të detajuara në aspektin e përmbajtjes dhe analizës do të duhet të përgatiten si pjesë e VNM-ve individuale për çdo projekt specifik të planit.

4.5.1 Rekomandime për mbrojtjen e tokës

Aktivitetet e parashikuara për t'u zbatuar në zonën e alpeve mund të shkaktojnë ndikime të përhershme apo të përkohshme, të cilat do të reflektohen si një ndryshim në strukturën dhe përdorimin e tokës.

Aktivitetet në tokat bujqësore dhe në pyjet me pjerrësi të madhe, duhet të kufizohen maksimalisht ose të eliminohen. Gjithashtu, përdorimi i materialeve të riciklueshme, ripërdorimi i elementëve etj., konsiderohen si mundësi shumë efikase për ruajtjen e tokave natyrore.

Masa mbi tokat bujqësore, tokat pyjore dhe kullotat

- Zbatimi i praktikave të mira bujqësore (punime, mirëmbajtje, ujitje, rotacion kulturash);
- Mbrojtja e llojeve vendase (kulturat bujqësore tradicionale si bimët, pemët, pjergullat, racat vendase në blegtori, bletaria, etj.);
- Zbatimi i praktikave agro-pyjore;
- Përdorimi racional i tokës (në zonat e përdorimit tradicional dhe zonat e zhvillimit të qëndrueshëm të parkut);
- Mbrojtja e tokave nga rrëshqitjet, erozioni dhe degradimi;
- Menaxhimi i tokave të braktisura;
- Mospërdorimi (në zonat qendrore të zonave të mbrojtura);
- Ndalimi i prerjes së drurëve në anët e rrugëve, në anët e rrjedhjeve ujore, në kufijtë e sipërm të vegjetacionit, në shpatet e pjerrëta dhe në tokat që rrezikojnë të rrëshqasin;
- Zbatimi i programeve për mbjelljen e sipërfaqeve të zhveshura, ato që ndodhen përreth qendrave të banuara si dhe në anë të rrjedhjeve ujore.

Mbrojtja e tokës nga erozioni

- Ndërthurja e masave të karakterit inxhinierik (diga, mure, gardhe) me ato biologjike (mbjellje);
- Programet për pyllëzime apo mbjellje me bimë që kanë një cikël të gjatë prodhimi (veshja e tokës me bimësi të përhershme);
- Mbrojtja e argjinaturave të rrjedhjeve ujore me anë të punimeve inxhinierike të kombinuara me mbjellje drurësh dhe bari për mbrojtjen e shpateve nga erozioni;
- Ndërthurja e masave inxhinierike me ato biologjike në rastin e tokave me pjerrësi të madhe;
- Rigjenerimi i sipërfaqeve pyjore të djegura e të dëmtuara nga prerjet.

4.5.2 Rekomandime për ruajtjen e cilësisë së ajrit

Aktualisht në territorin alpin ka argumente të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se cilësia e ajrit është brenda normave të vendit për sa i takon niveleve të lejuara të ndotjes nga pluhurat PM 10 dhe PM 2,5, dioksidi i squfurit (SO₂), oksidet e azotit (NO_x), ozoni troposferik (O₃), monoksidi i karbonit (CO), komponimet volatile pa metan (benzeni C₆H₆).

Masat për parandalimin e ndotjes së ajrit janë të shumëllojshme dhe në varësi të burimit të ndotjes.

Masat kryesore janë:

- Hartimi i planeve rajonale dhe vendore me qëllim përmirësimin e cilësisë së ajrit;
- Përmirësimi i transportit publik;
- Menaxhimi efikas i rrjetit rrugor dhe trafikut;
- Promovimi i përdorimit të biçikletave;

- Rritja e sipërfaqeve të gjelbra si dhe pastrimi e larja e rrugëve;
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore për një qarkullim më të mirë;
- Ngritja e kapaciteteve lokale për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe mjedisit në tërësi;
- Gjelbërimi i akseve rrugore.

4.5.3 Rekomandime për mbrojtjen e elementeve ujore

Zona e Alpeve Shqiptare është ndër zonat më të pasura më ujë. Për shkak të modulit të reshjeve, alpet përbëjnë zonën me nivelin më të lartë të reshjeve në Shqipëri. Zhvillimet e pritshme në rajonin e alpeve duhet të marrin në konsideratë natyrën specifike të gjeologjisë, gjeomorfologjisë dhe hidro-gjeologjisë në këtë zonë.

Me qëllim ruajtjen e burimeve të shumta ujore të zonës së alpeve, duhet të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

- Shmangia e ndërtimeve në zona të ndjeshme nga pikëpamja hidrologjike (përfshirë edhe burimet nëntokësore);
- Shmangia e përmblytjeve të mundshme, me qëllim uljen e impaktit të ndotjes së ujërave;
- Mbrojtja e akuifereve të zonës;
- Mbrojtja nga ngjarjet ekstreme (rrjedhjet e substancave të rrezikshme) etj;
- Ndalimi i eutrofikimit të ujërave.

4.5.4 Rekomandime për mbrojtjen e peizazhit natyror dhe kulturor

Për të siguruar mbrojtjen e peizazheve me karakteristika të dallueshme e të rralla në nivel kombëtar dhe ruajtjen e një imazhi me cilësi të lartë të peizazhit në rajonin e Alpeve Shqiptare, duhet të ndiqen udhëzimet e mëposhtme:

- Ruajtje e strukturës ekzistuese të pemëve të mbjella përgjatë rrugëve;
- Ruajtje e bimësisë autoktone të mbjellë dhe zëvendësimi i bimësisë jo autoktone;
- Shtim i sipërfaqeve të pyllëzuara në zonat industriale, kryesisht në afërsi të Koplikut;
- Moslejimi i ndërhyrjeve të infrastrukturës së re në zonat e veçanta të peizazhit apo peizazheve që paraqesin karakteristika të dallueshme në nivel kombëtar;
- Përzgjedhje e bimësisë përgjatë akseve rrugore urbane për të krijuar një peizazh rrugor estetik dhe të rregullt;

- Mbrojtje ose rindërtim i zonave breglumore të Cemit, Vermoshit, Lëpushës, Përroit të Thatë, Shalës, Valbonës, lumit të Gashit, lumit të Tropojës, Nikaj-Mërturit, etj. Ndërrhyrjet kanë si qëllim mbrojtjen e tokës nga gërryerja, ndalimin e ndotjes nga sipërfaqet bujqësore në drejtim të lumit, ruajtjen e korridoreve lidhëse për habitatet, për strehimin dhe lëvizjen e specieve të ndryshme dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit;
- Mbjellje e bimësisë, e cila krahas rregullimit të peizazhit përshtatet me tokën dhe mund të zhvillohet në mjedise relativisht të ndotura. Për mbjelljen e pemëve në zonat industriale sugjerohen bimët si: plepi (*populus alba*), shelgu (*salix sp.*), lofata (*cercis siliquastrum*), rrapit (*platanus orientalis*), bliri (*tilia sp.*) etj;
- Ripyllëzim i zonave të shpyllëzuara dhe të degraduara nga shkaqe të ndryshme, si: zona pyjore e Kelmendit, Shkrelit, Thethit, Lekbibajt, Valbonës etj. Kjo do të sjellë një impakt pozitiv në ruajtjen e njëtrajtshmërisë dhe të bashkimit të pjesëve të copëtuara të pyjeve, duke krijuar një peizazh pyjor të vazhdueshëm.

Zhvillimi i infrastrukturës mund të ndikojë në njësitë dhe zonat kulturore, veçanërisht në aspektin e degradimit të karakteristikave të peizazhit, dëmtimit të zonave përreth njësitë të trashëgimisë kulturore dhe objekteve të trashëgimisë kulturore, si dhe shkatërrimit të mbetjeve arkeologjike nga vibrimet gjatë fazës së ndërtimit.

Për të shmangur këto ndikime, duhet të merren parasysh si më poshtë:

- Shmangia e infrastrukturës së re në zonat e trashëgimisë kulturore;
- Kryerja e studimeve dhe vëzhgimeve paraprake arkeologjike, rezultatet e të cilave do të duhet të merren parasysh kur të përcaktohet vendosja e infrastrukturës së re;
- Në rast të zbulimit të gjetjeve apo mbetjeve arkeologjike, do të njoftohet menjëherë autoriteti përkatës, duke mos lejuar asnjë zhvillim të mëtejshëm në atë zonë derisa çështja të zgjidhet sipas procedurave të përcaktuara;
- Me integrimin e infrastrukturës së parashikuar në mjedis, përmirësimet brenda korridoreve apo strukturave ekzistuese kanë përparësi mbi ndërtimet e reja;
- E gjithë puna e ndërtimit duhet të jetë e kufizuar brenda korridorit të punimeve.

4.5.5 Rekomandime për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit

Mjedisi natyror në rajonin e Alpeve Shqiptare është aktualisht në gjendje të mirë, megjithatë, për të ruajtur në mënyrë të qëndrueshme mjedisin natyror dhe biodiversitetin, duhet të merren parasysh masat e mëposhtme:

- Përzgjedhja e opsioneve që kanë ndikimin më të ulët në emigrimin e kafshëve të egra apo në fragmentimin e habitateve;
- Zbatimi i sugjerimeve përkatëse të planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura lidhur me zonimin dhe aktivitetet e lejuara apo të ndaluara në to;
- Përdorimi sa më i madh i infrastrukturës ekzistuese në raport me ndërtimin e infrastrukturës së re;
- Sigurimi i kalimeve të përshtatshme për kafshët e egra apo faunën e vogël (amfibët, reptilët etj.), duke u bazuar në praktikatat më të mira evropiane;
- Mosndërrhyrja (në Zonat Qendrore dhe për llojet strikte të mbrojtura, Aneksi II i Direktivës 92/43/EEC);
- Kontrolli, pakësimi ose zhdukja e llojeve invazive;
- Nxitja dhe shtimi i llojshmërisë së florës dhe faunës, si në rastet e suksesit të rritjes së riprodhimit të kaprollit, derrat të egër, shpendëve të pyllit dhe atyre grabitqarë.

Në përputhje me objektivin SKZHI II "Një rritje e synuar prej 17% e sipërfaqes së zonave të mbrojtura të territorit nëpërmjet përmirësimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura", sipërfaqja e zonave të mbrojtura pritet të rritet. Prandaj, ndërhyrja hapësinore e infrastrukturës së parashikuar në zonat e propozuara për mbrojtje duhet të shmangët për të parandaluar konfliktet e mundshme dhe ndikimet negative në arritjen e objektivave mjedisore për ruajtjen e natyrës.

4.5.6 Rekomandime për uljen e zhurmave dhe ndotjen akustike

Në rajonin e Alpeve Shqiptare niveli i zhurmave është përgjithësisht i kufizuar. Kjo lidhet me zhvillimin e ulët urban dhe mungesën e aktiviteteve industriale. Zonat e banuara ndodhen përgjithësisht larg burimeve të zhurmës, si p.sh. sistemi rrugor, dhe për pasojë ndikimi i tyre në shëndetin publik dhe atë mjedisor është relativisht i ulët.

Megjithatë, në rastet e planifikimit të politikave për zhvillimin e infrastrukturës në përputhje me objektivat e SKZHI II, nevojitet ndjekia e disa udhëzimeve si më poshtë:

- Duhet të merren masa për uljen e zhurmës që në burim (masa në rrjetin apo strukturën përkatëse infrastrukturore, masa për automjetet në përdorim, masa logjistike, masa për riorganizimin e përkohshëm ose të përhershëm të lëvizjeve tranzite, për shkurtrimin e orareve të punës apo uljen e shpejtësisë në zonat e ekspozuara ndaj zhurmës, etj.);
- Në zonat ku tejkalohe kufijtë e ndotjes akustike duhet të merren masa për të parandaluar shtrirjen e zhurmës në mjedis (nëpërmjet barrierave të zhurmës, argjinaturave që izolojnë zhurmat etj.) dhe për të siguruar kushte të mira jetese në ndërtesa (mbrojtja pasive);
- Duhet të shmangët sa më shumë që të jetë e mundur ndërhyrja në zonat e qeta të banuara dhe / ose në zona të përcaktuara nga legjislacioni për mbrojtjen nga zhurma si veçanërisht të ndjeshme ndaj zhurmës (qendrat e banimit, objektet e kujdesit shëndetësor, zonat turistike, shkollat etj.);
- Duhet të shmangët sa më shumë ndërhyrja në zonat e mbrojtura në natyrë (zonat e mbrojtura në përputhje me rregullat për ruajtjen e natyrës).

4.5.7 Rekomandime ndaj ndryshimeve klimatike

Zhvillimi i zonës së alpeve duhet të marrë në konsideratë edhe skenarët e ndryshimeve klimatike. Kjo është e rëndësishme veçanërisht për infrastrukturën, qendrat e banuara dhe shërbimet. Kjo do të thotë se kur planifikohet infrastruktura, duhet të merren parasysh masa për vlerësimet e rreziqeve, të cilat rrisin elasticitetin e infrastrukturës ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht në raport me reshjet, përmbytjet, temperaturat e larta dhe valët e të nxehtit, thatësitat, rritjet e nivelit të detit dhe stuhitë.

Marrja e masave dhe zbatimi i mënyrave për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike do të mund të pakësonin efektet negative që po shtohen çdo ditë e më shumë. Ndër këto masa përfshihen:


- Masa në nivelin e politikave. Këtu mund të rendisim bazën e nevojshme ligjore, strategjitë sektoriale apo të përgjithshme, planet e veprimtimit etj., të cilat japin kuadrin e përgjithshëm të masave dhe politikave përkatëse. Në rastin konkret, politikat sektoriale duhet të marrin në konsideratë ndikimin që kanë dhe do të vazhdojnë të kenë ndryshimet klimatike në këtë sektor, duke parashikuar për çdo rast masat zbutëse ndaj këtyre ndryshimeve.
- Masa të karakterit teknik. Këtu përfshihen masa të sugjeruara nga specialistë të fushës. Këto masa i kanë kostot e llogaritura si dhe afatin kohor se kur do të zbatohen.
- Masa në nivelin e fermës / familjes. Kjo do të thotë se fermerët e banorët do të zbatojnë një pjesë të rëndësishme të masave që janë pjesë e punës së tyre të përditshme. Në këtë kategori përfshihen masa të tilla si: zgjedhja e përshtatshme e kohës së mbjelljes, përzgjedhja e varietetit më të përshtatshëm për kushtet e fermës, koha dhe mënyra e ujitjes dhe plehërimit, qarkullimi i kulturave bujqësore, praktikatat e mira të punimit dhe menaxhimit të tokës etj.

Disa nga masat që rekomandohen dhe që mund të zbatohen në zonën e alpeve, përfshijnë:

Rreziku i pritshëm	Masat zbutëse
Thatësira	<ul style="list-style-type: none"> • Modelimi bimor për të gjitha kulturat kryesore në zonë (misrin, grurin, perimet, foragjerët), bazuar në skenarët e ndryshimeve klimatike të parashikuara për zonën; • Përmirësimi i plehut organik (përmirësim i mënyrës së ruajtjes dhe përdorimit të plehut organik, duke e përdorur atë në mënyrë efikase); • Përmirësimi i organizimit të fermerëve në shoqata, në mënyrë që të rritet shkalla e lobimit për çështjet e bujqësisë në zonë; • Përdorimi i burimeve alternative për energji (p.sh. biogazi) në fermat blegtorale me numër të konsiderueshëm krerësh;
	<ul style="list-style-type: none"> • Përcaktimi i saktë i kohës së mbjelljes duke u këshilluar me specialistin e bujqësisë; • Përmirësimi gjenetik duke përdorur varietete që janë rezistente ndaj thatësirës dhe sigurojnë një rendiment të lartë; • Përdorimi i programeve të tilla si <i>CropWat</i> për ndërtimin e skenarëve efikasë të ujitjes;
	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e kapaciteteve të depozitave ujore (rezervuare, depozita etj.); • Përcaktimi mbi baza shkencore i kohës dhe periodicitetit të ujitjes; • Mbështetja për fermerët që përdorin ujin në mënyrë efikase;
	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i menaxhimit të ujit për ujitje (transporti, cilësia, skema, etj.); • Përmirësimi i teknologjisë së ujitjes përmes përdorimit të ujitjes me pika;
	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e shkallës së edukimit dhe ndërgjegjësimit për problemet që lidhen me ndryshimet klimatike; • Hartimi i masave parandaluese dhe paralizuese ndaj zjarreve në nivel fshati apo njësie administrative; • Ndërtimi i një partneriteti ndërmjet njësive administrative për të bashkëpunuar në raste zjarresh apo përmbytjesh;
	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësim i efektivitetit të menaxhimit të pesticideve/herbicideve; • Programe të përhershme monitorimi për sëmundjet dhe dëmtuesit; • Përcaktimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit të karantinës; • Qarkullimi i kontrolluar, shumëllojshmëria dhe periodiciteti i kulturave bujqësore;
	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i certifikuar i farërave, fidanëve, plehrave dhe kimikateve që përdoren në bujqësi, duke zbatuar më rreptësi kartelat teknologjike të tyre; • Zhvillimi i bujqësisë organike në zonë (me sa më pak përdorime kimikatesh);
	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i praktikave agro-pyjore, duke ndërtuar breza pyjore në anë të tokave bujqësore, kanaleve ujitëse e kulluese, si dhe veprave mbrojtëse (digave, argjinaturave etj.), për të pasur më shumë bazë ushqimore për blegtorinë, për të mbrojtur më shumë tokat bujqësore, qendrat e banuara, infrastrukturën etj., si dhe për t'i krijuar më shumë kushte të favorshme faunës së zonës;

	<ul style="list-style-type: none"> Ndalimi i ndërtimeve në zona potencialisht të rrezikuara nga përmbytjet, apo mbi veprat ujitëse e kulluese;
	<ul style="list-style-type: none"> Ripërdorimi i ujit që përdoret për ujitje. Rekomandohet që në stinën e verës kanalet kulluese të mbeten të mbyllura (të mos lejohet rrjedhja e ujit), në mënyrë që t'i mbajnë ujërat nëntokësore në afërsi të sipërfaqes sa më shumë të jetë e mundur. Kjo kursen ujin që përdoret për ujitje dhe numrin e ujitjeve për sezon; Mirëmbajtja e vazhdueshme e kanaleve ujitëse e kulluese; Mbrojtja e argjinaturave dhe digave që të jenë vazhdimisht efikase;
	<ul style="list-style-type: none"> Përcaktimi i saktë i kohës së kullotjes së sipërfaqeve që janë objekt kullotjeje nga blegtorja; Alternimi i ushqimit për kafshët duke u këshilluar me specialistin zooteknik; Kultivimi i foragjerëve me vlera të larta ushqyese; Përdorimi i racave të blegtorisë që janë më rezistente ndaj të nxehtit;
	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemit të ujitjes në të tre sistemet e kanalizimeve (I, II, III); Ruajtja nga ndotja e kanaleve kulluese e ujitëse, pasi kjo ndotje riciklohet përmes ujit që përdoret për ujitje; Rritja e periodicitetit të ujitjes (ujitje më shpesh, duke përdorur më pak ujë); Mospërdorimi për ujitje i ujërave nëntokësore nëse nuk janë në përputhje me cilësinë që kërkohet;
Valët e të nxehtit	<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i skemave mbrojtëse për bujqësinë dhe blegtorinë; Marrja e masave për informimin e fermerëve; Mbulimi i kulturave (mbulim me kashtë, byk etj.), në mënyrë që të ruhen nga dielli; Ujitja e shpeshtë dhe jo në periudhën e pikut të vapës; Ndërtime termo-izoluese;
Përmbytjet	<ul style="list-style-type: none"> Përmirësimi i sistemit të kullimit duke u bazuar në skenarët maksimalë të ndryshimeve të klimës dhe përvojës aktuale; Hartimi i skemave siguroese/kompensuese ndaj fatkeqësive natyrore; Ndërtimi i një partneriteti ndërmjet tre njësive administrative, për të bashkëpunuar në raste përmbytjesh apo ngjarjesh të tjera ekstreme;
	<ul style="list-style-type: none"> Ndalimi i aktivitetit të marrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve; Ndalimi i hapjes së puseve në mënyrë të pakontrolluar; Monitorimi periodik i cilësisë së ujërave;
	<ul style="list-style-type: none"> Planifikimi i të gjitha veprave inxhinierike në zonë dukë marrë në konsideratë skenarët maskimalë të ndryshimeve klimatike;
Rritje e frekuencës së ngjarjeve ekstreme të klimës	<ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i varieteteve me ndikim të ulët nga variacionet e menjëhershme të klimës; Përgatitja dhe vendosja në gatishmëri e materialeve izoluese ndaj të nxehtit e të ftohtit ekstrem, si dhe marrja paraprake e masave të tilla;

	<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet ekspertëve të klimës me ata të bujqësisë;
Shtim i sëmundjeve dëmtuesve dhe epidemive	<ul style="list-style-type: none"> • Shkëmbimi i informacionit dhe këshillimi i vazhdueshëm me specialistët e bujqësisë në zonë; • Rritja e efikasitetit të sistemit të prognozë-sinjalizimit; • Trajnime për të njohur sëmundjet dhe dëmtuesit e panjohur më parë; • Përdorimi i farërave të llojeve bimore e shtazore të certifikuara; • Përcaktimi i masave karantine; • Stimulimi i bujqësisë organike;
Erozioni	<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i praktikave menaxhuese të tokës. Kjo nënkupton përmirësimin në mënyrë rrënjësore të strukturave të bimëve që kultivohen në një zonë të caktuar. Rekomandohet që në zonat me pjerrësi të kultivohen bimë shumëvjeçare (p.sh. jonxha), të cilat nuk kërkojnë punime të përvitshme të tokës. • Përmirësimi i procesit të punimit dhe prashitjes së tokës. Praktika të mira janë punimi dhe prashitja horizontale, si dhe mbjellja e bimëve në rreshta; • Përmirësimi i ujitjes. Ujitja me përmytje përfaqëson një problem serioz përse i përket erozionit, pasi kërkon sasi të madhe uji dhe nuk është efektive. Ndaj, ujitja me pika mbetet zgjidhja më e mirë. • Përdorimi i kontrolluar i plehrave kimike, i cili ndihmon që procesi i shpëlarjes dhe degradimit të tokës të jetë sa më minimal. Përdorimi i plehrave të tilla duhet bërë vetëm pas kryerjes së analizave kimike të tokës dhe konsultimit me specialistin e bujqësisë. • Mbjellja e drurëve. Veçanërisht në zonat përreth tokave bujqësore, ky proces duhet të jetë një prioritet i përhershëm. Rekomandohet mbjellja e drurëve të shumëqëllimshëm (arra, gështenja, qershia, lajthia etj.), të cilët përveçse mbrojnë tokën nga erozioni, japin edhe prodhime të përvitshme. Kjo praktikë rekomandohet për të gjitha zonat e vendit. • Ndërtimi i brezave pyjore në brigjet e lumenjve dhe në anë të tokave bujqësore. Kjo praktikë ndihmon stabilizimin e brigjeve, rritjen e jetëgjatësisë së tyre dhe ul shpejtësinë e erërave në zonë, duke ulur në këtë mënyrë shkallën e avullimit nga toka (për rrjedhje ul kërkesën e bimëve për ujë). Breza të tillë ndihmojnë gjithashtu në uljen e shkallës së fragmentimit të habitateve, duke u bërë korridore biologjike për faunën. • Ndalimi i aktiviteteve minerare në shtretërit e lumenjve. • Marrja e masave për rehabilitimin e shtretërve të lumenjve përmes mbjelljes së pemëve në to (duke përdorur plepa, shelgje etj.) dhe rehabilitimi i argjinaturave të dëmtuara përmes rindërtimit dhe krijimit të gardheve të gjalla për rritjen e jetëgjatësisë së tyre.



05

PLANI I VEPRIMEVE PËR ZBATIMIN E PKS- së

- 5.1 METODOLOGJIA DHE PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE
- 5.2 FAZAT E ZBATIMIT TË PROJEKTEVE PRIORITARE DHE KOSTOT E TYRE
- 5.3 INDIKATORËT PËR MONITORIMIN DHE ZBATIMIN E PKS-SË
- 5.4 NDRYSHIMET E NEVOJSHME NË KUADRIN LIGJOR DHE ADMINISTRATIV
- 5.5 KOSTOT DHE FINANCAT E NEVOJSHME PËR ZBATIM

5.1

METODOLOGJIA & PËRCAKTIMI I PRIORITETEVE

Për të arritur vizionin e zhvillimit të sektorit të turizmit në Alpet Shqiptare, është e nevojshme të ndërmerren dhe zhvillohen një sërë veprimesh. Vizioni i zhvillimit përkthehet në tre objektiva që përbëhen nga programe strategjike, ku në secilin program detajohen veprimet konkrete që duhet të ndërmerren.

Këto veprime të propozuara përkthehen në kartela projektesh dhe koncept-projektsh, të cilat paraqiten në formë skede ku përmbledhen informacionet kryesore të projektit të propozuar. Informacioni i përmbajtur në skeda është:

- Titulli i projektit
- Zona në të cilët do të aplikohet ky projekt
- Objektivat e projektit
- Përshkrimi i projektit
- Kushtet specifike të zbatimit të projektit
- Përfituesit e projektit
- Kosto e projektit
- Financuesit e mundshëm
- Indikatorët e vlerësimit të projektit

Duke qenë se çdo projekt ka një ndikim të caktuar në territor, kërkon një afat kohor dhe ka nevojë për burime financimi, është e nevojshme të përcaktohet një metodologji për të përcaktuar prioritetet e zhvillimit dhe nisjen e zbatimit.

Pra, vlerësimi dhe renditja së projekteve sipas prioritetit është mëse i nevojshëm për të identifikuar investimet prioritare. Kjo lloj renditjeje evidenton dhe mbështet projektet që mund të ndërmerren në plan afatshkurtër, afatmesëm apo afatgjatë.

Bazuar në objektivat, vizionin dhe parimet e strategjisë së alpeve për zhvillimin e territorit, janë identifikuar 10 kriteret kryesore për vlerësimin e projekteve:

- Ndikimi i projektit në mbrojtjen e natyrës
- Ndikimi mjedisor
- Ndikimi i projektit në projektet e tjera
- Ndikimi në flukset turistike
- Kosto e investimit
- Efektiviteti i kostos
- Përfituesit
- Mundësia për punësim në shkallë lokale

- Ndikimi i projektit në shërbimet turistike të lokaliteteve
- Ndikimi në lokalitete sipas nivelit

5.1.1 Ndikimi i projektit në mbrojtjen e natyrës
Peizazhi natyror, vlerat natyrore, flora dhe fauna, evidentohen si disa nga avantazhet konkurruese kryesore të Alpeve Shqiptare. Në këtë kontekst, mbrojtja e natyrës shfaqet si një kriter i rëndësishëm në vlerësimin e prioritetit të projekteve strategjike.

Mbrojtja e natyrës	Vlerësimi
Nuk ndikon në mbrojtjen e natyrës	1
Ndikon mesatarisht në mbrojtjen e natyrës	3
Ndikon në mbrojtjen e natyrës	5

Projektet do të vlerësohen në funksion të rolit të tyre në mbrojtjen e mjedisit, ku:

- do të vlerësohen me 1 ato projekte që nuk kanë për qëllim dhe nuk ndikojnë në mbrojtjen e natyrës;
- do të vlerësohen me 3 projektet që nuk kanë për qëllim mbrojtjen e natyrës por kanë një ndikim direkt/indirekt në mbrojtjen e saj;
- do të vlerësohen më 5 projektet që kanë si qëllim kryesor mbrojtjen e natyrës.

5.1.2 Ndikimi mjedisor

Projektet kanë një ndikim pozitiv ose negativ në mjedis. Në këtë kontekst, kriteri i vlerësimit të ndikimit mjedisor do t'i japë prioritet projekteve me ndikim pozitiv në mjedis.

Ndikimi mjedisor	Vlerësimi
Ka ndikim negativ në mjedis	1
Nuk ka ndikim domethënës në mjedis	2
Ka ndikim pozitiv të ulët në mjedis	3
Ka ndikim pozitiv mesatar në mjedis	4
Ka ndikim pozitiv të lartë në mjedis	5

5.1.3 Ndikimi i projektit në projektet e tjera

Në përmbushjen e objektivave dhe vizionit të planit, përcaktohen si projekte kyçe ato që lidhen ngushtë me projektet e tjera strategjike, për shkak të ndikimit të gjerë që kanë. Në këtë kuadër, vlerësimi pozitiv i projekteve që kanë ndikim në projektet e tjera përbën një kriter të rëndësishëm në prioritizimin e projekteve.

Ndikimi i projektit në projekte të tjera	Vlerësimi
Nuk ka ndikim te projektet e tjera	1
Ka ndikim të kufizuar te projektet e tjera	2
Ka ndikim mesatar te projektet e tjera	3
Ka ndikim indirekt te projektet e tjera	4
Ka ndikim direkt te projektet e tjera	5

5.1.4 Ndikimi në flukset turistike

Flukset turistike janë faktorët kryesorë të zhvillimit të industrisë së turizmit, prandaj vlerësimi pozitiv i projekteve që mbështesin rritjen e fluksit të turistëve shfaqet si kriter kryesor për vlerësimin e prioritetit të zbatimit të projektit.

Ndikimi në flukset turistike	Vlerësimi
Nuk ka ndikim në fluksin turistik	1
Ka ndikim të papërfillshëm në fluksin turistik	2
Ka ndikim të ulët në fluksin turistik	3
Ka ndikim të mesëm në fluksin turistik	4
Ka ndikim të lartë në fluksin turistik	5

5.1.5 Kosto e investimit

Duke qenë se burimet janë të shterueshme dhe se investimet e mëdha gëzojnë efektin e ekonomisë së shkallës, për garantimin e shpërndarjes së ekuilibruar dhe të drejtë të fondeve do të vlerësohen me prioritet më të lartë projektet me kosto më të ulët.

Investimet kapitale (EUR)	Vlerësimi
>= 10.000.000 EUR	1
5.000.000 - 9.999.999 EUR	2
2.500.000 - 4.999.999 EUR	3
1.000.000 - 2.499.999 EUR	4
< 1.000.000 EUR	5

5.1.6 Efektiviteti i kostos

Duke marrë parasysh numrin e madh të projekteve, kufizimin e burimeve financiare dhe luhatjen e numrit të përfituesve të një projekti, gjykohet se duhet të zbatohen me prioritet projektet më efektive, që do të thotë ato me kosto më të ulët për përfitues ose për njësi.

Efektiviteti kosto: EUR / përfitues ose për njësi	Vlerësimi
>= 1500	1
1000 - 1499	2
500 - 999	3
50 - 499	4
< 50	5

5.1.7 Përfituesit

Përfituesit e një projekti përbëjnë një nga kriteret kryesore në vlerësimin e prioriteteve. Për këtë arsye do të vlerësohen me prioritet ato projekte të cilat i përgjigjen një numri të lartë përfituesish.

Numri i përfituesve	Vlerësimi
< 500	1
500 - 999	2
1000 - 9999	3
10.000 - 249.000	4
>= 250.000	5

5.1.8 Mundësia për punësim në shkallë lokale
Disa projekte, si ato të ndërhyrjes në infrastrukturë, krijojnë një punësim të përkohshëm, ndërsa disa të tjera të fushës së bujqësisë ose turizmit do të krijojnë vende pune të përhershme. Punësimi i përkohshëm apo i përhershëm luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të territorit. Në këtë kontekst, do t'u jepet prioritet atyre projekteve që do të punësojnë një numër të lartë të popullsisë lokale, pavarësisht dallimeve në natyrën e punësimit, të përkohshme ose të përhershme.

Mundësia për punësim në shkallë lokale	Vlerësimi
< 250	1
250 - 499	2
500 - 749	3
750 - 999	4
>= 1000	5

5.1.9 Ndikimi i projektit në shërbime turistike të lokaliteteve

Nisur nga vizioni dhe objektivat strategjike, Alpet Shqiptare do të përbëhen nga lokalitete turistike të specializuara, në të cilat ofrohen shërbime cilësore dhe konkurruese në treg. Larmishmëria dhe cilësia e shërbimeve turistike shfaqen si faktorë të rëndësishëm në zhvillimin e ardhshëm të sektorit të turizmit në rajon. Në këtë kontekst, ndikimi territorial i një projekti ose një ndërhyrjeje, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e produktit dhe shërbimeve që ofrohen në lokalitete turistike. Pra, u jepet prioritet projekteve që kanë ndikim në rritjen e cilësisë dhe numrit të shërbimeve në lokalitetet turistike, për shkak se ndikojnë pozitivisht në përmirësimin e produktit turistik të lokaliteteve.

Shërbime në lokalitetet turistike	Vlerësimi
Nuk ndikon në shërbimet turistike të lokaliteteve	1
Ndikon pjesërisht në shërbimet turistike të lokaliteteve	3
Ndikon plotësisht në shërbimet turistike të lokaliteteve	5

5.1.10 Ndikimi i ndërhyrjes sipas nivelit të lokalitetit.

Duke marrë parasysh nevojën e orientimit të flukseve turistike, konsiderohen prioritare projektet me ndikim të lartë në lokalitetet e nivelit të parë.

Ndikimi në lokalitete sipas nivelit	Vlerësimi
Nuk ndikon në lokalitete	1
Ndikon në lokalitet e nivelit IV	2
Ndikon në lokalitet e nivelit III	3
Ndikon në lokalitet e nivelit I dhe II	4
Ndikon në lokalitet e nivelit I	5

5.1.11 Përcaktimi i prioritetit të një projekti

Të gjitha ndërhyrjet ose projektet do të vlerësohen nga 10 kriteret e sipërpërmendura. Vlerësimi nga 1 deri në 5 për çdo kriter të projektit është bazuar në vlerësimin e ekspertëve.

Kriteret e vlerësimit (k_i) dhe vlerësimi i ekspertëve (nga 1 në 5), çon në vlerësimin e shkallës së prioritetit të projektit.

$$\text{Shkalla e prioritetit} = 1/n \sum_{i=1}^n k_i$$

Identifikimi i shkallës së prioritetit mundëson renditjen e secilit nga projektet sipas peshës që ka në realizimin e objektivave dhe vizionit strategjik. Duke qenë se PKST-Alpe parashikon zhvillimin e sektorit të turizmit për 15 vitet e ardhshme, grupimi i ndërhyrjeve në funksion të fazës së zbatimit lehtëson leximin dhe buxhetimin e projekteve. Për këtë arsye, zbatimi i projekteve të ndryshme do të ndahet në tre faza:

- Faza e zbatimit afatshkurtër (2017-2022)
- Faza e zbatimit afatmesëm (2022-2027)
- Faza e zbatimit afatgjatë (2027-2031)

Grupimi i projekteve në faza të ndryshme zbatimi bazohet në renditjen e shkallës së prioritetit. Në këtë mënyrë, efektet e zbatimit të projekteve do të jenë më koherente.

5.2

FAZAT E ZBATIMIT TË PROJEKTEVE PRIORITARE & KOSTOT E TYRE

OBJEKTIVAT	PROGRAMET	PROGRAME / PROJEKTET	KODI	AUTORITETET PERGJEGJESE	BURIMET E MUNDSHME TE FINANCIMIT	KOSTO	FAZAT E ZBATIMIT		
							2017- 2022	2022- 2027	2027- 2031
OS1	OS1P1	Zhvillimi i turizmit duke respektuar Planet e Menaxhimit te Parqeve Kombëtare dhe Rajonale (projekte sipas Planeve të Menaxhimit)	OS1P1P1	Ministria e linjës për Mjedisin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	-			
		Orientim drejt një turizmi edukativ, shkencor lidhur me njohjen e florës dhe faunës lokale	OS1P1P2	Ministria e linjës për Mjedisin. Ministria e linjës për Arsimin. Bashkitë.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	-			
		Identifikim i aksesit në zonat e mbrojtura dhe informim i turistëve për rregullat përkatëse (panelet informuese, minikurse, etj.)	OS1P1P3	Ministria e linjës për Mjedisin. Bashkitë.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	-			
	OS1P2	Forcimi i identitetit urban dhe arkitektonik të lokaliteteve si	OS1P2P1	Ministria e linjës për Zhvillimin Urban. Ministria e linjës për Ekonominë. Ministria e linjës për Kulturën.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	-			

OS1 EKULIBËR MIDIS NATYRËS DHE ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

<p>nxitës të zhvillimit të turizmit</p>	<p>Nxitja e transformimit të godinave me arkitekturë tradicionale në struktura të hapura për publikun (muze, bar-restorant, objekte tregtare, bujtina, etj.)</p>	<p>OS1P2PR2</p>	<p>Ministria e linjës për Zhvillimin urban. Ministria e linjës për Ekonominë. Ministria e linjës për kulturën. Bashkitë</p>	<p>Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare</p>	<p>-</p>		
		<p>Restaurimi i Banesës së Mehmet Ramës</p>	<p>OS1P2PR3</p>	<p>Ministria e linjës për Kulturën, Bashkitë</p>	<p>Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat</p>	<p>25,000</p>	
		<p>Restaurimi i Mullirit të Bajram Currit</p>	<p>OS1P2PR4</p>	<p>Ministria e linjës për Kulturën, Bashkitë</p>	<p>Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat</p>	<p>9,500</p>	
		<p>Restaurimi i Banesës të Shkurte Aliës</p>	<p>OS1P2PR5</p>	<p>Ministria e linjës për Kulturën, Bashkitë</p>	<p>Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat</p>	<p>38,000</p>	
		<p>Restaurimi i Banesës të Lulash Kecit</p>	<p>OS1P2PR6</p>	<p>Ministria e linjës për Kulturën, Bashkitë</p>	<p>Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat</p>	<p>7,000</p>	
		<p>Restaurimi i Kullës e Thepit</p>	<p>OS1P2PR7</p>	<p>Ministria e linjës për Kulturën, Bashkitë</p>	<p>Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat</p>	<p>11,000</p>	
		<p>Restaurimi i Kalasë së Lekës</p>	<p>OS1P2PR8</p>	<p>Ministria e linjës për Kulturën, Bashkitë</p>	<p>Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat</p>	<p>27,000</p>	
		<p>Restaurimi i Kalasë së Shoshanit</p>	<p>OS1P2PR9</p>	<p>Ministria e linjës për Kulturën, Bashkitë</p>	<p>Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat</p>	<p>23,000</p>	

OS1 EKUILIBËR MIDIS NATYRËS DHE ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

			Restaurimi i Qytezës së Rosujës	OS1P2PR10	Ministria e linjës për Kulturën, Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	25,000			
		Mbështetje në sistemimet dhe rinovimet e banesave që transformohen në bujtina apo në shërbime, me qëllim ruajtjen e karakteristikave të arkitekturës vernakolare (çati, fasada, gardhe, oborret, etj), nëpërmjet granteve në mbulimin e një pjesë të kostos së investimit.		OS1P2PR11	Ministria e linjës për Zhvillimin Urban. Ministria e linjës për Ekonominë. Ministria e linjës për Kulturën. Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	1,500,000			
	Monitorimi i pasurimit të hapësirave komunitare (sheshe, fusha sporti, etj.) të identifikuar për t'u përdorur në funksion të turizmit rekreativ dhe sportiv, me shërbime infrastrukture dhe arredim urban si përgjigje e kërkesës së turizmit rekreativ (aktivitete të përcaktuara në këtë plan)	Rikualifikim i qendrës rurale Vermosh	OS1P2PR12	Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	150,000				
Rikualifikim i qendrës rurale Lëpushë		OS1P2PR13	Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	187,500					
Rikualifikim i qendrës rurale Bogë		OS1P2PR14	Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	112,500					
Rikualifikim i qendrës rurale Theth		OS1P2PR15	Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	187,500					
Rikualifikim i qendrës rurale Valbonë		OS1P2PR16	Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	225,000					
Rikualifikim i qendrës rurale Curraj I Epërm		OS1P2PR17	Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	112,500					

OS1 EKUILIBËR MIDIS NATYRËS DHE ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

OSIP3

Strukturimi i itinerareve turistike

Krijimi i aksesit në lokalitetet turistike nëpërmjet transportit publik duke reduktuar varësinë nga mjetet e motorizuara private.

Rikualifikim i qendrës rurale Koman	OSIP2PR18	Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	150,000		
Rikualifikim i qendrës rurale Reç	OSIP2PR19	Bashkitë	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	112,500		
Krijimi i terminalit multimodal Bajram Curri	OSIP3PR1	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	300,000		
Krijimi i terminalit multimodal Kopluk	OSIP3PR2	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	300,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Valbonë	OSIP3PR3	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	200,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Lekbibaj	OSIP3PR4	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Tropojë e Vjetër	OSIP3PR5	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Bogë	OSIP3PR6	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Dragobi	OSIP3PR7	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		

OS1 EKUILIBËR MIDIS NATYRËS DHE ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Lëpushë	OS1P3PR8	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Nikc	OS1P3PR9	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Razëm	OS1P3PR10	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Tamarë	OS1P3PR11	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Curraj I Epërm	OS1P3PR12	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Vukël	OS1P3PR13	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Vermosh	OS1P3PR14	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		
Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Reç	OS1P3PR15	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000		

OS1 EKVILIBËR MIDIS NATYRËS DHE ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

	Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Kir	OS1P3PR16	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000			
	Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Ndërlytaj	OS1P3PR17	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000			
	Krijimi i stacionit të transportit publik dhe turistik Theth	OS1P3PR18	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare, aktor privat	100,000			
Plotësim i segmenteve të munguara të itinerareve me infrastrukturën e mobilitetit (rrugë, xhepa, parkime, vepra arti, etj.)	Rehabilitimi i rrugës SH25 Vau Dejës – Koman – Liqeni i Komanit	OS1P3PR19	Bashkitë. Ministria e linjës për Transportin.	Qeveria Qendrore, Bashkitë, Organizata jo qeveritare	9,100,000			
Skuadra e kërkim-shpëtimit mund të jetë pjesë e organikës së bashkisë, duke bërë efektive parashikimet ligjore të mësipërme dhe duke marrë parasysh që shërbimi zjarrfikës është decentralizuar duke kaluar në varësi bashkive përkatëse sipas Ligjit të ri nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Këto ndryshime ligjore kanë synuar rritjen e efektivitetit të këtij shërbimi në mbrojtje të jetës njerëzore, pronës dhe mjedisit.

Duke qenë se një sërë shërbimesh për qytetarët janë decentralizuar në nivelin më pranë tyre (bashki), dhe me synim rritjen e cilësisë dhe shkurtimeve të kohës së marrjes së shërbimit, propozohet që kjo strukturë të jetë në nivel bashkie, duke bërë të mundur edhe lehtësimin e plotësimit me staf të kualifikuar për ofrimin e shërbimit të kërkim-shpëtimit.

5.5

KOSTOT & FINANCAT E NEVOJSHME PËR ZBATIM

Zbatimi i Planit Kombëtar Sektorial të Turizmit për Rajonin e Alpeve ka nevojë për burime financiare të konsiderueshme. Teorikisht të gjithë instrumentet financiare me kombinimet e tyre mund të përdoren për të financuar projektet prioritare për zonën e alpeve.

Burimet e financimit

Ky dimension paraqet burimet e mundshme të financimit për projektet prioritare. Kategoritë janë si më poshtë:

Buxheti i Shtetit, i përcaktuar sipas ligjit të buxhetit vjetor

Shpenzimet kapitale të Programit të Zhvillimit të Turizmit mund të integrohen në Buxhetin e Shtetit dhe të ministrive të linjës që kanë lidhje me natyrën e projektit.

Duke qenë se zhvillimi i sektorit të turizmit ka nevojë për ndërhyrje shumëdimensionale në aspekte të ndryshme si infrastruktura, sektori bujqësor, transporti etj., financimi projekteve të ndryshme duhet të bëhet falë një koordinimi mes ministrive të ndryshme ose përmes një zëri specifik për zbatimin e Programit të Zhvillimit të Turizmit për Alpet Shqiptare.

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Në këtë mënyrë, siguron zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial për të pasur rajone me zhvillim të ekuilibruar, konkurrues dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Për vitin 2017, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 3 shtylla:

Shtylla I: Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendorë dhe Rajonale

Zhvillimi i infrastrukturës vendorë dhe rajonale përbëhet nga 6 grantet e mëposhtme:

- a) Granti për infrastrukturën vendorë dhe rajonale me burim financimi programin "Infrastruktura vendorë dhe rajonale" pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban;

- b) Grantet për arsimin me burim financimi programet e mëposhtme buxhetore të Ministrisë së Arsimit:

- i. Granti për arsimin bazë, me burim financimi programin e buxhetit "Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)";
- ii. Granti për arsimin e mesëm, me burim financimi programin e buxhetit "Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)";
- iii. Granti për arsimin universitar, me burim financimi programin e buxhetit "Arsimi universitar";
- iv. Granti për sportin, me burim financimi programin e buxhetit "Mbështetje për sportin".

- c) Granti për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor) me burim financimi programin e buxhetit "Shërbimet e kujdesit parësor" të Ministrisë së Shëndetësisë;

- d) Granti për artin dhe kulturën me burim financimi programin e buxhetit "Arti dhe kultura" të Ministrisë së Kulturës;

- e) Granti për ujësjellës-kanalizime me burim financimi programin e buxhetit "Furnizimi me ujë dhe kanalizime" të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe granti konkurrues për infrastrukturën vendorë dhe rajonale;

- f) Granti konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim me burim financimi programin e buxhetit "Administrimi i pyjeve" të Ministrisë së Mjedisit.

Shtylla II: Programi "Shqipëria dixhitale" (inovacioni dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit)

Fondi për programin "Shqipëria dixhitale" përbëhet nga granti konkurrues për inovacionin dhe teknologjinë e komunikimit, me burim financimi programin "Infrastruktura vendorë dhe rajonale" pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban.

Shtylla III: Programi i mbështetjes për ekonominë Fondi për programin “Mbështetje për ekonominë” ka burim financimi programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale” pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban, dhe përbëhet nga grantet:

- a) Granti “Nënprogrami i pjesëmarrjes shtetërore me instrumente të financimit dhe forma partneriteti në shoqëri tregtare” dhe
- b) Granti “Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të)”.

Bazuar në shtyllat e lartpërmendura, grantet dhe orientimet e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve mund të përbëjnë një burim financimi të konsiderueshëm në zbatimin e projekteve të identifikuar nga PKST-Alpe.

Agjencia e Zhvillimit të Rajoneve (AZHR)

AKZHR-ja, AZHR-të dhe AZHER-ja kanë misionin e promovimit të një politike të përbashkët investimesh të integruara për zhvillimin e rajoneve e potencialeve të tyre, nxitjes së një modeli sa më të gjerë bashkëpunimi, krijimit të partneriteteve publike-private me interes të përbashkët zhvillimi, krijimin e rrjetëzimeve rajonale dhe ndër-rajonale, uljen e hendekut mes zonave të zhvilluara dhe të pazhvilluara, si dhe zbatimin e projekteve publike e private.

Agjencitë i kryejnë veprimtaritë e tyre në rolin e një institucioni ekspert për zbatimin dhe arritjen e objektivave për politikën e zhvillimit rajonal, si dhe kontribuojnë për harmonizimin dhe integrimin e faktorëve ekonomikë, socialë dhe ambientale për zhvillimin e ekuilibruar të të gjitha rajoneve të Shqipërisë.

Agjencitë financohen nga:

1. kontributi i Buxhetit të Shtetit;
2. të ardhurat vetjake nga mjete dhe/ose burime të tjera financiare nëpërmjet:
 - a. kontributit nga programe të ndihmës së huaj, sipas marrëveshjeve me partnerët e huaj për zhvillim dhe integrim;
 - b. kostove të menaxhimit për programe apo projekte që ata zhvillojnë, me disa përfitues.
3. burime të tjera të ligjshme si donacione etj.

Për realizimin e misionit të përcaktuar në këtë vendim, Agjencitë për Zhvillim Rajonal nr. 1, 2, 3 e 4, dhe konkretisht AZHR nr. 1 që mbulon zonën e alpeve me seli në Shkodër, kryejnë këto detyra:

- a) Hartojnë programet operacionale të zonës përkatëse të zhvillimit rajonal;
- b) Bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore në përgatitjen dhe zbatimin e planeve të zhvillimit lokal, në përputhje me planet e zhvillimit rajonal dhe për krijimin e partneriteteve vendore, ndër-vendore, rajonale e ndër-rajonale;
- c) Përfaqësojnë interesat e zhvillimit të zonës përkatëse të zhvillimit rajonal në marrëdhënie me Agjencinë Kombëtare për Zhvillimin Rajonal ose me palë të tjera të përfshira;
- d) Përgatisin dhe zbatojnë programe dhe projekte konkrete të zhvillimit rajonal e territorial të zonës përkatëse, duke kontribuar në zbatimin e politikës së kohezionit dhe zhvillimit rajonal, dhe duke nxitur, mbështetur dhe/ose marrë vetë pjesë në forma të ndryshme të partneritetit rajonal;
- e) Zhvillojnë programe që mbështesin hartimin e projekteve rajonale me disa përfitues dhe nxisin e mbështesin krijimin e partneriteteve rajonale;
- f) Ngrenë dhe menaxhojnë sistemin informativ për projektet rajonale e lokale të zhvillimit që zbatohen në zonën përkatëse të zhvillimit rajonal, si dhe kontribuojnë me informacion dhe të dhëna pranë AKZHR-së në sistemin informativ rajonal në nivel kombëtar;
- g) Kryejnë detyra të tjera në pajtim me aktet ligjore e nënligjore dhe rregullat e miratuara nga AZHR-ja.

Investimet në nivel vendor (bashkitë)

Bashkitë duhet të bazohet në Planin Kombëtar Sektorial dhe në Planet e Përgjithshme Vendore për përcaktimin dhe përgatitjen e planeve të investimeve për vitet e ardhshme. Në këtë kontekst, disa projekte me ndikim në nivel bashkiak mund të integrohen në buxhetin e bashkisë si transferta e kushtëzuar, ose mund të financohen nga të ardhura dhe transferta të pakushtëzuara.

Buxheti i qeverisë vendore:

- Fondet e investimeve në buxhetin e bashkive.
- Transferta e pakushtëzuar është një fond i caktuar që i jepet pushtetit vendor nga Buxheti i Shtetit me qëllim kryerjen dhe përballimin e funksioneve dhe veprimtarive të tij. Së bashku me të ardhurat nga taksat që administrohen dhe mbledhen nga pushteti

lokal, ato përbëjnë burimin kryesor të financimit të buxhetit lokal.

Integrimi i projekteve në buxhetin afatmesëm dhe financimi falë të ardhurave të bashkisë dhe transfertës së pakushtëzuar, përben një burim të rëndësishëm financimi në shkallë lokale.

Fondet IPA II 2014-2020

IPA II përcakton një kuadër të ri për sigurimin e asistencës së para-aderimit për periudhën 2014-2020. Risia më e rëndësishme e IPA II është fokusi i saj strategjik.

IPA II synon reformat brenda kuadrit të sektorëve të përcaktuar. Këta sektorë mbulojnë fushat e lidhura ngushtë me strategjinë e zgjerimit, siç janë demokracia dhe qeverisja, zhvillimi dhe konkurrenca. Kjo qasje promovon reforma strukturore që do të ndihmojnë në transformimin e një sektori të caktuar dhe në arritjen e standardeve të BE-së.

IPA II gjithashtu lejon një përdorim më sistematik të mbështetjes financiare të sektorit. Së fundi, ai i jep më shumë peshë matjes së performancës.

Fondi total i caktuar për Shqipërinë për periudhën 2014-2020 është 649,4 milionë euro.

Sektorët prioritarë për financim gjatë kësaj periudhë janë:

- Demokracia dhe qeverisja: forcimi i institucioneve demokratike, reformimi i shërbimit civil dhe ofrimi i shërbimeve publike, qeverisja më e mirë ekonomike, përmirësimi i menaxhimit financiar publik, fuqizimi i shoqërisë civile (p.sh. organizatat joshtetërore, vullnetare, etj.);
- Ligjet dhe të drejtat themelore: sistemi gjyqësor i pavarur dhe efikas, ndihma për policinë në luftën kundër krimit të organizuar dhe lufta kundër korrupsionit duke respektuar konventat e të drejtave të njeriut;
- Veprimi i mjedisit dhe klimës: përshtatja me ligjin dhe standardet e BE-së, trajtimi më i mirë i mbeturinave e ujit dhe kontrolli i ndotjes së ajrit;
- Transporti: përmirësimi i infrastrukturës dhe lidhjes rajonale, rritja e sigurisë rrugore, rritja e ndërveprimit (përputhshmëria teknike ndërkufitare);
- Konkurrueshmëria dhe inovacioni: mbështetja e konkurrencës së biznesit, integrimi më i madh i tregut, përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe zhvillimi i turizmit;
- Arsimi, punësimi dhe politikat sociale: sig-

urimi i një trajnimi efektiv individual, përmirësimi i shërbimeve të punësimit dhe politikave të tregut të punës, përfshirja e personave në nevojë dhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore e sociale;

- Bujqësia dhe zhvillimi rural: rritja e konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor dhe ushqimor, rritja e standardeve të sigurisë ushqimore dhe rritja e cilësisë së jetës në zonat rurale;
- Bashkëpunimi rajonal dhe territorial: promovimi i rrjeteve rajonale, marrëdhëniet e mira ndërkufitare dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm lokal në zonat kufitare.

Fonde nga donatorët e huaj

Grantet ndërkombëtare për financimin e projekteve prioritare:

- U jepen subjekteve publike ose investitorëve privatë nëpërmjet një kërkesë bashkëfinancimi (ose bashkëfinancim për investimet private) pa ripagim ose ndarje të fitimit.
- Bashkëfinancimi u ofrohet subjekteve publike ose investitorëve privatë me kërkesë për ripagim apo ndarje të fitimit.

Nëse përfituesi është një investitor privat, ky i fundit do të jetë pronari i pasurisë së krijuar, dhe publiku (ofruesi i bashkëfinancimit) nuk do të ketë ndikim në menaxhimin e asetit dhe nuk do të ketë asnjë risk nga ai.

Aktualisht në Shqipëri operon Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), e cila është agjenci bashkëpunimi ndërkombëtare e Zvicrës në kuadër të Departamentit Federal të Punëve të Jashtme (FDFA). SDC-ja është përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të aktiviteteve zhvillimore dhe bashkëpunimit me Evropën Lindore, si dhe për ndihmën humanitare të parashikuar nga konfederata zvicerane.

Qëllimi i këtij bashkëpunimi është ulja e varfërisë. Ai është konceptuar kryesisht për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe mbështetjen e autonomisë së shteteve, për të përmirësuar kushtet e prodhimit, për të gjetur zgjidhje për problemet e mjedisit dhe për të siguruar qasje më të mirë në arsim dhe shërbimet themelore të kujdesit shëndetësor. Qeveria e Zvicrës investon rreth 200 milionë franga në vit për të luftuar varfërinë dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendeve në zhvillim dhe vendeve të Lindjes.

Skemat e lidhura me huatë

Këto skema bazohen në faktin se investitorët privatë, veçanërisht SME-të, kanë vështirësi për të hyrë në financim nga tregu për shkak të normave të interesit tepër të larta për ta ose për shkak të rrezikut të lartë të financimit sipas kushteve standarde të biznesit.

Zgjidhja mund të jetë:

- ulja e kostos së financimit duke siguruar subvencione për interesin e pagueshëm;
- kreditë e ofruara nga donatorë të huaj me tarifa preferenciale;
- ulja e rrezikut për ofruesin e kredisë duke ofruar garanci të plotë ose të pjesshme për shlyerjen e huasë (garancia e pjesshme mund të ndahet me të tjerët).

Skemat "Joint venture"

Qëllimi i këtyre skemave është sigurimi i bashkë-financimit dhe shkëmbimit për biznese të sapoformuara apo të vazhdueshme, të cilët për shkak të mungesës së kapitalit nuk mund të krijoheshin ose nuk mund të përdornin potencialin në rritje pa pjesëmarrjen e publikut.

Këto skema kërkojnë investime "upfront". Në varësi të rrezikut të marrë përsipër, ky konsiderohet si operacion i kapitalit sipërmarrës.

Skemat e Partneritetit Publik-Privat (PPP)

Disa investime që ofrojnë shërbime publike (rrugë, shkolla, aeroporte etj.) financohen dhe menaxhohen nga investitorët privatë, të cilët më vonë ia ofrojnë shërbimin direkt publikut ose bashkisë / qeverisë kundrejt pagesës. Tarifa duhet të mbulojë si shpenzimet e investimit ashtu edhe kostot operacionale. Në varësi të marrëveshjes dhe natyrës së investimit, pagesa duhet të bëhet nga përdoruesit e fundit ose nga bashkia / qeveria.

Skemat e PPP mundësojnë që bashkia / qeveria të ndërtojë diçka që i nevojitet popullsisë më herët sesa në rast përdorimi të fondeve publike, por nga ana tjetër ato krijojnë detyrime financiare afatgjata me rrisje të mëdha.

Fondi Kombëtar i Garancisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

Në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare dhe BERZH-in, instrumenti i ri i financimit "Fondi Kombëtar i Garancisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural" do të adresojë mungesën e kolateralit si problem kreditimi tek fermerët, si dhe do të stimulojë bankat që të rrisin aktivitetet e tyre kredituese në bujqësi, në mënyrë që të zhbllokojë sektorin që ka rëndësi të lartë për ekonominë.

Qëllimi kryesor i Instrumentit të Financimit të Agrobiznesit nga BERZH, projekt që do të përfitojë nga Fondi Kombëtar i Garancisë, është të zhbllokojë financimin e agrobiznesit duke e ndarë riskun mes tre palëve:

- (1) bankave të nivelit të dytë ose institucioneve të mikrofinancës;
- (2) qeverisë shqiptare përmes Fondit Kombëtar të Garancisë dhe
- (3) BERZH-it.

Ideja është që qeveria shqiptare të sigurojë një shumë të caktuar nga buxheti i saj si garanci, siç quhet ndryshe fond garancie, që mbulon humbjet e para të kredisë apo portofolit të kredive. Kjo bëhet në mënyrë që të mbrohet portofoli i kredive të agrobiznesit nga humbjet që mund të ndodhin. Përveç kësaj, BERZH-i do të sigurojë një garanci shtesë për të ndarë riskun e portofolit të kredisë së agrobiznesit me bankat apo institucionet e mikrofinancës. Kjo skemë i siguron mbrojtje institucioneve financiare duke i bërë të ndihën më të sigurta, dhe i inkurajon ato për të rritur kreditimin e këtij sektori që ka rëndësi të lartë për ekonominë. Duke e ndarë rrezikun me BERZH-in, institucionet financiare mund të sigurojnë edhe lehtësim të kapitalit, një benefit ekstra i cili pritët t'u mundësojë atyre rritjen e kreditimit. Gjithashtu, në kuadër të garantimit të ndarjes së riskut, BERZH do të sigurojë fonde për bankat apo institucionet financiare që kanë nevojë për fonde për të kredituar sektorin e agrobiznesit.

Zhvillimi i aseteve

Kjo është një mënyrë gjithëpërfshirëse për lloje të ndryshme të bashkëpunimit me sektorin privat. Me shfrytëzimin e fondeve publike, zhvillohen ose transferohen disa asete ekzistuese (p.sh. struktura akomoduese, biznese të vogla apo fill-estare etj.) për t'i ardhur në ndihmë zhvillimit të bizneseve të panjohura. Në një formë tjetër, zhvillimet e caktuara infrastrukturore (lidhjet rrugore, furnizimi me ujë etj.) financohen bazuar në një marrëveshje nga publiku për të mbështetur një investim privat të veçantë.

Në këto raste, shpenzimi publik (që duhet të bëhet përpara) është një investim i kryer nga publiku, ku zakonisht edhe biznesi merr përsipër një risk të konsiderueshëm (ky është një nga dallimet e rëndësishme nga PPP).

Të ardhurat nga taksat

Taksat luajnë një rol të rëndësishëm në kanalizimin e të ardhurave nga zonat dhe trashëgimia kulturore. Edhe pse taksat në vendet historike dhe kulturore nuk janë një formë direkte e financimit, ato mundësojnë një gjenerim më të mirë të ardhurash nga operacionet që mund të ri-investohen në këto zona. Ato shfaqen shpesh si kredi tatimore për pronarët ose për qiramarrësit e objekteve kulturore.

Grantet qeveritare

Grantet qeveritare mund të shërbejnë si një katalizatorë për investimet private. Disa nga format e granteve qeveritare përfshijnë:

- Çmimet dhe dhurimet: Përveç shumës së drejt-përdrejtë të investuar, çmimet dhe dhurimet shërbejnë edhe si sinjal për projektet me cilësi të lartë dhe përmirësojnë aftësinë për të tërhequr investitorë të tjerë publikë dhe privatë.
- Skemat matching (plotësuese): Këto lidhen me grantet qeveritare të cilat shërbejnë si plotësuese për çdo shumë të investuar nga financues publikë apo privatë.

Çmimet dhe shpërblimet

Qeveritë dhe institucionet e tjera publike mund të mbështesin financimin e projekteve nëpërmjet çmimeve dhe shpërblimeve, të cilat mund të nxisin investitorët për mbështetje të mëtejshme. Këto janë të ngjashme me grantet, por operojnë në shkallë më të madhe dhe u japin më shumë mbështetje investitorëve sesa qeverive. Një mekanizëm i tillë financimi mund të synojë një qytet të veçantë ose monument për një periudhë të caktuar kohe (p.sh. çdo vit), dhe të shpenzojë disa nga fondet e mbledhura për turizëm për nevojat kulturore të qytetit dhe për promovimin e aktiviteteve. Këto mund të synojnë:

- Mbështetjen e mëtejshme të financimit nga investitorët e tjerë privatë dhe publikë;
- Tërheqjen e sa më shumë vizitorëve në faqen e caktuar të internetit apo qytetin i cili do të gjenerojë të ardhura të mëtejshme.

Investitorët e vegjël privatë

Një shembull i tipit të investitorëve të vegjël si subjekt financiar tregtar janë edhe angel investors (investitorët "engjell"). Në terma të përgjithshme, ata zakonisht ofrojnë mbështetje financiare për sipërmarrësit e vegjël. Kapitali "engjell" ofrohet përgjithësisht nga ana e investitorit në pikënisjen e biznesit dhe shërben si kapital bazë (Investopedia, 2016). Investitorët "engjell" operojnë në rrjete në mënyrë që të kenë ndikim më të madh dhe të fitojnë projekte potenciale.

Në kuadër të investimeve turistike dhe kulturore, këta investitorë nuk janë shumë të zakonshëm në shpërndarjen e të mirave dhe shërbimeve. Këto të mira dhe shërbime zakonisht ofrohen nga projektet publike ose gjysmë-publike, ndërsa investitorët "engjell" udhëhiqen nga normat e kthimit të investimeve. Megjithatë, ka raste kur financimi nëpërmjet investitorëve të tillë mund të jetë një alternativë; gjithsesi financimi do të jetë në një shkallë të vogël, siç është ilustruar në hapësirën informuese më poshtë.

Nën-kontraktimi i kompanive private (outsourcing)

Qeveritë e vendeve me ekonomi në zhvillim po ua besojnë gjithnjë e më shumë ofrimin e shërbimeve dhe infrastrukturës firmave të sektorit privat. Kontraktimi është një nga metodat më të përdorura nga qeveritë për të nxitur pjesëmarrjen më të lartë të sektorit privat në ofrimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës. Kontraktimi për infrastrukturë dhe shërbime i lejon qeverisë që përmes kompanive private të ofrojë shërbime ose objekte që plotësojnë specifikimet e vendosura nga qeveria. Në përgjithësi, qeveritë lidhin marrëveshje me organizatat private për të ofruar një shërbim përmes tre mekanizmave: marrëveshjet e shërbimit, menaxhimit dhe leasing-ut.

Marrëveshjet për ndërtim-operim-transferim

Qeveritë në mbarë botën përdorin projekte me konsorciume me kompani private për ndërtimin e infrastrukturës rrugore, telekomunikacionit, aeroportit, shërbimeve dhe ndërtimin e ujësjellës-kanalizimeve. Qeveritë në vendet me ekonomi në zhvillim përdorin marrëveshjet për ndërtim-operim-transferim, përmes së cilave ata blejnë ose japin me qira objektet e përfunduara, të ndërtuara nga investitorë privatë. Në këtë mënyrë, kompanitë nxjerrin investimin e tyre duke përdorur objektet për një periudhë të caktuar kohore në bazë marrëveshjeje.

Investimet publike pasive

Qeveritë përdorin investime publike pasive kur përdorin grante, investime të kapitalit, kredi ose garanci për të nxitur organizatat e sektorit privat që të marrin pjesë në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve, ose në ndërtimin e infrastrukturave që konsiderohen të jenë në interes të publikut. Agjencitë qeveritare mund të ofrojnë garanci ose stimuj fiskalë për të nxitur organizatat private që të sigurojnë infrastrukturë dhe shërbime që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, si dhe ofrojnë hua ose subvencione për individë ose grupe për blerjen e shërbimeve dhe pajisjeve apo sigurimin e strehimit nga sektori privat.

Delegimi i përgjegjësisë për shërbimet ose infrastrukturën në sektorin privat

Qeveritë në disa vende po rrisin pjesëmarrjen e sektorit privat duke u deleguar përgjegjësi për disa shërbime dhe infrastruktura organizatave jo-qeveritare ose ndërmarrjeve private. Kjo realizohet përmes kërkesave rregullatore, duke përdorur objekte tregtare dhe duke kërkuar nga zhvilluesit të ofrojnë ose të mbështesin financiarisht shërbimet dhe infrastrukturën që lidhen me projekte ndërtimi rezidenciale, komerciale ose industriale.



06

**PËRFSHIRJA E PALËVE
TË INTERESUARA &
TAKIMET ME PUBLIKUN**

Gjatë fazave të këtij projekti janë organizuar disa takime me publikun me qëllim finalizimin e dokumentit përfundimtar, ku mund të përmendim forumin e dytë të bashkërendimit dhe dëgjesat publike.

Përmbajtjet e këtyre takimeve vijojnë si më poshtë:

Në datë 04.07.2017, ora 10:30-14:00, u zhvillua takimi i dytë i FBPO-së në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar Sektorial të Turizmit për rajonin e alpeve. Qëllimi i organizimit të këtij forumi ishte bashkërendimi i rregullores së PKST-Alpe dhe planit të zhvillimit me anëtarët e forumit, për të mbledhur dhe reflektuar më tej sugjerimet e tyre. Gjatë këtij forumi, përveç prezantimit të rregullores së PKST-Alpe, u prezantua në mënyrë të përgjithshme edhe raporti paraprak i vlerësimit strategjik mjedisor. Pjesëmarrës ishin rreth 50 persona nga niveli vendor dhe qendror, përkatësisht:

- Stafi i AKPT;
- Përfaqësues të FSHZH;
- Përfaqësues të DLDP;
- Përfaqësues të studios B&L;
- Përfaqësues të bashkisë Malësi e Madhe;
- Përfaqësues të studios ATELIER 4;
- Përfaqësues të bashkisë Vau i Dejës;
- Përfaqësues të studios UTS-01;
- Përfaqësues të qarqeve dhe bashkive kufitare;
- Përfaqësues të konsorciumit drejtuar nga IP3;
- Përfaqësues nga ministritë dhe agjencitë (Ministria e Mjedisit, MEI, MZHETTS, MB-ZHRAU, MZHU, MTI, Shoqata Shqiptare e Turizmit, Qendra "Alpe", GIZ, AdZM Shkodër, AdZM Kukës, Aleanca Alpet Shqiptare, Agjencia për Zhvillim Rajonal.

Në vijim pati dy prezantime nga ekspertët e IP3, Znj. Ariela Kushi dhe Z. Endri Noçka, për prezantimin e planit të zhvillimit dhe rregullores, si dhe Z. Abdulla Diku për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor.

Forumit ishte i ndarë në dy panele, ku të pranishmëve iu krijua mundësia për sugjerime dhe komente.

Rekomandimet e mëtejshme të paneleve përfshijnë:

Paneli I

GIZ:

- Pasaktësi e të dhënave numerike që rezultuan nga metodologjia e përdorur në raport me të dhënat aktuale. A janë analizuar projeksionet për secilin nga trendet e zhvillimit?
- Lidhur me orientimin kryesor që ka Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit, ai bie ndesh me konceptin e ndjekjes së trendeve aktuale i cili ndjek tjetër drejtim.
- Cili është numri i të punësuarve në sektorin e turizmit dhe si do të realizohet mbulimi i vendeve të reja që do të krijohen, bazuar në analizën e projeksionit të popullsisë?

IP3:

- Duhet qartësuar ndryshimi midis kapacitetit mbajtës dhe kapacitetit akomodues.
- Projeksionet e numrave të turistëve janë vlerësuar sipas metodës së Delphi-t, e cila është një metodologji që ka kryer vlerësime ekonometrike në dy faza duke analizuar trendin.
- Nisur nga statistikat e dala nga censusi, rezulton një numër popullsie e papunësuar (vendase ose jo), e cila është planifikuar të punësohet në sektorët që kanë lidhje direkte dhe indirekte me turizmin.
- Strategjia përmban projekte të orientuara drejt rritjes së standardeve të shërbimeve turistike, duke përfshirë punësimin nga vende të tjera dhe trajnimet.
- Duhet pasur parasysh që rritja e standardeve çon në uljen e numrit të shtretërve, por kjo nuk do të thotë pakësim i vizitorëve të zonës.

GIZ:

- Skema të mundshme e menaxhimit lidhur me banesat ekzistuese si dhe dëshira e banorëve për bashkëpunim dhe roli i tyre.
- Si do të bëhet menaxhimi i këtyre skemave dhe si do të restaurohen godinat ekzistuese?
- Cili është roli i bashkisë dhe ai i Bordit të Menaxhimit?

IP3:

- Llojet e strukturave akomoduese varen nga lokalitetet, për këtë arsye janë propozuar ske- ma të ndryshme restaurimi dhe menaxhimi në vende të ndryshme, p.sh. në Curraj është propozuar koncepti i zhvillimi të hotelerisë alberghi diffusi, në Valbonë është propozuar hoteleria e mirëfilltë, në Theth janë propozu- ar bujtinat, etj.

FSHZH:

- Është hedhur ideja dhe po diskutohet për kri- jimin e Bordit të Menaxhimit.
- Struktura e menaxhimit të këtij Bordi dhe qa- sjet sipas rasteve të ndryshme ku duhet të di- skutohet për kompetencat dhe menaxhimin e tij në nivel qendror apo vendor.

AKPT:

- Ku qëndron Plani Kombëtar Sektorial i Tur- izmit për zonën e alpeve në raport me Planet e Përgjithshme Vendore dhe a janë ato të për- putshme në qasje?

B&L Studio:

- Në parim janë ndjekur të njëjtat orientime. Nisur nga pikëpamja hapësinore dhe shpërnda- rja e strukturave pritëse, shqetësimi ngri- het në lidhje me orientimin e zhvillimit të këtyre strukturave në Valbonë.
- Numri i familjeve që përqafojnë idenë e tur- izmit familjar dhe mundësitë alternative për familjet që nuk janë pjesë e biznesit të tur- izmit.

IP3:

- Shpërndarja e strukturave lidhet me çështjet e segmentimit turistik, me avantazhet që ka secila zonë, dhe me trendin rritës të secilës zonë.
- Theksohet se PKST-Alpe është në një linjë me Planet e Përgjithshme Vendore që prekin territorin, dhe alternativat e mundshme do t'i referohen situatave të paraqitura.

Paneli II

AZHR 1 - MZHU - MTI - IP3 - AdZM Shkodër - Bashkia Vau i Dejës - Studio UTS01 - Qendra "Alpe" - Bashkia Pukë - MM - MEI - MBZHRAU

AdZM Shkodër:

- Lugina e Shalës u përmend shumë pak. Ajo është një zonë me potencial edhe më të madh se Thethi, si një zonë me mbi 1000 vjet his- tori. Gjithashtu, kjo luginë ka infrastrukturë rrugore dhe përpara viteve '90 ka pasur rreth

6000 banorë. Problematika kryesore për këtë zonë është ajo e pronësisë.

IP3:

- Lugina e Shalës me qendrën në Ndërlytaj është parashikuar si lokalitet i nivelit të dytë pas lokaliteteve të nivelit të parë (Kopliku dhe Bajram Curri). Kapaciteti i saj akomo- dues është menduar të jetë më i madh se Thethi.

MZHU:

- Prezantimi ishte mjaft interesant dhe duket që janë bërë përparime nga prezantimi i fun- dit. Do të ishte me vlerë të paraqiteshin edhe mënyrat e ndërlidhjes së itinerareve, pra si kalohet nga njeri itinerar në tjetrin.
- Gjithashtu, lidhja me vendet kufitare do të jepte informacion sesi aksesohen zonat nga këto shtete, përfshi dhe rrugët magjistrale.
- Duhet të merret parasysh edhe prioritarizimi i listës së projekteve.

B. Vau i Dejës:

- Në territorin e bashkisë së Vaut të Dejës gjen- den fshatra të braktisura përgjatë basenit ujqor, të cilat mund të përfshihen në projektet e rehabilitimit nga PKST-Alpe.
- Territori i bashkisë Vau i Dejës përmban edhe shumë shpella.

UTS01:

- Nëpërmjet PPV Vau i Dejës kemi propozuar lidhjen e këtyre fshatrave me anë të itinerarit ujqor Vau i Dejës - Koman.

IP3:

- Gjendja e stacioneve/moleve të ndalimit të trageteve është shumë e keqe. Rigjallërimi i tyre nga privati apo nga bashkia, duke përf- shirë disa shërbime si tualete, dushe, shitore të vogla apo edhe bare, do të përmirësonte imazhin e turizmit të alpeve dhe do të nd- ikonte pozitivisht në ekonominë lokale.

UTS01:

- A ka ndonjë kufizim nga MEI për linjën e tragetit të propozuar nga PPV Vau i Dejës?

MTI:

- Licencimi i këtyre operatorëve është kompe- tencë e Ministrisë së Transportit dhe Infra- strukturës. Propozimet vijnë nga njësitë ven- dore.
- Të riemërtohet kapitulli i infrastrukturës së

transportit në "Transport dhe mobilitet".

- Duhet eliminuar të dhënat mbi sinjalistikën/ tabelat, pasi ato vijnë standarde nga rregulloret e transportit dhe ulin nivelin e planit.
- Të trajtohet në mënyrë të plotë transporti publik, pasi turisti ka nevojë të dijë se si do të lëvizë nga një pikë në një tjetër si dhe mënyrat e transportit.
- Duhet detajuar se si bëhet lidhja e rajonit të alpeve me zonat përreth dhe si aksesohet zona: hekurudha, aeroport, porti i Shëngjinit, portet e propozuara të jahteve.
- Itineraret unazore kanë nevojë për interpretim: si lidhen mes tyre si dhe modalitetet e përdorura të lëvizjes.
- I gjithë informacioni të jetë i përqendruar vetëm për zonën e studimit.

AKPT:

- PKST-Alpe propozon zhvillimin e turizmit të HEC-eve të mëdha dhe të vogla. Si e konsideron MEI këtë propozim? A është e mundur të aksesohen këto vepra, apo ndodhen në një zonë të sigurisë së lartë?

MEI:

- HEC-et deri në 2 MW janë kryesisht pronësi private dhe aksesin në to e dikton subjekti privat, ndërkohë që në HEC-et e mëdha në dijeninë time është e ndaluar hyrja, përveç studentëve që kryejnë praktikantë mësimore.

AKPT:

- Presim rekomandime nga MEI nëse një lloj i tillë turizmi është i mundur të zhvillohet.

AZHR1:

- AZHR1 ka bërë një analizë të projekteve të ardhura nga planet vendore, por do të duhej të qartësohej sesi lidhen këto projekte me buxhetet e bashkive.
- Gjithashtu AZHR1 ka bërë disa studime pre-fizibiliteti mbi stacionet intermodale të trenit në Shkodër, Lezhë dhe Shëngjin, si dhe stacionin multimodal në Kukës.
- A ka një ndarje të projekteve në bazë të financimit? Cilat i takojnë bashkive e cilat institucioneve të tjera?

AKPT:

- Po punojmë që lista e këtyre projekteve të rakordohet me Ministrinë e Financave dhe Kryeministrinë.
- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve duhet të shohë nëse projektet e aplikuar janë në

listat e parashikuara nga PPV.

- Plani Kombëtar Sektorial (PKST) i Alpeve propozon ngritjen e një Bordi Menaxhimi që të ndjekë zbatimin e tij, dhe kjo kërkon rakordimin e një rrjeti të gjerë institucionesh.

IP3:

- PKST-Alpe propozon politika të pakësimit dhe kompostimit të mbetjeve, si dhe transferimit të pjesës së papërpunuar jashtë zonës së alpeve.
- Problem mbetet kosto e lartë e transportit të mbetjeve.
- Ndërkohë, është ndjekur politika e rajonalizimit të mbetjeve: Shkodra, Malësia e Madhe dhe Vau i Dejës përdorin landfill-in e Bushatit, kurse Tropoja e Hasi përdorin një landfill tjetër.

AKPT:

- Për menaxhimin e mbetjeve po hartohet një masterplan nga Ministria e Zhvillimit Urban.
- Ndërkohë, si mendoni se mund të nxitet kulinaria në rajonin e alpeve si një aset i kësaj zone? Si mund të replikohet modeli i "Mrizit të Zanave"?

MBZHRAU:

- MBZHRAU ka një strategji e cila duhet të merret parasysh nga grupi hartues i planit. Bashkitë duhet të nxisin zhvillimin e këtyre modeleve si dhe të bëjnë inventarin e aseteve: pyjet, kullota, toka bujqësore. Kemi një mungesë të të dhënave statistiko-re në fushën e bujqësisë nga ana e bashkive. Ministria ka projekte për mbështetjen e tyre.
- Pyetja që ngrihet është nëse do të mundet tregu lokal i prodhimeve të mbulojë kërkesën e rreth 10.000-11.000 turistëve të pritshëm?

IP3:

- Nga analizat tona, kjo zonë mund të prodhojë shumicën e vitit dhe do të duhet të marrë furnizim vetëm për muajt e dimrit. Rekomandimet që jep PKST-Alpe janë në përputhje me strategjitë e MBZHRAU.



Në 13 korrik 2017 u mbajt dëgjesa e parë publike në kuadër të Vlerësimit Strategjik Mjedisor, Planit të Zhvillimit dhe rregullores së Planit Kombëtar Sektorial të Turizmit të Alpeve Shqiptare. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i raportit para-prak të VSM, prezantimi i Planit të Zhvillimit dhe koordinimi me pjesëmarrësit e rregullores së planit, për të nxjerrë dokumentat finale të cilat do të kenë të integruara edhe komentet e sugjerimet e mbledhura nga këto takime.

Në këtë takim pati dy prezantime. Në prezantimin e parë u fol për Planin Kombëtar Sektorial në fushën e turizmit dhe rregulloren, duke analizuar rajonin dhe karakteristikat makro të rajonit. Në prezantimin e dytë u prezantua raporti para-prak i VSM. Në këtë takim shumica e pjesëmarrësve ishin aktorë lokalë, duke qenë se mendimi dhe opinion i tyre ishte në fokusin e kësaj mbledhjeje.

Prezantimet dhe puna e ekipit u prit dhe u vlerësua mjaft mirë nga të pranishmit, por nuk munguan debatet e diskutimet për dokumentet në fjalë. Me një interes shumë të madh për mbarëvajtjen e këtij procesi, u dhanë komentet e mëposhtme, një pjesë e mirë e të cilave është reflektuar në dokumentet përkatëse finale:

1. Zona e Reçit nuk është përmendur dhe nuk i është dhënë prioritet.
2. Çfarë keni planifikuar lidhur me ndërtimin e HEC-eve?
3. Duke qenë disa zona kanë mungesë furnizimi me energji elektrike (si p.sh. zona e Bradoshnicës), ku do të merret energjia për këto zona?

AZHR1

4. A parashikon ndërhyrje plani për efektet mjedisore nga proceset ekzistuese?
5. A do të shkatërrojmë ndërtimet që janë bërë ose po bëhen aktualisht?
6. Sa efektiv dhe sa i zbatueshëm do të jetë ky plan?

Shoqata "Bjeshkët e Nemuna"

7. Si do të zbatohet ky projekt?
8. Sugjerimi që Parku i Maranajt të përfshihet në territorin e studiuar të planit të zonës së alpeve.
9. Çfarë ndodh me mbrojtjen e mjedisit për banorët e zonës?
10. Si do të adresohet emigracioni?



11. Modele zhvillimi/mbrojtjeje
12. Çfarë parashikon ligji shqiptar për njerëzit që jetojnë në parqe?
13. Sa "ligj" do të bëhet ky plan?
14. Si do të zbatohet ky plan?

Aleanca e Alpeve Shqiptare (Petrit Imeraj)

15. Duhet të respektohen ligjet dhe zakonet e vendit sepse ato janë një realitet i zonës.

VIS Albania (Pier Paolo Ambrosi)

16. Nëse mungon prania njerëzore nuk ka turizëm.
17. Vlerësimi Strategjik Mjedisor duhet të lidhet me praninë njerëzore.
18. Si t'i ftojme/stimulojmë të rinjtë që të vijnë dhe të punojnë në këtë zonë?

Nga ana tjetër, banorët u shfaqën të shqetësuar për probleme më individuale, si mungesa e furnizimit me ujë dhe energjia elektrike, duke dhënë propozime të cilat nuk mund të ishin pjesë e trajtimit në këtë plan për shkak të hierarkisë së planifikimit të përcaktuar në legjislacionin shqiptar.

Në vija të përgjithshme mund të themi se ky ishte një takim shumë dinamik dhe intensiv për nga ana e diskutimeve dhe debateve që u krijuan mes të ftuarve dhe grupit të punës, çka na la të kuptonim se banorët e këtyre zonave mirëpresin dhe janë të gatshëm të kontribuojnë në çdo formë për iniciativa të tilla zhvillimi.

Pas kësaj dëgjese, u zhvillua dëgjese e dytë publike në qytetin e Bajram Currit, ku tematika e takimit si dhe përbërja e të ftuarve ishte e njëjtë me dëgjesën e parë. Edhe në këtë takim u vu re një pjesëmarrje shumë e lartë nga ana e aktorëve lokalë, e përfaqësuesve të pushtetit vendor, po edhe e medias (televizionit lokal), vëmendja e të cilëve na provoi edhe një herë rëndësinë e këtij plani për rritjen e cilësisë së jetesës së vendasve.

Komentet që dolën prej këtij takimi vijojnë si më poshtë:

1. Si parashikoni ta menaxhoni fenomenin e ndërtimit të HEC-ve që bëhet nga shteti dhe shfrytëzimin e pasurive minerare pa asnjë masë rregulluese?
2. Ndërtimi i staneve/bujtinave pa asnjë rregull sipas stilit tradicional të zonës.
3. Çfarë nënkuptohet me qëndrueshmëri sociale në plan?

4. Ka vonesë në hartimin e një plani të tillë për zonën e alpeve, gjë që ka ndikuar negativisht në zhvillimin e zonës.
5. Ka mundësi të pakta të popullsisë për ndërtimin e staneve, blegtorinë, etj. Banorët duhen ndihmuar me propozime për mbështetjen e popullsisë vendase.
6. Planifikimi i mbjelljes së bimësisë në zonën e bjeshkëve - të propozohet një pyllëzim i planifikuar.
7. Bjeshkët e Bytyçit kanë mungesë pyllëzimi dhe duhet të pyllëzohen.
8. Ka mungesë të infrastrukturës ndihmëse, transportit, energjisë, telekomunikacionit etj.
9. Rrugët automobilistike të ndërtohen brenda standardeve pa dëmtuar mjedisin.
10. Nuk është propozuar lidhja mes Rragamit-Shalës-Thethit.
11. Pjesa e Fierzës duhet të zhvillohet me infrastruktura ndihmëse.
12. Peshkimi në këto zona bëhet me dinamit, klor dhe mjete dëmtuese, çka ka dëmtuar ndjeshëm liqenin e Komanit dhe lumin e Gashit.
13. Vlerësohet e nevojshme kryerja e një propagande televizive për njohjen e planit.
14. A është planifikuar të ruhen dhe të restaurohen stanet, liqenet dhe lumenjtë?
15. Duhet të përfshihet edhe komuna Bujan - Kalaja e Rosujës dhe shumë të tjera si Kalaja e Lekës.
16. Nuk janë përmendur rrugët lokale.
17. Shtëpia e Mic Sokolit nuk është përmendur për t'u restauruar.
18. Nuk është përmendur liqeni i Ponarëve.
19. Bujani nuk është përmendur për pasuritë e tij dhe nuk është integruar në plan.
20. Kulla e "Konferencës së Bujanit" është në gjendje të keqe dhe duhet restaurim, i cili nuk është përmendur në plan.
21. Mbrojtja e Valbonës nga ndërtimi i HEC-ve është ngritur si çështje në Gjykatën Administrative.
22. Propozohet që t'u dërgohet edhe banoreve një kopje e planit.
23. Vlerësohet i rëndësishëm bashkëpunimi midis banorëve, organizatave që operojnë në zonë dhe hartuesve të këtij plani për pasqyrimin sa më të saktë të situatës aktuale në zonë.
24. Sipas Catherine Bohne (themeluese e OJQ-së "Toka"), zona e alpeve nuk është dëmtuar nga banorët e zonës pasi ata tregojnë shumë

- kujdes për natyrën, por nga personat që vijnë nga jashtë dhe kanë qëllime përfitimi.
25. Sa është përfshirë në këtë plan sistemi arsimor, nxënësit dhe mësuesit me nevojat dhe shqetësimet e tyre?
 26. Hartimi i këtij plani ka ardhur shumë vonë pasi ka 6 vjet që është propozuar një plan menaxhimi për Valbonën (Kulla e Mic Sokollit).
 27. Banorët e kësaj zone pyeten shumë pak për nevojat dhe kërkesat e tyre.
 28. Shteti duhet të bëjë një ndërhyrje me subvencionim për ushqimet tradicionale të zonës.
 29. Zona ka probleme me telefoninë.
 30. Duhet pasur bashkëpunim me projekte të tjera rajonale si "Projekti Rajonal për Mjedisin" për të përmirësuar planin e alpeve.
 31. Duhet të vlerësohen si të rëndësishme shtigjet malore.
 32. Parandalimi i dëmtimit të mjedisit që është një nga shqetësimet e banorëve vendas, dhe duhet të përfshihet tek pjesa e mjedisit.
 33. Ka mungesë përfshirjeje dhe vlerësimi të disa elementeve të kulturës tradicionale dhe vlerave kulturore si vallja e burrave e cila mbrohet nga UNESCO.
 34. Mjedi tropojan, liqenet, legjendat, traditat e zonës, lahutës, çiftelisë, kërcimeve, ritet, gojëdhënat duhen vlerësuar dhe integruar më shumë në plan.
 35. Zhvillimi i kulturës me pasuritë e tij duhet të trajtohet me kujdes në plan në mënyrë që të mos humbasë në kohë.
 36. Duhet të konsiderohet e rëndësishme ruajtja e vlerave shpirtërore.
 37. Mungesë e investimeve për pronarët e bujtinave dhe mundësi të pakta për të pritur dhe përballuar fluksin e turistëve. Duhet të propozohen subvencione për dhënien e kredive të buta.
 38. Mungesë e tregut të punës.
 39. Mungesë e plotësimit të kërkesave dhe nevojave të turistëve si pasojë e mundësive të pakta financiare.
 40. A është planifikuar korridori Mal i Zi - Çerem?
 41. A është planifikuar Rruga Vuthaj - Qafë Borë - Sulbicë?

Skema e procesit

Procesi i hartimit të planit rezultoi i suksesshëm dhe transparent, duke respektuar parimet e demokracisë dhe transparencës në planifikim. Gjatë diskutimeve janë përfshirë të gjitha grupet e interesit, duke përfshirë të gjitha ministrinë e linjës si përfaqësuese të pushtetit qendror, bashkitë e prekura nga ky plan si përfaqësuese të pushtetit vendor, banorë të zonës në studim dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që operojnë në fushën e turizmit.

Qëllimi dhe fokusi i takimeve të organizuara ka qenë shkëmbimi i informacionit duke rakorduar dokumentacionet përkatëse të institucioneve të niveleve të ndryshme dhe përfshirja e komunitetit, njohja e tyre me procesin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në këtë proces, duke reflektuar komentet e tyre në dokumentet e prodhuara nga ky plan. Duhet theksuar që një pjesë e mirë e komenteve të marra nga takimet e zhvilluara është reflektuar në në faza të ndryshme të planit. Ndërkohë ka pasur edhe komente të cilat nuk mund të trajtoheshin në këtë plan për shkak të ekzistencës së niveleve të ndryshme të planifikimit të parashikuar në legjislacionin shqiptar. Ekzistojnë plane të një niveli më të ulët si plani rajonal dhe ai vendor, të cilat kanë detyrimin ligjor të parashikojnë dhe trajtojnë komentet që nuk janë reflektuar në Planin Kombëtar Sektorial të Turizmit për rajonin e Alpeve Shqiptare.

6.1

SHËNIME DHE REFERENCA

- AKPT - Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Shkodër
- AKPT - Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Malësia e Madhe
- AKPT - Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Tropojë
- AKPT, MZHU, Atelier Albania, IABR (2015), The Metabolism of Albania
- MZHU, AKPT (2015), Plani i Përgjithshëm Kombëtar
- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (2014), Strategjia Kombëtare për Turizmin 2014-2020
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (2016), Draft-Strategjia e Zhvillimit të Turizmit 2017-2022
- Ministria e Mjedisit, INCA (2015), “Plan Menaxhimi për Parkun Kombëtar Alpet e Shqipërisë”
- EU, IPA (2014), CBC Programme Albania – Kosovo 2014 – 2020
- EU, IPA (2014), CBC Programme Albania – Montenegro 2014 – 2020
- EU, IPA (2010), “Plani i Menaxhimit për Parqet Kombëtare të Thethit & Luginës së Valbonës dhe Rezervën Strikte Natyrore të Lumit të Gashit”, Draft
- Vendbanime dhe banesa shqiptare, Thomo, P., Muka A., Zarshari F. Martini Gj (2004) Tiranë: Instituti i Kultures Popullore, Botimet TOENA
- Biodiversity and Cultural Heritage, Prokletije, Bjeshkët e Nemuna
- Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (2014), Hartat tematike, qarku Kukës dhe Shkodër
- GIZ, GOPA (2014) Plani i Menaxhimit për Parkun Natyror Rajonal Nikaj-Mërtur
- GIZ, GOPA (2014) Plani i Menaxhimit për Parkun Natyror Rajonal Shkrel
- GIZ: botimi “The guide of Valbona”
- GIZ: botimi “Udherrefyesi i Thethit”
- GIZ: botimi “The guide of the Regional Nature Park of Nikaj-Mërtur”
- GIZ: botimi “Udhërrëfyes Parku Natyror Rajonal Shkrel”
- Ministria e Mjedisit, GIZ, GOPA (2015) “Zonimi i Parkut Kombëtar të Alpeve Shqiptare”
- Departamenti i Gjeofizikës Rajonale dhe Inxhinierik & Departamentit të Sizmologjisë së Institutit të Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (2010), “Vlerësimi i rrezikut potencial dhe aktual të erozionit të tokës për gjithë territorin e Shqipërisë nëpërmjet GIS dhe ndërthurja e tij me teknologjinë e vlerësimit sipas CORINE Land Cover ”
- State Authority for Geospatial Information (ASIG)
- Furnizimi me ujë dhe KUZ - Bashkitë respektive (Malësia e Madhe, Shkodër, Vau i Dejës, Tropojë) dhe vizita në terren
- Të dhënat e agreguara për ndërmarrjet e ujësjellësve - DPUK Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve
- Llogaritja e nevojës për ujë - Masterplani i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime për Shqipërinë
- Shtigjet turistike në rajon - www.zbulo.org
- Shtigje për këmbësorë dhe bicikleta - Albania hiking & biking map: Huber Kartographie GmbH; National Society for Mountainous Studies, Albania, Albanian Alps association, Harta dhe Udhëtime
- Shtegu Majat e Balkanit - Peaks of the Balkans: GIZ, zbulo.org

Referenca ligjore:

- Ligji 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 8378, datë 22.7.1998, ndryshuar me ligjin nr. 9808, datë 24.9.2007 dhe ligjin nr. 10 488, datë 5.12.2011 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.7.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen Zonë e Mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”
- Ligji nr.9048 date 07.04. 2003 “Për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.102, datë 15.1.1996 “Për miratimin në parim të strategjisë për zbatimin e projektit për vlerësimin mjedisor nga zbatimi i projektit të pyjeve”
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 9868, datë 4.2.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 “për zonat e mbrojtura”
- Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar
- VKM nr. 395, datë 21.6.2006 “Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillimin e turizmit kulturor dhe mjedisor”
- VKM nr. 175, datë 19.1.2011 “Strategjia Kombëtare Shqiptare mbi mbetjet”
- VKM nr. 844, datë 11.06.2008 “Strategjia Sektoriale e Turizmit 2007 - 2013” dhe “Draft strategjia sektoriale e turizmit 2014 - 2020”
- VKM nr. 80, datë 28.01.2008 “Strategjia Sektoriale e mbrojtjes sociale”
- VKM nr.774, datë 14.11.2007 “Strategjia Ndërsektoriale Shqiptare e zhvillimit rural”
- VKM nr. 924, datë 14.11.2007 “Strategjia Sektoriale e bujqësisë dhe ushqimit”
- VKM nr. 751, datë 7.11.2007 “Strategjia Sektoriale e punësimit”
- VKM nr. 847, datë 29.11.2007 “Strategjia Ndërsektoriale e mjedisit”
- VKM nr. 348, datë 12.05.2016 “Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015 – 2020”
- VKM nr. 643, datë 14.09.2011 “Strategjia Kombëtare Sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve 2011-2017” & “Strategjia Kombëtare e mbrojtjes sociale 2015-2020”
- VKM nr. 773, dt.14.11.2007 “Strategjia Ndërsektoriale për zhvillimin rajonal” & “Strategjia Ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen Vendore 2015 - 2020”
- VKM nr. 405, datë 01.06.2016 “Strategjia e strehimit social 2016 - 2025”
- VKM nr. 427, datë 08.06.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit”
- Ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”
- Ligji nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”
- Ligji nr. 9180, datë 5.2.2004, “Për statistikat zyrtare”, i ndryshuar

AKRONIME

PKS – Plan Kombëtar Sektorial
PKST – Plan Kombëtar Sektorial i Turizmit
MZHETTS – Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MM – Ministria e Mjedisit
MZHU – Ministria e Zhvillimit Urban
AKPT – Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
VKM – Vendim i Këshillit të Ministrave
PPK – Plani i Përgjithshëm Kombëtar
PINS – Plani i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit
PK – Park Kombëtar
IPA – Instrument i Para Anëtarësimit
NJEF - Njësi Ekonomike Familjare
ZB – Zona Bërthame
ZF – Zona Funktionale
ZM – Zona Mbështetëse
NjAV – Njësi Administrative Vendore
NjA – Njësi Administrative
PBB – Prodhimi i Brendshëm Bruto
IUCN - International Union for Conservation of Nature
(Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës)
EEC - European Economic Community
VNM – Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
PNR – Park Natyror Rajonal
TAP – Trans Adriatic Pipeline
IAP – Ionian Adriatic Pipeline
UNESCO – United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization
AMBO – The Albanian, Macedonian & Bulgarian Oil Pipeline Corporation
KE – Këshilli i Europës
BB – Banka Botërore
UNDP – United Nations Development Programme
UNEP – United Nations Environment Programme (UN Environment)
GEF – Global Environment Facility
IUCN – International Union for Conservation of Nature
WWF – World Wildlife Fund
GIZ – German Society for International Cooperation
SIDA – Swedish International Development Cooperation Agency,
Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
ADA – Agjencia Austriake e Zhvillimit
MAVA – Mava - Fondation pour la nature
EUROPARC – EUROPARC Federation is the network for Europe's natural and cultural heritage
MADA – Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore
INCA – Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri
GOPA – Specialists in developing and transition economies - leading German development consulting firm and one of the strongest consulting groups in Europe
SNV – a not-for-profit international development organisation
KESH – Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
OST - Operatori i Sistemit të Transmetimit

PLANI KOMBËTAR SEKTORIAL
I TURIZMIT PËR RAJONIN
E ALPEVE SHQIPTARE

Dhjetor 2017